

LE MONDE. *shqip* diplomatiq

Le Monde
Diplomatique
në shqip / Faqe 2

Mujorja e njohur franceze, me numrin më të madh të artikujve të shpërndara në botë, mund të gjendet nga sot edhe në Tiranë, Prizren, Vlorë, Ferizaj, Shkup, Shkodër, Prishtinë, etj.

200 LEKË, 2 EURO / MUJORE / 24 FAQE

Nr. 786 / Viti i 66 i botimit / Shtator 2019

Dosje Rusi, Brazil

Kush përfiton nga lufta kundër korrupsionit?

Ta qortojmë apo ta ndryshojmë botën?

NGA BENOIT BRÉVILLE DHE RENAUD LAMBERT



Marrëveshja © Gentian Shkurti

Ata mishërojnë kundër fuqinë ose kundër pushtetin: gazetarët që hetojnë korrupsionin e të fuqishmëve. Këta hetues, investigues, po detyrojnë ministrat të dorëhiqen, po shkundojnë këshilltarët, po heqin shefat - më rrallë. Por këngët e transparencës gjithmonë ruajnë një zonë gri. Si punojnë, kush u kundërvihet, çfarë i motivon, publiku nuk di asgjë. Pierre Pean, i cili ishte një figurë e spikatur në këtë mjedis, hedh mbi këto kulisa një dritë origjinale. / Faqe 12

Rusi

Opozitarët rusë janë gjithmonë të korruptuar

Nga Tony Wood / Faqe 16

Në fillim të viteve 2000, zoti Vladimir Putin, instrumentalizoi luftën kundër korrupsionit për tu rimarrë oligarkëve të kohës së Jelcinit pushtetin që kishin akumuluar gjatë tranzicionit. Ishte një kthim drejt të afërmeve të presidentit për ti pasuruar ata. 15 vjet më vonë, përvetësimi dhe tronditjet janë bërë pjesë e brendshme e kapitalizmit rus.

Brazil

Misteri i një grushti shteti juridik

Nga Perry Anderson / Faqe 14

Shkarkimi i presidentes braziliane Dilma Ruself në vitin 2016, procesi me një spektakël të madh i burgosjes në vitin 2018 i Luiz Inacio "Lula" da Silva, u ngritën mbi të njëjtin motiv: lufta kundër korrupsionit. Një numër i madh vëzhguesish e kanë miratuar këtë fshesë të dhënë në emër të drejtësisë republikane. Por mund të dallohet se është fjala për një grusht shteti juridik nga i cili përfitoi ekstremi i djathtë.

Shoqëri

Emancipimi homoseksual, çështje politike

Nga Jean Stern / Faqe 3

Nga fundi i shekullit të XIX e deri në atë të XX, pretendimi për rinjohjen e identitetit homoseksual, disa herë, është kryqëzuar me luftën e klasave.

Kush e zgjedhi zonjën von der Leyen?

NGA SERGE HALIMI

Zgjedhjet presidenciale dhe vapa e padurueshme e korrikut 2019! Gjithë kjo errësoi një çështje që zbuloi plot çrregullime, megjithatë demokratike. Me vështrimin e turbulluar nga djersa, pak evropianë, në fakt, vumë re se ligjërimi politik, që është zbehur, të paktën prej tri vjetësh, erdhi dhe u bë shpërthyes. Shtypi, i zënë me «investigime» të tjera, nuk u mundua ta sinjalizonte këtë ngjarje.

Qindra milionë zgjedhës europianë deri këtu ishin përkundur nga një narrativë «manisheiste» (që analizon raportet shoqërore sipas skemës «E mira» dhe «E keqja», shën. im I.Y.). Politika e Unionit dhe votimet e fundit të muajit maj, siç u pa, mund të përmbledheshin në ballafaqimin mes dy kampeve: liberalët kundër «populistëve». 2 korrik, takim i kryetarëve



CC-BY-4.0: © European Union 2019 - Source: EP

të shteteve dhe drejtuesve të Unionit. Aty rekomandohet që ministrja kristian-demokrate gjermane, Ursula von der Leyen të bëhet presidente e Komisionit evropian. Ideja u hodh nga z. Emmanuel Makron. Sugjerimi i tij, natyrisht, u rimor nga Knacelarja Merkel, por edhe nga ... kryeministri hungarez Viktor Orban.

Që nga zgjedhja e tij, presidenti francez, nuk kishte reshtur se betuari që ai do të tregojë i pakompromis me nacionalistët dhe «populistët», këta sjellës të «pasionëve të trishtuar», të «ideve që shumë herë kanë ndezur flakët ku Europa mund të dig-

jej e të zhdukej». Ata gënjejnë popujt dhe u premtojnë atyre vetëm urrejtje, kishte thënë ai. Zoti Makron, po ashtu, nisej edhe nga modestia e tij e paqortueshme për të sfiduar dy nga zjarrvënësist e qëllimshëm, drejtuesin e ekstremit të djathtë italian, Mateo Salvini dhe z. Orban: «Nëse në personin tim shohin opozitarin kryesor, ata kanë të drejtë.»

16 korrikun e shkuar, kur eurodeputetët konfirmuan zgjedhjen e kryetarëve të shteteve dhe qeverisësve të Unionit, slogonet e fushatave - «progresistët» - kundër nacionalistëve - ranë dhe ia lanë vendin një konfigurimi politik krejtësisht tjetër. Parlamentarët socialistë votuan në disa raste kundër zonjës von der Leyen (francezët dhe gjermanët përkatësisht) dhe spanjollët e portugezët ndonjëherë. Dhe, në këtë rastin e fundit, ata u gjendën bashkë me nacionalistët polakë dhe të besuarit e zotit Orban. Domethënë me ata që edhe zonja Le Pen i joshte disa

ditë më parë për të formuar me ta një grup të përbashkët në Strasburg... Si përfundim, kandidatja e zotit Makron ia detyron zgjedhjen e saj si presidente e Komisionit Evropian, fituar me një mazhorancë me vetëm 9 nëntë vota tepër, koalicionit të parregullt dhe atipik që përbëhej nga trembëdhjetë parlamentarë hungarezë besnikë të zotit Orban si dhe katërmëdhjetë eurodeputetë «populistë» të Lëvizjes 5 Yjet, në atë kohë aleatë e Salvinit.

Një hartë e tillë e votimeve, sigurisht që na largon nga historikat që çdo mëngjes u tregohen evropianëve të urtë dhe të disiplinuar. Megjithatë, pavarësisht se temperaturat po bëhen normale në Kontinentin e Vjetër, shumica e gazetarëve do të vazhdojnë të përsëritin deri në mërzë kategoritë artificiale me të cilat z. Makron i ka mitomanizuar.

1 Shih Serzh Halimi dhe Pierr Rimbart «Libereaux contre populistes, un clivage trompeur», *Le monde Diplomatique*, septembre 21018.
2 Fjalimi në Sorbonë, Paris, 26 shtator, 2017.

Shqipërimi i «Le monde diplomatique»

Shqipërimi i «Le monde diplomatique» është përpjekje për ta zhvilluar tutje një gazetari profesionale, pjesëmarrëse dhe jopersonale, në një mjedis ku jo rrallëherë në emër të lirisë së shprehjes përhapen ide ksenofobe, konservatore, eksploatuese, fanatike, autoritare, oligarkike, patriarkale etj.

Le Monde Diplomatique » flet më në fund edhe shqip. Mujorja e njohur franceze, me numrin më të madh të artikujve të shpërndara në botë, mund të gjendet nga sot edhe në Tiranë, Prizren, Vlorë, Ferizaj, Shkup, Shkodër, Prishtinë, etj.

Kështu, «Le monde diplomatique» në gjuhën shqipe i bashkohet tashmë dhjetëra botimeve ekzistuese ndërkombëtare; në gjuhën angleze, gjermane, italiane, japoneze, arabe e deri në gjuhën palestineze, farsi, esperanto, etj.

Por, ky botim nuk është vetëm në shërbim të universalizimit të sociokulturës shqiptare. Ai është mbi të gjitha një gazetë. Një platformë që synon ta pasurojë hapësirën mediatike e publike, me tema (ndër)kombëtare, sociale, ekonomike, kulturore etj.

Shqipërimi i «Le monde diplomatique» është përpjekje për një gazetari cilësore e përmbajtësore, më afër tjetrit, në kohën e globalizimit dhe në zemër të modernitetit numerik, ku hapësira jonë mediatike po përqendrohet çdo ditë e më tepër në informim të shkurtër, të shpejtë dhe të lokalizuar.

«Le monde diplomatique» do të ndihmojë ta kuptojmë realitetin tonë përmes këndvështrimit internacional dhe, njëkohësisht, ta analizojmë e ta kuptojmë botën përmes përditshmërisë tonë.

Shqipërimi i «Le monde diplomatique» është përpjekje për ta zhvilluar tutje një gazetari profesionale, pjesëmarrëse dhe jopersonale, në një mjedis ku, jo rrallëherë, në emër të lirisë së shprehjes, përhapen ide ksenofobe, konservatore, eksploatuese, fanatike, autoritare, oligarkike, patriarkale etj.

Një gazetari të angazhuar që ka për synim të së vërtetës besnikërinë ndaj një ideali jetese, e që nuk përkufizohet vetëm në fakte duke toleruar ideologjitë vrastare edhe në emër të neutralitetit. Një gazetari që nuk mjaftohet me përhapje mendimesh, sepse të tilla nuk mungojnë në pluralizmin mediatik dhe publik.

«Nëse nuk besojmë në asgjë, nëse asgjë nuk ka kuptim dhe nëse nuk mund ta shpërfaqim asnjë vlerë, atëherë gjithçka është e lejuar dhe asgjë nuk ka rëndësi. Atëherë nuk ka as të mirë dhe as të keqe. Dhe Hitleri nuk e kishte as mirë dhe as keq, Ai që e ka me të drejtë është ai që ka sukses dhe ai e ka mirë përderisa ka sukses», thoshte Albert Camus.

Tanimë çdo muaj, lexuesi shqiptar ka një mundësi më shumë. Një hapësirë të re. Aty ku gjuha shqipe dhe shoqëria shqiptare është pjesë e «Le monde» si njerëzim dhe «Diplomatique» si marrëdhënie.

REDAKSIA



TRIDHJETË VJET PAS RAPORTIT BOURDIEU, ASNJË LËVIZJE

Kuptimi i filozofisë dhe sfida e demokratizimit

Filozofia do të mund të quhet si një disiplinë çelës për të armatosur shpirtin kritik nxënësve. Por mësimi i saj vuan nga konservatorizmi i ngulët, i ardhur gjerësisht nga prestigji paralizues që e rrethon këtë lëndë.

**NGA SERGE COSPÉREC
DHE FRÉDÉRIC LE PLAINE***

Filozofia paraqitet si një emblemë sidomos e demokracisë. Ajo është e pakufizuar, emancipuese universale, kampione e çdo terreni të shpirtit kritik. Të anuluar, asnjëherë, «Udhëzimet» e ministrit të arsimit publik dhe arteve të bukura Anatol dhe Monzi, që datojnë në vitin 1925, deklarojnë se «pikërisht në orën e filozofisë studentët mësojnë çfarë është liria duke ushtruar refleksionin, dhe mund të themi se është pikërisht aty objekti i pastër dhe thelbësor i mësimdhënies (1)». Kur bëhet fjalë për ta dhënë si mësim, pranohet se jemi larg asaj që duhet. Në fillim kur u hap lënda e filozofisë pati studentë më shumë se asnjëherë tjetër: gjysma e një brezi

në Francë – vetëm gjysma ama, sepse studentët e liceve profesionalë, që përfaqësojnë 28% të maturantëve, u përjashtuan(1), njëlloj si ata që dolën nga institucionet shkollore një vit më parë. Pavarësisht të tjerave, gjysma e një brezi nuk është pak, dhe një grup liceistësh patën fatin që vitin e tyre të fundit të zbulonin mënyra të vëzhgimit të gjërave të pazakonta për ta, që nxitën frikën dhe kuriozitetin, dhe që, për pjesën më të madhe të tyre, do të jetë takimi i parë dhe i fundit me filozofinë.

Çfarë nxjerrin ata si konkluzion? Raporti i fundit i hartuar para dhjetë vjetësh nga inspektimi i përgjithshëm i filozofisë të godet nga qartësia e tij, në një regjistër ku figurat e imponuara duhet të kënaqen me gjendjen e tanishme(1). Kështu, duke nënvizuar cilësinë e mësuësve, angazhimet dhe përpjekjet e tyre për t’iu përshtatur kushteve ndonjëherë dhe shumë të vështira, vërehet se «një pjesë



Pierre Bourdieu © Thierry Ehrmann

goxa e madhe e nxënësve, sidomos në disa kurse, shfaq një indiferencë totale dhe pa nuanca ndaj aspektit çlirimtar të filozofisë, duke e konsideruar nga çdo pikëpamje, si humbje kohe qëndrimin në klasën e filozofisë». Filialet teknike janë nga më të përmendurat. Vazhdojnë t’u kërkohet që të shkruajnë disertacione – që konsiderohet si një provë kryesore që prej një shekulli – sidomos nxënësve që kanë vështirësi në shkollë, orientimi

i të cilëve në një degë të caktuar është bërë gabimisht, dhe që nuk kanë asnjë bagazh kulturor, apo shprehin gjuhësore që do të mund t’i ndihmonte të kalonin këtë lloj ushtrimi.

I kaluar fare pa u vënë re në profesione, ky raport do të përfundonte kështu: «Mësimdhënia e filozofisë ndodhet në udhëkryq të disa rrugëve. Ka shumë mundësi që të humbasë, nëse në imazhin e vet, ajo refuzon të

ndryshojë mënyrën e të qenit, dmth, mënyrën e dhënies së mësimi». Dhjetë vjet më vonë asgjë nuk ka ndryshuar.

Si arritëm deri këtu? Padashur hedhim një sy në retrospektivë: nëse sot mësimdhënia e filozofisë i vë në vështirësi profesorët dhe nxënësit, duke u kërkuar me ngulm disave që të kërkojnë nga të tjerët që të marrin në të njëjtin vit provimesh një kulturë filozofike dhe një metodë reflektimi të gdhendur në mermer, kjo ka ndodhur sepse të gjitha tentativat e shndërrimit u hodhën në mënyrë të pandryshueshme. Në vitin 1988, ministri i arsimit Lionel Zhospe, i kërkoi një grupi të drejtuar nga sociologu Pjer Burdjë dhe filozofi Frederik Gros të mendonin rreth përmbajtjes së mësimdhënies. Komisioni i filozofisë dhe epistemologjisë, i drejtuar njëkohësisht nga Zhak Boveres dhe Zhak Derrida përfundoi raportin e tij në qershor të vitit 1989 (1). Ky tekst përfundimtar, ku diagnostika dhe propozimet nuk morën as një rrudhë në 30 vjet rresht, nuk u bë kurrë objekt i një debati serioz dhe të argumentuar në këtë profesion: ministri hoqi dorë nga botimi i tij, nën presionin e një pjesë të mirë të komisionit. Edhe sot e kësaj dite, një pjesë e madhe e mësuësve e injoron ekzistencën e tij. Përse bënte fjalë ky raport? Në të thuhej se duhej të zbritej nga piedestali metoda e mësimdhënies së filozofisë në të cilën kishte ngritur lart shenjtërimin e saj. Duhet të futej karakteri i saj shkollor, progresiv, më pak elitiste dhe që shqetësohej më shumë për formimin real të nxënësve.

* Përkatesisht profesor filozofie në shkollën e mesme të mësuësive dhe të edukimit të Kretëj, autor i librit me titull *Filozofia, një reformë e pamundur? Një mësim në nivel elite si provë për demokracizimin*, që do të dalë në qarkullim këtë vjeshtë nga botimet Lambert-Lukas; si dhe profesor filozofie, president i Shoqatës për krijimin e instituteve të kërkimit mbi mësimdhënien e lëndës së filozofisë (Acireph).

Filozofia do të mund të quhet si një disiplinë çelës për të armatosur shpirtin kritik nxënësve. Por mësimi i saj vuan nga konservatorizmi i ngulët, i ardhur gjerësisht nga prestigji paralizues që e rrethon këtë lëndë

Midis të tjerash, dy propozime të këtij raporti u ofruan për debat. E para ishte që të nxirrej kjo lëndë nga izolimi i saj pasi jepej vetëm në vitin e fundit dhe të kthehej në një cikël të detyrueshëm: të filloje në fillorë, pastaj në shkollë të mesme duke e përfunduar në shkollën e lartë. Filozofia nuk konsiderohej më si kurorëzim, por si një shoqëruese dhe e lidhur me disiplina të tjera, duke e ndihmuar nxënësin që të japë një unitet dhe një përmasë kritike kulturës së tij në mënyrë që ai ta përfitojë atë.

Propozimi i dytë ishte që të saktësohej dhe të përcaktoheshin programet në mënyrë që të sigurohej se nxënësi në provim do vlerësohej duke u nisur nga çfarë kishte përfituar në klasë; sepse në mungesë të tyre, aftësitë e marra jashtë shkollës do të bëheshin përcaktuese, aftësi të cilat i dimë se nuk janë më të mirat të përhapura në mënyrë sociale. Që në vitin 1973 programet kanë të bëjnë me nocionet: liria, lumturia, shteti, arti, etj... ose i njëjti nocion mund të shihet nga kënde të ndryshme. Profesorët në teori janë të lirë të zgjedhin tema dhe të ndërtojnë orët e tyre me autoritet që ata përzgjedhin vetë. Por, në praktikë, nuk kanë kohë të thellojnë të gjitha aspektet e një nocioni, dhe nxënësit e tyre mund të kenë në provim në fund të shkollës së mesme një temë që nuk e kanë studiuar ose e kanë studiuar shumë pak gjatë vitit.

Kjo liri mund të hapë debate mbi ekzistencën e një libri-arbitër, libër i përzgjedhur me vullnet të lirë, (një liri që kundërshton determinizmin) apo dhe mbi liritë politike. Një tjetër shembull: një inventar jo i plotë i temave të provimit në fund në lidhje me artin e dhënë që prej tridhjetë vjetësh nxjerr në pah se kandidatët mbahen për të përballuar afërsisht rreth 15 problematika të ndryshme. Midis këtyre temave mund të vecojmë: «Natyra e veprave të artit», («Çfarë e dallon një vepër arti nga një objekt çfarëdo?»), «Raportet midis Artit dhe së vërtetës», («Vepra e artit na vendos përballë një të vërtetë të pamundur për t'u arritur në mënyrë të tjera?»), apo akoma «Raportet midis Artit dhe historisë» («A varet vepra e artit nga koha në të cilën është realizuar?»).

Programi ekzistues pretendon të garantojë lirinë e profesorëve, por, në realitet, përbush të kundërtën: një program i pacaktuar nuk ofron liri më të mëdha. Përkundrazi: sa më shumë që është i përqëndruar në disa probleme të caktuara për t'u studiuar, në bazë të të cilave do të vlerësohen kandidatët në provim, aq më shumë kohë dhe aftësi kanë profesorët për të thelluar dhe ndryshuar metodat filozofike me nxënësit e tyre. Ky episod i raportit Derrida-Buveres ka shkrirë tre dhjetëvjeçarët që erdhën pas. Çdo tentativë për të reformuar programet dhe provimet e fundit të shkollës së mesme, në kuptimin e një kufizimi të madh të nocioneve për të studiuar dhe të një formulimi më të mirë të arsyeve, një kamp konservator po

formohet, ose më mirë të themi po riformohet, mbështetur në mitologjinë e profesionit.

Rezultati i kësaj lufte programesh është përjetësimi i gjendjes aktuale të gjërave: futja e lëndës së filozofisë në shkollën fillore, në shkollat e mesme profesionale dhe në arsimin e lartë nuk është debatuar seriozisht dhe provimet e fundit të shkollës së mesme ngelen të pandryshuara.

Në emër të autencitetit filozofik, reflektimet dhe praktikimet të vërtetë pedagogjike shihen të degdisura në rangun e «një kuzhine të vogël» ku çdo profesor ka të vetën, dhe kur nuk priten me mosbesim apo përçmim. Siç e vë në dukje dhe sociologu Luis Pinto në vitin 1983, «një punë që ka për objekt përmasat sociale të aftësive filozofike nuk mund të ndjehet apo denoncohet si një agresion nga të gjithë ata që e shndërrojnë në një monopol profesional të mendimit të fundit, një mendim që përkufizohet vetë». Kështu, kjo përmasë qëndrore e çdo mësimdhënieje – didaktika e saj – është përjashtuar përgjithmonë nga formimi fillestar dhe i vazhdueshëm i profesorëve, pothuajse ekskluzivisht e mësuar. «Konkurset dhe sidomos konkurset për profesorë, janë konceptuar dhe jetuar si «tituj ekselence filozofike» dhe mjete për të vazhduar të qenit «filozof» më shumë se një rrugë hyrjeje në profesionin e profesorit të filozofisë», do të denonconte që para njëzet vjetësh Manifesti për mësimdhënien dhe për filozofinë, që është dhe teksti bazë i Shoqatës për krijimin e instituteve të kërkimit mbi mësimdhënien e filozofisë. (Acireph).

Për të demokratizuar mësimdhënien e filozofisë nuk mungojnë idetë. Duke filluar me nxjerrjen e saj nga mbyllja vetëm në vitin e fundit të shkollës së mesme, për ta futur në rrugën progresive dhe bashkëkohore në të tria vitet e liceut. Do të duhej që programe të reja, të dhënë për këta tre vite, të mundësonin futjen tek analiza, kërkimi dhe diskutimi racional. Duke e ditur se bëhet fjalë për

përbajtje dhe praktika, duhet vënë theksi tek thithja e njohurive thelbësore nga vetë nxënësit, thithja e njohurive logjike dhe argumentuese (një kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm; argument/sofizëm; arsyetim induktiv/deduktiv; etj.), orientime leksikore dhe konceptuale të lidhura me çdo nocion apo problem, orientime kulturore që lidhen me rrymat e mëdha filozofike duke kundërshtuar një problem të dhënë, dhe, në fund, çështje të lidhura me botën bashkëkohore.

Mund të imagjinonim një orar të përbashkët për këtë formim të përbashkët të klasës që nga viti i dytë deri tek i fundit. Asgjë nuk e justifikon shpërndarjen e orarit aktual, me vetëm katër orë filozofi në formimin e përgjithshëm, krahasuar me dy orë në profilet teknologjike dhe asnjë orë tek licetë profesionale. Kjo situatë nuk ka asnjë lloj kuptimi: atje ku nxënësit janë më të dobët në formimin e përgjithshëm për shkak të profilit që kanë zgjedhur, atje ku do të kishin nevojë për një formim akoma më të fortë, kanë më pak orë në dispozicion.

Reforma e diskutuar në ditët e sotme, e ndryshuar nga masat e marra në lidhje me rendin buxhetor, nuk po merr këtë drejtim, fatqësisht. Përveç çështjes së orareve dhe mënyrave të përhershme, nëse nuk është zvogëluar në një kontekst të rreptë, ministri i arsimit Z. Jean-Michel Blanker emëroi një konservator në krye të Këshillit të lartë të programeve (CSP). Znj. Suad Ajada ka ushtruar, gjithashtu, një kontroll mbi grupet e ngarkuara për përpunimin e projekteve të programeve (GEPP), duke i ndaluar që të takohen me shoqatat, sindikatat dhe specialistë të tjerë të mësimdhënies, në kundërshtim me kartën që inkudron Këshillin e lartë të Programeve, sipas të cilit, «në bazë të dekretit të 24 korrikut 2013, grupi i përpunimit të projekteve për programet (...), konsulton specialistët dhe partnerët ekspertiza e të cilëve duket e nevojshme». Programet e ardhshme, nuk do të jenë ndonjë surprizë, pasi do të ruajnë paqartësinë e programeve të para.

Njëkohësisht, së prapthi, kundër reformës konservatore dhe «disnivelimit të kërkesave» që përkojnë shpesh me qëllimet më të mira, i kërkohet më pak nxënësve të dobët – duke bërë kështu që ata të mësojnë më pak –, është më e nevojshme se kurrë, të rinovojmë metodat praktike të formimit dhe të vlerësimit të nxënësve në filozofi, për t'iu dhënë mjetet e të mësuarit real të mënyrave të mendimit kritik. Kjo lejon të shndërrohen provat e provimit të pjekurisë për të saktësuar, qartësuar dhe argumentuar kërkesat. Një shteg veçanërisht urgjent në seritë teknologjike, ku një pjesë domethënëse e kandidatëve të habitur nga paqartësia e arsytimit, e mbaron vetëm në një orë, një provim të planifikuar të zgjasë katër orë.



Shoqëria

Emancipimi homoseksual, çështje politike

Nga fundi i shekullit të XIX e deri në atë të XX, pretendimi për rinjohjen e identitetit homoseksual, disa herë, është kryqëzuar me luftën e klasave. Lëvizja militante *Homo* ka dashur të përafrohet me lëvizjen punëtore, megjithë goditjet, në kuptimin e plotë të fjalës, që ajo ka marrë. Kjo vajtje-ardhje përshkon veprën e eseistit kontravers Zhil Dove¹ dhe doktorantit Matija Kuer²

Më 1869 Frederik Engels, në një letër drejtuar Karl Marksit, shqetësohej për «pederastët» që organizoheshin «en secret» me të majtën që sapo lindte në Gjermani. Që në 1864, Karl Hajnrih Ulrihs, pranë social-demokratëve të atëhershëm, kishte botuar *Kërkime mbi enigmën e dashurisë mes meshkujve*. Për të, të mbrosh «të drejtën e dashurisë brenda të njëjtit seks shpesh ngatërohet me luftën për liritë demokratike». Psikiatërit, pas Sigmund Frojdit, do të ishin armiqësorë me penalizimin e homoseksualitetit – të rrënjësor edhe në kodin penal gjerman në paragrafin e tmerrshëm 175, adoptuar më 1871 dhe rrëzuar më 1994, - duke shpallur se «duhej njohur shmangia që ta zotërosh pastaj», shpjegon Dové. Nazistët nuk ishin të këtij mendimi dhe e ashpërsuan këtë nen në vitin 1935 duke dërguar disa dhjetëra mijëra homoseksualë në kampet e vdekjes.

Hipokrizia e Anglisë postviktoriale, shfaqja e «zanave» - paraprijëset e drag-geens (burra që vishen me rrobat e grave –shën i përkth.) – në SHBA dhe ndërtimi i një korrenti politik të strukturuar në Gjermaninë e viteve 1920: paraqitje e huazuar nga rrugë të ndryshme sipas fuqive perëndimore. Përmes teksteve, korrespondencave, studimeve sociologjike, intervistave, Dové përshkruan një homoskesualitet të lidhur me mënyrën e riprodhimit kapitalist dhe, për rrjedhojë, me luftën e klasave. Duhet të presim shpërthimin e Stonuellit në Nju Jork, në 1969-n, në një periudhë, «të tronditur nga mosbindjet e klasës punëtore» që lëvizja *Homo*, në fillim e afërt me të majtën radikale, të lindë *gay power* me logjikën e saj konformiste. Këtu Dovéja shikon dështimin e besimit sipas të cilit «emancipimi seksual kalon përmes revolucionit social global». Kapitalizmi «i rehatuar me atë që nuk e bezdis» uron një «kapërcim» drejt një «poliseksualitetit» (me konture teorike të zbehta), me qëllim që të dalë nga pretendimi për një identitet strikt.

Kuéréja merrret me një faqe të veçantë të luftës lesbiane, gej, biseksual dhe trans (LGBT) në Francë, hapur prej Grupit të lirisë homoseksuale mes 1974-s dhe 1979-s. Debati për identitetin homoseksual nisat atëherë prej konstatimit që «nuk ka asnjë konvergencë mes një borgjezi të madh homo, një proletari homo dhe një borgjezi të vogël homo». Ta bësh atë që është private një çështje politike do të thotë të shpikësh një lëvizje të veçantë, të bëhesh aleat me të shtypurit: debati për konvergencën e luftërave përshkon tekstet e përdorura prej Kuérésë dhe duken në fakt të vërteta përballë një modeli të homoseksualitetit trajtuar si mall.

NGA JEAN STERN

1 Gilles Dauvé, *Homo, Question sociale et question sexuelle de 1864 à nos jours*. Niet! Editions, Le Mas-d'Azil, 2018, 296 pages, 9 euro. Proche du groupe La Vieille Taupe, Dauvé a été un temps considéré, parmi d'autres représentants d'une certaine mouvance de l'extrême gauche, comme un soutien de position revisionistes.

2 Mathias Quérel, *Qui sème le vent recolt la rapette. Une histoire des Groupes de libération sexuels en France de 1974 à 1979*. Tahin Party, Lyon, 2019. 168 pages, 6 euro.

“Mëshira”, mjerimi i fshehur i përzgjedhjes

Ndërsa arsimit kombëtar po përjeton një mungesë në rritje të burimeve dhe efektivitet, një moto po lulëzon: «dashamirësia» që mësuesit janë të ftuar të dëshmojnë për nxënësit e tyre, dhe që mund të triumfojë mbi të gjitha pengesat. Si ato refrenet që përsëritin psallmet në kishë, maskohet kështu, pafuqia e institucionit për të zvogëluar hendekun midis fëmijëve të klasave të privileguara dhe atyre të klasave popullore.

NGA CLOTHILDE DOZIER DHE SAMUEL DUMOULIN

Republika», «ekselencat», «dashamirësia»: nga tre fjalët e zgjedhura prej Ministrisë të Arsimit Kombëtar, Z. Jean-Michel Blanquer, në ditën e parë të shkollës, në Shtator 2017, është ajo e fundit që surprizon. Që nga Jules Ferry, nuk mund të flitet për shkollë pa kujtuar Republikën. Ekselencia ka hyrë edhe në fjalorin e përditshëm të shkollave. I referohet shqetësimit të institucionit, mbështetur nga disa mësues, për të mos përqendruar përpjekjet dhe mjetet në mënyrë disproporcionale të studentët në vështirësi në «dëm» të tjerëve. Duke treguar vullnet për të qenë i vëmendshëm, mbi të gjitha, për të mos dëmtuar të favorizuarit, kjo fjalë u bë shprehja zyrtare - megjithëse e eufemizuar - duke justifikuar dallimet e suksesit akademik.

AFTËSITË NË SHUMËS

Kështu që mbetet dashamirësia. Nocioni u përhap në kolegje dhe shkolla të mesme në pak vite. Frymëzuar nga politika e kujdesit, e shpërndarë në Francë nga zonja Martine Aubry (1), ajo u mbrojt nga Ministri e Arsimit Kombëtar Vincent Peillon në vitin 2012, si pjesë e konsultës «Rithemelojmë shkollën e Republikës», me ligj paraprak, ratifikim, me të njëjtin emër. Dashamirësia tani shfaqet si një nga shtyllat e «praktikave të mira» të mbrojtura nga institucioni. Një formulë mund të përmbledhë filozofinë: «çdo i i ri ka nevojë për inkurajim çdo ditë (2). Pa këtë pedagogji mirëkuptuese, nxënësi nuk do të jetë në gjendje të ketë sukses e, pra, të parashikojë një orientim të lumtur.

Mesazhi është i qartë: mësues të vrazhdë, që përdorni arsenalin e dekurajimit (vetullngrysur, me vërejtje të mprehta dhe nota tejet të ulta), ju mbani përgjegjësinë kryesore

në dështimin e qindra mijëra krizalideve, që presin një gjest për t'u bërë flutura. Ose si të promovohen në debatet për shkollën, çështjet mbi sjelljen, në vend të çështjeve mbi strukturën. Dalja në orbitë e temës së dashamirësisë në universin arsimor, në radhë të parë, synon të fshehtë shkaqet e vërteta të dështimit të shkollës. Përshatur mrekullisht me kurën shtrënguese të imponuar ndaj shërbimit publik - kjo «dashamirësi» nuk i kushton asgjë Shtetit - ai është gjithashtu ekrani i përsosur i saj, përderisa largon vëmendjen nga çështje të pahijshme, siç janë numri i orëve të mësimi ose numri i nxënësve për klasë.

Nën presidencën e Z. François Hollande lulëzoi psalmi moralizues. Mësuesi u shndërrua në animator: «Mësuesi krijon kushte të përshatshme dhe qetësuese, në mënyrë që të gjithë fëmijët (edhe ata që nuk flasin ose flasin pak) të flasin, të marrin pjesë në situata gjuhësore që janë më komplekse sesa ato të jetës së zakonshme; ai mirëpret gabimet «pozitive» (...). Kështu, ndihmon në krijimin e drejtësisë midis fëmijëve duke zvogëluar dallimet gjuhësore (3). «

Për t'u dhënë fund pabarazive në zotërimin e gjuhës, strategjet e rrugës Grenelle mbështeten në dashamirësinë e mësuesit. Kur shkruan, nxënësi duhet të jetë në gjendje të mbështetet në «vërejtje gjithmonë miqësore që kanë të bëjnë me tekstin e krijuar fillimisht (4)». Në nivelin e kolegjit, personaliteti i drejtorisë i qorton ata që kanë pasur fatkeqësinë të vendosin një zero për një detyrë të pakryer dhe u kërkojnë më-



Photo by Visual Tag Mix from Pexels

Nxitur nga Bashkimi European, vlerësimi sipas aftësive tani, është i përhapur në shkollat fillore dhe në një numër të madh kolegësh

suesve të plotësojnë vlerësimin e tyre tremujor të nxënësit, me një fjalë pozitive.

Rekomandimi mund të bëhet nëse nuk provohet të zëvendësohet misioni emancipues i shkollës me imperativin e përbushjes personale: «Shkolla e kopshtit është një shkollë dashamirëse (...). Misioni i saj kryesor është t'i bëjë fëmijët të duan të shkojnë në shkollë për të mësuar të afirmohen dhe të zhvillojnë personalitetin e tyre (5). «

Injeksioni provokon sjellje paradoksale mes mësuesve: sarkazëm dhe lodhje përballë leitmotivit të ri të institucionit, por edhe qartësi ndaj këtij fjalimi që i bën me faj. Përballë vështirësisë së detyrës, nganjëherë mizorisë, ata mund të jenë të ndjeshëm ndaj asaj që, nën maskën e përparimit, është në të vërtetë një tërheqje, heqje dorë. «Nëse duam të diplomojmë

jmë më shumë nxënës, duhet të shkojmë në një sistem mësimor që përzgjedh në mënyrë që më të mirët të arrijnë trajnimin e ekxelencës, në një sistem «dashamirës» i cili vendos të ndihmojë me mënyra të ndryshme, nxënës me aftësi të shumta, kështu shkruante një raport i Inspektoratit të Përgjithshëm në vitin 2013 (6). Në akademinë e qytetit Lille, një kolegji zgjodhi të emërojë projektin e tij me emërtimin «kolegj i inteligjencave në shumës». Në Prill 2015, ai mori çmimin e Inovacionit dhe Zhvillimit Profesional në Ditën e Inovacionit të Ministrisë së Arsimit Kombëtar. Parimi? «Ftesa për mësuesit për të kërkuar forma të tjera të inteligjencës në të mësuar, inteligjenca hapësinore, fizike - kinestetike ose muzikore - ritmike (7). »Përfutuesit? «Nxënësit në vështirësi me gjuhën. Dhe për të rekomanduar në veçanti përdorimin e «hartës heuristike», mind map ose «hartave të mendjes», këtyre skemave që kanë pushtuar manualët, fletoret dhe dosjet.

Talent, potencial, inteligjencë aftësi... Laki mi i këtyre termave shmang realitetin e hierarkisë së dijes dhe aftësive shkollërore, dhe pasoja e saj: një vend pak a shumë i lakmueshëm në shkollën shoqërore. Përdorimi i tyre tradhton - dhe shpërndan - një konceptim thelbësor për nxënësit sepse është i shkëputur nga klasa e tyre shoqërore. Në vend që të përpiqet të kuptojë dështimin e shkollës për ta luftuar më mirë atë, ky konceptim e mbështet atë dhe e pikturon me konsiderata morale në mënyrë që ta bëjë atë më të pranueshme dhe të pashmangshme. Këto ligjërime pseudo-egualitare, barazuese, kanë për qëllim të justifikojnë heqjen dorë nga institucioni shkollor që duhet t'i qasë fëmijët e klasave të ulëta të dija e ligjshme.

Nga ana e tij, Lycée Henri-IV, në lagjen e 5-të të Parisit, mban kursin e tij. Deri në fillim të shtatorit 2018, para reformës së shkollës së mesme, ai vinte në dispozicion të nxënësve të klasës së parë një listë të librave si «këshilla për leximin». Në frëngjisht, për kapitullin e vetëm «Realizmi dhe natyralizmi», numëroheshin dy-



sociale në shkollë

zet e tre tituj. Për të mos përmendur novelat natyraliste të Emile Zola, Guy de Maupassant, Joris-Karl Huysmans ... Kur do të firmoset një peticion i intelektualëve për të kërkuar respekt për «aftësitë në shumës» të fëmijëve të borgjezisë pariziane?

THYEJENI TERMOMETRIN ...

Ky promovim i dashamirësisë i bën jehonë instalimit, në të gjitha nivelet e sistemit shkollor, të vlerësimit të zotësisë. Të dy konvergojnë për të fshehur dështimin e masivizimit të shkollës. Shqetësimi për dashamirësinë çon, për shembull, në shkollën fillore, në emërimin e disa nxënësve përgjegjës, që çdo javë marrin misionet të shumta pa objektiva konjitive, që kanë të bëjnë me dijen, siç është fshirja e tryezës, mbledhja e fletoreve, rreshtimi i shokëve para hyrjes në klasë, etj., të cilët krijojnë një çoroditje, të madhe midis dijeve që do të fitohen dhe detyrave që duhet të kryhen (8). Sapo vlerësohen si të tilla, si një formë e «aftësisë në sjellje», në referencat e aftësive tani të përhapura në të gjitha nivelet e institucionit shkollor, fëmija i shoqërueshëm dhe vullnetar për të fikur dritat dhe ulur grilat ka çdo arsye për të besuar, dhe familja e tij tok me të, që ai po përmbush pjesën e tij të kontratës. Edhe nëse ai nuk e zotëron leximin. Sulmi kundër vlerësimit të nxënësve përmes një vlerësimi numerik - të zëvendësuar nga një sistem kompleks vlerësimesh sipas aftësive - ka të bëjë me të njëjtën logjikë. Nxitur nga Bashkimi Evropian (9), vlerësimi sipas aftësive tani, është i përhapur në shkollat fillore dhe në një numër të madh kolegësh. Buletinët tani janë tabela të pafund që tregojnë «aftësi» të ndara në «fusha», të segmentuara në «artikuj» me skica, me konture veçanërisht të paqarta: «dëgjoni të kuptoni një mesazh me gojë, një fjalim, një tekst të lexuar»; «përvetëso dhe kupto thelbin e fjalëve» ... ato janë bërë të palexueshme. Ndërgjegjësimi për pabarazitë e shkollës, burim zhgënjimi brutal për të rinjtë e dalë nga klasat popullore, shkon nga shkolla fillore në shkollë të mesme, ku nota vazhdon.

Ideja e thyerjes së termometrit për uljen e etheve nuk është e re. Por sot ajo futet sistematikisht në të gjitha fazat e udhëtimit arsimor. Ja rasti i një nxënësi të vitit të tretë që ka ambicien të marrë diplomën e shkollës. Le ta quajmë atë Florian. Që nga sesioni i vitit 2017, diploma shënohet në 800 pikë. Katërqind pikë jepën për teste në fund të vitit shkollor. 400 pikë janë rezultat i provimeve në fund të vitit shkollor. 400 pikët e mbetura fitohen nga zotërimi i të tetë komponentëve, secili i shënuar nga 50 pikë, të cilët qëndrojnë mbi një «themel të përbashkët të njohurive, aftësive dhe kulturës». Këta përbërës nuk korrespondojnë me mjedisin e njohur të punës (disiplinën) të nxënësit. Kjo detyron mësuesit të punojnë, përafërsisht, në mënyrë që të ngulitin «pozicionimin» e secilit nxënësi për secilën nga tetë përbërësit e pedestalit (për shembull: «metodat dhe mjetet për të mësuar», «formimi i personit dhe qytetarit»).

Paqartësia nuk ndalet këtu. Në të vërtetë, për secilin përbërës ishte fiksuar një shkallë me katër vlera që dëshmon nivelin e kontrollit të arritur: «të pamjaftueshëm» (10 pikë nga 50), «të brishtë» (25 pikë), «të kënaqshëm» (40 pikë) dhe «përvetësim shumë i mirë» (50 pikë). Edhe nëse Florian është një hijë në anglisht, detajimi i numërimit të pikëve i garanton atij të paktën 20% të pikëve të mundshme. Shumë i mirë në matematikë - por jo i shkëlqyer - ai do të marrë 100% pikë për përbërësin në fjalë. Dhe, nëse, përkundër këtij shkallëzimi, që përmirëson vetë rezultatet e nxënësve - por jo njohuritë e tyre - Floriani rrezikonte të dështonte, ai do mund të mbështetej në ndërhyrjet e përsëritura të stafit drejtues në kuptimin e një korrigjimi për të ngritur vlerësimet e bëra nga mësuesit.

Përqindjet e suksesit të nxënësve në provime të ndryshme janë me të vërtetë elemente kryesore në vlerësimin e punës së drejtuesve të shkollës nga drejtorët akademikë të shërbimeve arsimore kombëtare (Dasen, ish inspektorët e akademisë) dhe rektorët.

Me reformat e shkollës së mesme dhe të maturave që hyri në fuqi në Shtator 2019, Z. Blanquer shtrin këtë prioritet. Nocioni i «rregullimit» të individualizuar të nxënësve - që supozohet të zgjedhin «specialitetet» e tyre - imiton lirinë duke lënë të dhëna strukturore: jo të gjitha specialitetet mësohen në të gjitha shkollat e mesme. Këtu, përsëri, mbretëron paqartësia mbi marrjen e diplomës së ardhshme: kontrolli të vazhdueshme, teste të zakonshme (disa në klasë të parë, të tjerë në vitin përfundimtar), provime përfundimtare (disa në klasë të parë, të tjerë në vitin përfundimtar). Lum ai që do dijë të shohë qartë - ose më saktë, lum ai që do të informohet. Dispozita kontradiktore është e fortë për nxënësin e shkollës së mesme i ftuar të zgjedhë specialitetet e tij ndërsa një përzgjedhje e fortë e vendos atë nën një vlerësim të përhershëm.

Shkolla e Republikës së Tretë, e fortë dhe kërkuese, në të cilën nxënësit do të kishin fituar zotërimin e tabelave të shumëzimit dhe njohurinë mbi rregullat e drejtshkrim-it, është kryesisht fantazi. Edhe për sistemin e vjetër të vlerësimit nuk duhet të kemi nostalgji të veçantë. Renditja shoqërore e nxënësve ekzistonte, tashmë që më përpara. Por, institucioni nuk bëri qas shumë përpjekje për ta bërë atë të padukshëm

(1) Lire Evelyne Pieiller, «Liberté, égalité... "care"», Le Monde diplomatique, septembre 2010.
(2) «Agir contre le décrochage scolaire: alliance éducative et approche pédagogique repensées», rapport de l'inspection générale de l'éducation nationale (IGEN) et de l'inspection générale de l'administration de l'éducation nationale et de la recherche (IGAENR), ministère de l'éducation nationale, Paris, juin 2013.
(3) Bulletin officiel, ministère de l'éducation nationale, Paris, 26 mars 2015.
(4) Bulletin officiel, 24 décembre 2015.
(5) Bulletin officiel spécial no 2, 26 mars 2015.
(6) «Agir contre le décrochage scolaire», op. cit.
(7) Ibid.
(8) Cf. Stéphane Bonnéry, Comprendre l'échec scolaire. Éléves en difficultés et dispositifs pédagogiques, La Dispute, coll. «L'enjeu scolaire», Paris, 2007.
(9) «Une nouvelle stratégie en matière de compétences pour l'Europe», Commission européenne, Bruxelles, 10 juin 2016.



Dorine dhe Gérard Horst, alias André Gorz

Ekologji

Në kutinë e veglave të André Gorz-it

Në në fjalim të pazakontë të vitit 2005 dhe që është botuar sot, (1) mendimtari Andre Gorz (1923-2007) i tregon mikut të tij filozof Fransua Nudelman se lufta e tij në favor të ekologjisë është e pandarë nga kritika e tij në lidhje me racionalitetin ekonomik. Mendimtar kundërshtues dhe teoricien i rënies, në librin e tij *Të mendosh të ardhmen*, ai shpjegon se shoqëria e konsumit krijon më shumë nevojë të pakënaqshme sesa përmbush në të vërtetë. : «*jetojmë në një regjim ku qëllimi i çdo aktiviteti është krijimi i gjërave të këmbës dhe të pagueshme, dhe ajo ç'ka nuk është e pagueshme nuk ka status në ekonominë kapitaliste*». Larg diktatit të kryeqytetit dhe mbretërimit të mallrave, Gorz mbron një botë ku mundohet të mbrrojë kohën e lirë dhe lulëzimin në gjirin e të gjallëve. Ashtu siç e tregojnë edhe librat e tij, *Ekologjia dhe politika*, botuar në vitin 1975, *Ekologjia dhe liria* botuar në vitin 1977, ai shqetësohet për të ekuilibruar biosferën, ekosistemin dhe njerëzimin. I alarmuar nga ndotja e madhe dhe i shqetësuar nga rreziqet që sjellin përdorimet e lëndëve bërthamore, ai hedh një thirrje të mprehtë : «*Akuzoj*» logjikën ekonomike shkatërruese. Për mendimin e tij,

sindikalizmi dhe ekologjia politike shkojnë bashkë, dhe janë baza e një mendimi «baza e lirisë, e emnacionit, e subjektivitetit autonom dhe e demokracisë vetadministruese», - përfundon Nudelmani.

Pikërisht këtë gjë analizon dhe Uilli Xhaninazi në ribotimin e biografisë së tij *Andre Gorz. Një jetë e tërë*. (1) «*Ekologjizmi i tij drejtohet nga qëllime sociale*», komenton Xhaninazi, ku saktëson se «*Gorz vdiq duke menduar se «dalja nga kapitalizmi ka filluar tashmë*». Gazetari-filozof kishte kuptuar më herët me mjaft qartësi dobësitë dhe krizën e kapitalizmit financiar pas vitit 2008. Në ditët e sotme, gratë dhe burrat që duan të kufizojnë tregtinë e mallrave, lëvizjen e parave, utilitarizmin dhe ekonominë për të krijuar një shoqëri me një masë ekstrategtare, do të gjejnë në utopinë konkrete të Gorzit një pikënisje të mrekullueshme.

Si mund të ndërtojnë parimet e ekologjisë sociale një horizont të ri emancipimi ? Kjo është pyetja e ngritur në një artikull të titulluar «*Ekologjia politike ndërmjet ekspertkracisë dhe autokufizimit*», e vitit 1992 dhe që rimerret përsëri nën titullin

Elozh i mjaftueshëm (1). Përgjigjja bashkon atë që ndonjëherë e quajmë «*ekosocializmi*» apo dhe «*ekologjia arkadiane*». Bëhet fjalë për të interpretuar degradimet e planetit si një shenjë e krizës sistematike të qytetërimit. «*Kriza e jetës urbane, e vendit ku banojmë, e mjekësisë, e shkollës, dhe e shkencës*», saktëson Gorz. Atëherë çfarë duhet bërë ? Për babain e ekologjisë politike dhe të teorisë së autonomisë, realiteti ekologjik shënon një kufi të mjaftueshëm për sjelljet tona dhe për veprimet, gjithashtu. Autonomia njerëzore duhet të integrojë kuadrin mjedisor si një parim politik dhe ruajtjen e burimeve natyrore si një domosdoshmëri materiale. Çdo gjë që vihet në lojë në mënyrë demokratike qëndron në një ekuilibër të arsyeshëm dhe në një përfaqje koherente, të cilat, së bashku, përcaktojnë normën e të mjaftueshmes. Kjo do të thotë, përfundon ai, se «*një normë e caktuar rregullon nivelin e përpjekjes në funksion të kënaqësisë së kërkuar dhe anasjelltas*». Me anë të këtyre tre veprave, mendimi i Andre Gorzit, që ngelet një referencë thelbësore në regjimet kritike, është një pikënisje e së ardhmes së ekologjisë politike franceze.

ALIOCHA WALD LASOWSKI

E përmendur disa herë si kundërshtuese e Komisionit European dhe si nxitëse e rritjes së fuqisë blerëse, qeveria portugeze, tashmë është në vështirësi. Shumë lëvizje shoqërore po tensionojnë situatën në vend, si greva e shoferëve të kamionëve për paga më të mira. Në kulmin e vapës, madje, kryeministri kërkoi të shtonte kamionët për të furnizuar stacionet e shërbimeve. Lufta kundër punëve të përkohshme dhe për rritjen e fuqisë blerëse prekin jo vetëm pagat e sektorit publik, por edhe ato privat.

NGA I DËRGUARI SPECIAL MICKAËL CORREIA

Cfarë duam ne? Shtëpi për të gjithë!», bërtasin një grup prej nja pesëdhjetë personash përpara ndërtesës gri të ministrisë së strehimit. Në këtë mëngjes të 4 qershorit 2019, militantët e Stop Despejos («Jo dëbimeve») dhe një grusht familjesh lisboneze të kërcënuara me dëbim, nuk kanë ndërmend të mërziten.

Disa ditë më parë, zonja Maria Nazare Jorge, 83 vjeçe që baninte në qendër të kryeqytetit Lisbonë është nxjerrë jashtë nga shtëpia prej nja dhjetë plocësh. «Ajo jetonte prej dyzetë vjetësh në atë apartament. Kontrata e qerasë ishte në emërin e tezes së saj, që vdiq nuk ka pak kohë», tregon zonja Sandra P., e «Stop Despejos». Qiraja e saj ishte 200 euro në muaj. Me qenë se çmimi i qerave të banesave në qendër të kryeqytetit është rritur ndjeshëm, pronari do të përfitojë dhe e ka dëbuar. Përreth një ore, anëtarët e këtij grupi manifestojnë duke tundur pankartat në të cilat shkruhet: «Banimi është në krizë» ose «Jo spekulimit imobiliar!», ndërkohë që një delegacion i vogël është lejuar që të hyjë në ndërtesën e ministrisë. Shefja e kabinetit e ministres deklaroi në mënyrë lakonike: «Maria Nazare Jorge është strehuar përkohësisht derisa të gjendet një zgjidhje përfundimtare.» «Qysh nga nxjerrja forcërisht prej banesës ajo është dërrmuar dhe ka humbur gjithë kursimet, thotë Sandra P. Jeton e izoluar në lartësitë e Kastelos, lagjes më turistike të qytetit, ku e vetmja mënyrë e transportit publik, i famshmi tramvaj 28, është plot e përplot me pushues...»

Më 2012, guvernatori i qendrës së djathtë z. Pedro Passos Coelho (2011-2015) modifikoi ligjin për banesat në favor të pronarëve, duke lehtësuar kështu rritjen e qerasë që pati si përfundim ndërprejen e qerave të vjetra dhe dëbimin e qiramarrësve në rastet kur ata nuk rinovonin kontratën me çmime të reja. E asfiksuar nga kriza e borxheve që nga viti 2008, Portugalia në vitin 2012 ra në rrjetën e «trojkës», aleanca e Fondit Monetar ndërkombëtar, Banka qendrore europiane dhe Komisioni europian. Këta i rekomunduan prishjen e tregut imobiliar dhe zhvillimin e ofertës turistike si kusht për dhëniene ndihmës prej 78 miliard eurosh. Qysh atëherë, Lisbona u përdor për të rritur «aktivitetin fiskal», duke stimuluar tregun imobiliar. Krijuar në vitin 2012 «vizat e arta», leje qëndrimi

prej pesë vjetësh akorduar të huajve që blejnë të mira imobiliare për më shumë se 500 000 euro, bënë që në ekonominë portugeze të injektohen 4 miliard euro kapital në këtë sektor. Kësaj i shtohet edhe statusi i rezidentit jo të përhershëm (RNH), garanci e një regjimi fiskal avantazhues për shumë pensionistë europjanë që zgjedhin të vendosen në Portugali dhe gjejnë aty një banesë.

«Një ligj tjetër, ai i vitit 2014 që rregullon vendbanimet e tipit Airbnb, u lejon pronarëve të fitojnë 3000 euro në muaj duke u dhënë me qera turistëve një banesë që një portugezi do t'ia jepnin me 300 euro, shton Luis Mendes, gjeograf dhe anëtar i Mora rem Lisboa («Të banosh në Lisbonë»), platformë e rreth dyzet shoqatave për të drejtën e banesës. Në disa lagje të qendrës, më shumë se një në dy banesa është dhënë me qera përmes Airbnb. Ky liberalizim i tregut të banesave ka çuar në nxjerrjen jashtë banesës të një deri në tre familje çdo ditë. Edhe klasat e mesme tani kanë vështirësi në strehim!» Me një rritje të banesave turistike prej 3000% brenda dhjetë vjetësh, që nga viti 2018, Lisbona është qyteti europian që numuron më shumë rezidenca Airbnb për banorë, përpara Barcelonës dhe Parisit. Ndërkaq, «në katër vjet qeveria e majtë ka reaguar shumë pak përballë këtij arsenalit masash neoliberal, që favorizojnë financimin e pronarëve të banesave», deklaroi Mendes.

Përrjashtime fiskale për të pasurit që jetojnë jashtë

Në nëntor 2015, qeveria e kryeministrit socialist Antonio Costa erdhi në pushtet duke shpallur vullnetin se do të zbuste masat e ashpra të parashikuara nga «trojka». I mbështetur në Parlament nga Blloku i majtë, Partia Komuniste portugeze (PCP) dhe ekologjistët në saj të marrëveshjeve dypalëshe – një koalicion i quajtur *la gerinçona* –, ekzekutivi vuri në veprim një politikë të rritjes së fuqisë blerëse, gjithë duke ndërhyrë në rregullimin e llogarive publike. Qeveria rivlerësoi pensionet me modeste duke e rritur pagën minimale deri në kufirin e paluajtëshmë të 485 eurove bruto në muaj (për katërmëdhjetë muaj) deri në 2014 dhe në vitin 2019 ajo e kaloi shifrën e 600 erove – dhe ka zgjeruar bazën e pagesës për minimumin jetik.¹

QEVERI E MAJTË... POR JO SHUMË

Ana e fshehur e




Pyjet në flakë në Portugali, 2016. Foto nga Roman Königshtofer, Flickr

Dhe rezultatet janë të shndritshme. Në qershor 2017 Portugalia doli nga procedura deficitit të rënduar në të cilën gjendej qysh prej 2009-ës. Përqindja e papunësisë është ulur ndjeshëm, duke kaluar nga 12% në 2015-n në 6.3% në 2019 dhe qeveria synon të arrijë një deficit publik përafërsisht në zero për vitin 2019, ndërkohë që ka stabilizuar akoma me 4.4% rritjen e prodhimit të përgjithshëm bruto (PIB) që në vitin 2015: e para shifër e arritur që nga rikthimi i demokracisë në vitin 1974. Rritja «kulmoi» që nga 2017 me 2.8% një rekord që nuk njihej prej shtatëmbëdhjetë vjetësh.

Nga Neë York Times te Le Monde, nga Figaro te Economie e te Financial Times, shtypi përshëndeste «mrekullinë e ekonomisë portugeze». Ndërsa e majta europiane duartrokiste këtë rinisje të veçantë, udhëhequr nga M. Kosta, që diti t'i kthejë shpinën dogmës së masave të ashpra imponuar nga Brukseli. Gjatë fushatës presidenciale në Francë në vitin 2017, kandidati socialist Benua Hamo, shkoi takoi z. Kosta në Lisbonë. Nga ana e tij z. Zhan-Lyk Melenshon (Franca e panënshtuar) i referohej «modelit portugez» për të lartësuar programin e tij elektoral.

Ky sukses u përkthye në rezultate të mira në zgjedhjet e fundit europiane megjithë absetnimin e fortë. Zëvendës sekretari i shtetit për çështjet parlamentare, socialisti Duarte Kordeiro, i kënaqur me rezultatin e partisë së tij, ulur në kolltukun e zyrës së tij elegante në zemër të Asamblesë Parlamentare të Republikës, nënvizon: «Disa muaj deri në zgjedhjet legislative të tetorit, ne e kemi rritur numrin e parlamentarëve me 33.4% të votave. Ne nuk kemi tetë, por nëntë



deputetë socialistë në Parlamentin europian. Është kjo një shenjë e mbështetjes së gjerë popullore për logjikën aktuale të Partisë Socialiste (PS) dhe të partive që mbështesin qeverinë.»

Megjithatë, PS-ja portugeze duket se është ambientuar pa shumë vështirësi me aplikimin e lasave neoliberalë të pararendësve të saj. Siç janë psh., masat që nxisin pronarët imobiliarë që t'ua japin me qera banesat më parë turistëve sesa banorëve vendës përrjashtimi nga taksat pasur për të tërhequr investitorët kinezë dhe rusë. «Vizat e arta dhe statusi i RNH-së janë dy objekte mbi të cilat qeveria nuk e ka rifolmuar politikën e saj, pranon z. Kordeiro. Por ne jemi të gathsëm për të reflektuar, natyrisht gjatë legjislaturës së ardhshme.»

Me të vërtetë? Në janar 2019, M. Kosta përuroi një regjim të shoqërisë imobiliare, frymëzuar prej Real Estate Investment Trust, një model që të lejon të transformosh investimin imobiliar në investim financiar falë avantazheve fiskale. Për më tepër, në të njëjtën logjikë si statusi i RNH, qeveria, qysh nga korriku i 2019-s ofron një zvogëlim me 50% të taksave për të ardhurat gjatë pesë vjetëve për të gjithë portugezët, të cilët, të larguar gjatë periudhës së ashpër të masave të trojkës, vendosin të kthehen në atdhe. Gjatë viteve 2010 dhe 2015, në periudhën më të nxehtë të masave ekonomike të ashpra e shtrënguese, 500 000 persona, pra, 5% e popullsisë, emigroi në fakt. Objektivi i kësaj mase: të inkurajojë me taksa të ulëta të rinjtë e diplomuar dhe të pasur që të vijin e të investojnë në Portugali. Një ndihmë të cilën nuk mund ta mar-

mrekullisë portugeze

rin ata që nuk kanë pasur mjetet për të emigruar gjatë viteve të masave të ashpra ekonomike.

Të nesërmen e aksionit Stop Despejos, Mora rem Lisboa organizoi një debat me temë kalimin rishitas të banesave Airbnb në administrim nga bashkia. Në një sallë të vogël me perde të trasha, dy hapa larg Muzeut të traditës muzikore «fado», një lagje e ulët e Alfamas, debatet e ndezura shuhen vetëm kur bie nata. Zonja Lurdes Pinheiro e shoqatës së lagjes, shpërthen: «Affama po kthehet në një park tërheqës. Të gjitha ndërhyrjet urbanistike të bashkisë janë drejtuar për turistët dhe për lizbonasit. Është një barabari arkitekturore që po shkatërron pasurinë tonë!»

Disa rugica më tej, bashkia socialiste ia ka dhënë pallatin Santa Helena, një ndërtesë antike e pagëzuar në shekullin XVI, Stone Capital, një nga promotorët kryesorë imobiliarë të qytetit. Dy vëllezërit, në krye të këtij grupi privat, francezët Artur dhe Geofroy Moreno, e kanë transformuar në apartamente luksi. «Nga ana tjetër e kodrës së Alfamës, Stone Capital ka privatizuar një oborr të lashtë me pemë dekorative, i konsideruar si mushkëria e gjelbër e lagjes Graça, thotë zonja Ana Jara, arkitekte dhe këshilltare e opozitës në bashki (PCP). *Projekti i saj është që të ndërtojë një rezidencë të mbyllur luksi, pa konsultim publik dhe pa studim ambiental.*

Lisbona terreni i lojërave të investitorëve

Pas zgjedhjeve për pushtetin lokal, që rikonfirmuan kryetarin socialist të bashkisë Fernando Medina, projektet urbane të hapësirës nuk kanë kaluar në sitën e këshillit bashkiak. Ato janë vlerësuar drejtpërdrejt nga zëvendëskryetari i bashkisë, i ngarkuar me urbanistikën. M. Manyel Salgado, që kishte këtë funksion deri në gushtin e shkuar, për dymbëdhjetë vjet ka qenë «mjeshtri i strategjisë së menaxhimit urban neoliberal, objektivi themelor i të cilit ka qenë ta kthejë Lisbonën në një tokë pjellore për investimet financiare», thotë zonja Jara.

«Ka akoma pesë vjet që një në tri ndërtesa në Lisbonë është shkatërruar, degraduar ose është bosh», na thotë Mendes. Qysh se tregu i lëvizshëm i rehabilitimit të kryeqytetit i është besuar sektorit privat, projekte të mëdha urbanistike janë rrëmbyer nga M. Sangado. Në veri të kryeqytetit, e ardhmja e Torre Portugalia, një kullë që ka brenda saj banesa luksoze, ka nxjerrë në pah zemërimin e lizbonasve. Nga ana tjetër e Tage, në lagjet popullore, projekti Lisbon South Bay, parashikohet të jetë operacioni më i madh i rikualifikimit urban që nga ekspozita ndërkombëtare e 1998-s. Në program: qendra e kongresit, marina dhe hotele luksoze. Promotorët e kësaj nismëçmojnë se ky projekt «do të përforcojë statusin e Lisbonës si destinacion i turizmit dhe investimeve» (Publico, 14 maj 2019). Kryeqyteti sot është bërë një terren



Kështjella São Jorge, Lisbonë. Foto nga Massimo Catarinella

Ulja spektakolare e papunësisë fshihet në fakt pas punonjësve të paguar keq dhe pak të kualifikuar

i tillë lojërash për investitorët ndërkombëtarë sa që M. Medina ishte e ftuar në pranverën e vitit 2019 në klubin Bielsberg një mbledhje diskrete vjetore e elitave politike dhe ekonomike perëndimore.

Kjo politikë e rrëmbimit të të mirave publike, e shkatërrimit të së drejtës të banimit në kryeqytetin portugez kanë për qëllim të lehtësojnë dobësinë e madhe të investimeve të qeverisë së M. Kostas. Sepse, që prej ardhjes në pushtet të socialistëve, çantat e portugezëve janë zvogëluar ashtu siç nuk kanë qenë qysh nga viti 1974. Më 2018 madje, vendi ka qenë investitori më i dobët publik i zonës euro.²

Arsyet e kësaj zgjedhjeje politike? Ankthi i qeverisë socialiste është të respektojë ortodoksinë buxhetore të imponuar nga traktatet europiane. Ringritja e ekonomisë ka shërbyer kështu vetëm si prioritet për përmirësimin e kushteve të jetës së portugezëve, por edhe për reduktimin e borxhit, vlerësuar me 120% të PIB. «Një pjesë e madhe e PS-së dëshiron të ruajë një marrëdhënie paqësore me sektorin bankar dhe institucionet europiane, për t'u dukur si një nxënës i mirë në sy të Europës,

shton José Gusmao, drejtues i Bllokut të majtë dhe eurodeputet. *Objektivi final është të zvogëlohet borxhi i brendshëm për të respektuar tavanin e fiksuar nga B rukseli deri në 60% të PIB. Por, duke vështuar ritmin aktual të reduktimit të borxhit-ajo që është utopike – do të duhej që ne të privoheshim nga investimet publike për të paktën edhe dy dhjetëvjeçarë...» Z. Kordeiro pranon: «Divergjenca kryesore me ne partënerët e majtë mbetet ritmi i reduktimit të borxhit. Ato nuk përputhen me objektivat tanë buxhetorë. Ne i përmblushim ato plotësisht.»*

Kjo ashpërsi është vënë në jetë nga ministri i financave Mario Cén-tenao, ekonomist liberal i diplomuar në Harvard dhe presidenti aktual i Eurogrupit³. Më shumë se të investojë në sektorin publik, z. Centeno ka fryrë rishitaz arkat e Novo Banko-s⁴, një bankë private që kishte falimentuar gjatë krizës për shkak të aktiviteteve të saj spekulative: 1.9 miliard euro para publike. Vendimi provokoi zemërimin e së majtës radikale dhe të komunistëve të cilët akuzuan ministrin që preferonte «të shëndoshte» bankat private më shumë se të kryente investimet e nevojshme në vend.

Universitetet janë në prag të falimentimit; sistemit shëndetësor i mungojnë mjetet materiale dhe personale. Sektori publik i infrastrukturës hekurudhore ka shpallur se 60% e linjave të trenave janë në një gjendje «të keqe» ose «mediokre». Sa u takon banesave sociale, ato nuk zënë më shumë se 2% të fondit imobiliar. «Një ligj kuadër mbi banesat sapo është miratuar në Parlament, por pak a shumë ne e dimë se si ka për të përfunduar ai, psherëtin zonja Rita Silva, e shoqatës për të drejtën e banimit «Habitá». *Megjithë disa masa pozitive, nuk ekziston asnjë vullnet politik për të investuar para publike në strehim. Dhe Antonio Kosta ka pohuar tashmë se ky ligj nuk duhet të vërë në diskutim liberalizimin e tregut imobiliar.»*

Simptomat e këtij tensioni mes disiplinës buxhetore dhe politikave sociale: greva e fundit e mësuesve. Duke dashur të përfitojnë nga

përmirësimi ekonomik, këta të fundit kërkojnë rritjen e pensioneve, të ngrira gjatë nëntë vjetëve për shkak të ashpërsisë buxhetore. Por në 3 majin e shkuar, kryeministri e cilësoi këtë miratim të të tilla shpenzimeve nga Parlamenti si «bombë buxhetore» që kërcënonte të prishte «ekuilibrin e shpenzimeve publike» dhe që do të kompromentonte «besueshmërinë ndërkombëtare» të vendit. Pasi qeveria kërcënoi me dorëheqje, mësuesit arritën të përfitojnë vetëm një ngritje të pjesshme të pensioneve të tyre me përlllogaritje vetëm për dy vjet e nëntë muaj.

«Vendi ka mbetur i bllokuar nga dëshira për të kënaqur kërkesat e Brukselit, analizon José Reis, kërkues shkencor i ekonomisë në universitetin e Coimbras dhe koordinator i Observatorit të krizave dhe alternativave. *Një luftë e vështirë është bërë për të rivlerësuar të ardhurat e ulëta brenda kuadrit të buxhetit evropian, por niveli i përgjithshëm i pagave nuk ka arritur ende atë të para krizës financiare. Përse? Sepse rritja ekonomike, mes të tjerash, mbështetet në punën sezonale dhe me kosto të ulët.*

Më shumë se asnjëherë tjetër punëtorë të përkohshëm

Ulja spektakolare e papunësisë fshihet në fakt pas punonjësve të paguar keq dhe pak të kualifikuar. Sipas studimeve kushtuar kësaj çështjeje, gjysma e të punësuarëve sot janë me kontratë me kohë të përcaktuar. Që nga ardhja e «trojkës», nuk ka pasur asnjëherë kaq punëtorë të përkohshëm: 73 000 më shumë se në 2011-n. Gjysma e orëve shtesë të kryera, nuk ishin paguar në vitin 2018. Në radhë të parë janë të rinjtë. 65% e tyre janë me kontratë të përkohshme, dhjetë përqind më shumë se dhjetë vjet më parë. «Sa i takon legjislacionit të punës ne kemi përparuar shumë pak, mamë shumë kemi bërë regres, shpjegon z. Gusmao. *Me ndihmën e së djathtës dhe të patronatit, qeveria ka validuar si të ligjshme kontratat e përkohshme me*

koëzgjatje të pakët, rezervuar më parë për sektorin turistik. Në tërësi ajo që gërringorça mundësoi që të ndërtohej një rivlerësim i pagave, qeveria e minoi përmes pagësve për punë të përkohshme.

Ndërkohë që mes 2009-s dhe 2018-s, totali i eksporteve kaloi nga 27% në 43% të PIB – një rritje e konsiderueshme – portet industriale paraqisnin kështu një sfidë të madhe për ekonominë. Mirëpo konkurrenca e porteve të eskporti portugez mbështetet mbi shfrytëzimin e një krahu pune fleksibël dhe në shkurtimin e pagave të punëtorëve. «Në kapërcyell të 2013-s, pushteti votoi një ligj për liberalizimin e veprimtarisë portuale që solli si pasojë dobësimin e kushteve tonë të punës, tregon z. Antonio Mariano, president i sindikatës së hamejve dhe ligjistikës (Sindicato des dockers e da Actividade, Logistica, SEAL). *Kjo ka çuar drejt një forme të gjerë të nënkontraktimit.*

Në gusht 2018, SEAL-i shpalli një grevë në solidaritet me punëtorët e portit të Setubalit, nja pesëdhjetë kilometra nga Lisboa, ku 90% e dokerëve dhe logjisticienëve ishin në atë kohë me kontrata ditore. «Këta punëtorë sezonalë nuk përfitojnë as leje as sigurime shoqërore dhe as shëndetësore në raste sëmundjesh apo aksidentesh në punë. Disa mund të kontraktohen dhe të çkontraktohen dy herë brenda një dite, me qëllim që t'i mbajnë lidhur për të punuar deri në gjashtëmbëdhjetë orë në ditë», shpjegon z. Mariano. Setubali është porti i eksportit strategjik të Autoeuropea, uzina e grupit Ëolgsvagen, prej nga dalin më shumë se njëqind mijë automobila në vit dhe e The Navigator Company, një nga peshat më të rënda të industrisë së letrës.

«Përballë lëvizjes sonë kundër punës sezonale deri në ekstrem, qeveria Kosta është çliruar nga përgjegjësia duke argumentuar se kjo është një çështje që ka të bëjë me sektorin privat, tregon presidenti i SEAL. *Më 22 nëntor, kur porti ishte paralizuar, Sheti dërgoi forcat e policisë për të thyer grevën me qëllim që të ngarkohej një sasi veturash të*

«Autoeuropa...» Ministri i detit, socialistja Ana Paula Vitorino ishte e shqetësuar më shumë për autoveturat Volkjissëagen që prisnin të ngarkoheshin dhe të eksportoheshin sesa për kushtet e dokerëve.

Fundi i 2018-s, lufta e SEAL solli një marrëveshje sipas së cilës punëtorët e Setubalit formuan një konventë kolektive. «Megjithatë, ligji i 2013-s për punën në porte mbetet në fuqi, megjithë ndërhyrjet e shumta të ministrisë së detit ose të komisioneve parlamentare që mbështeten në legjislacionin e punës. Sot në tërësinë e porteve të vendit 25-50% e punëtorëve janë punonjës ditorë të nënpaguar, vijon z. Mariano. Por dokerët nuk janë të vetmit që janë prekur nga vala e përkohshmërisë. Sheti kërkon të rrisë produktivitetin duke thyer pushtetin e negociimit të punëtorëve.»

Dyqind kilometra në veri të Lisbonës, në zemër të Portugalisë, qyteti i vogël i Pedrogao Grande duket si i thërmuar nga dielli. Për të arritur atje duhet të hysh nëpër një labirint rrugësh në mes të një peizazhi të gjerë zhgënjyes. Në qershor 2017, zjarre mosnatroze i katandisën në hi dhe trugje të shkrumbuartridhjetë mijë hektarë pyje dhe shkatuan vdekjen e shtatëdhjetë personave. Shumica u plagosën duke dashur të shpëtonin nga zjarret përmes rrugës kryesore, të cilën autoritetet nuk e kishin mbyllur në kohë. Kjo tragjedi kombëtare ka zgjuar një emocion të madh. Për të shpjeguar shkaqet e këtij zjarri, më vdekjeprurësi në historinë e vendit, shumë kanë nënvizuar mungesën e mjeteve njerëzore dhe materiale. Zjarrfikësit, në shumicë vullnetarë në Portugali, janë të përgatitur keq dhe sistemi i komunikimit mes ndihmës së shpejtë (Siresp), frut i një partneriteti publik-privat është gjykur i falimentuar prej dhjetëra vjetësh.

Qeveria e z. Kosta ishte në qendër të kritikave të ashpra. Pasoje e ashpërsisë ekonomike dhe nivelit të ulët të investimeve publike, shkatërrimi i shërbimit pyjor, privatizimi i mjeteve ajrore kundër zjarreve dhe shkurtimi i buxhetit për politikën e mbrojtjes së pyjeve, u zbatuan edhe nga ekzekutivi socialist. Mes 2006-s dhe 2016-s efektivat e policisë pyjore u reduktuan me një të tretën. Një çmenduri në një vend që ka sipërfaqen prej 32% të mbuluar me pyje dhe ku zjarret shkatërrojnë mesatarisht njëqind mijë hektarë çdo vit.

Kultura intensive e eukaliptit në fakt është inkriminuar. Kjo pemë me origjinë australiane e njohur për varfërimin njëherësh të tokës dhe të biodiversitetit është edhe shumë e ndjeshme ndaj zjarrit. Mirëpo pronarët e vegjël të pyjeve e mbjellin atë masivisht që prej njëzetë vjetësh: sepse nuk kërkon asnjë ndërhyrje dhe rritet shumë shpejt. Esenca e saj, siç dihet, shitet si lëndë e parë në industrinë e letrës, përkatësisht te The Navigator Company. «Eukalipti përfaqëson sot ¼ e pyjeve portugeze. Është fjala për llojin më të përhapur në territor, denoncon Lidhja për mbrojtjen e natyrës (LPN). Portugalia numuron densitetin më të lartë të eukaliptit në botë. Kjo pemë e shpallur prej shtetit si «nafta jeshile», perceptohet si motorri i ekonomisë.»

The Navigator Company realizon 3% të eksporteve kombëtare, domethënë e treta në rendin e eksportuesve të vendit. «Nga 2002-2004 qeveria e José Manuel Borrosos negocioi me këtë ndërmarrje me qëllim që të intensifikonte zhvillimin e saj ekonomik, na thotë zonja Nadia Piazza, e cila ka humbur djalin e saj 5 vjeç gjatë dramës së qershorit 2017 dhe që



Eucalyptus Bluegum Trees

drejton Shoqatën e viktimave të zjarrit të Pedrogao Grande.⁵ Që atëherë, qeveritë lokale me sy mbyllur, kanë dhënë autorizime që pronarët e vegjël të mbjellin eukalipte. Politika pyjore është ndërtaur mbi përfitimin e shpejtë, me pemë që rriten shpejt në zonat rurale më të pafavorizuara.» Në shtim të kësaj dhe pavarësisht dhimbjes së shoqatave të mbrojtjes së mjedisit, qeveria e z. Passos Coelho ka liberalizuar kulturën e eukaliptit për parcelat me më pak se dy hektarë, pra për më shumë se 80% të sipërfaqes pyjore, duke e transformuar Portugalinë në «Eucalyptugal», sipas shprehjes së ekologjistëve.

«Pedrogao Grande është një nga komunat më të varfra të vendit. Një e treta e 2500 banorëve tanë që janë më shumë se 65 vjeç marrin një pension më pak se 300 euro në muaj, dëshmon z. Valdemar Alves, kryetar bashkie i PS-së i komunës.⁶ Të mbjellësh disa eukalipte në parcela të vogla, do të thotë të sigurosh një të ardhur modeste për të mbijetuar». Veç kësaj, popullsia e fshatit është rrudhur dhe zvogëluar gati përgjysmë gjatë pesëdhjetë vjetëve të fundit. «Të gjithë të rinjtë shkojnë në Lisbonë për të kërkuar punë, shpreh keqardhjen kryetari i komunës. Ky eksod rural ka bërë që të braktisën fushat me pyje, të cilat të pamirëmbajtura e lehtësojnë përhapjen e zjarreve.» «Ne kemi humbur jo vetëm të afërmit, por gjithashtu edhe shpresën, na thotë duke psherëtirë zonja Piazza. Të gjithë sikur provojmë ndjenjën e braktisjes.»

Asnjë ambicie për të ndryshuar skenarin aktual.

Territori që rrethon bashkinë është rrudhur në një tërësi kodrash i gri ku të humbet vështrimi ose me fidanë të lartë eukalipti që dalin nga toka ashtu si djalli nga shishja. «Zjarret e favorizojnë përhapjen e kësaj bime si dhe sjelljen e saj prej pushtuesje...», na shpjegon LPN. Pas tragjedisë së qershorit 2017 dhe me krizën e rënduar të zjarreve, qeveria i rrit efektivitë në terren, përforcoi mjetet ajrore dhe i bleu te privati për 7 million euro rrjetin e sigurisë Siresp. Mirëpo kryeministri

ka emëruar në krye të Agjencisë për ruajtjen e integruar të zjarreve rurale, në strukturën kombëtare të koordinimit dhe planifikimit të luftës kundër zjarreve krijuar në fillim të 2019-s, z. Tiago Martins de Oliveira, ish-kuadrin e The Navigator Company. Sa u takon programeve të reja rajonale të menaxhimit pyjor, hyrë në fuqi këtë vit, ata preferojnë eukaliptin për të gjitha operacionet e mbjelljes dhe të rryllëzimit në 95% të territorit. «Programet e reja nuk dëshmojnë asnjë ambicie për të ndryshuar skenarin aktual dhe funksionimin sipas modeli biznes us usual», përfundon LPN-ja.

Që nga viti i shkuar, shenjat tregojnë se bumi ekonomik i Portugalisë është duke u shuar. Pas shtatë vjetësh ngritjeje të pandërprerë, rritja e numrit të turistëve është zvogëluar ndjeshëm në vitin 2018 – një rritje prej 3.8% përkundërsht 9.1% në 2017. Në qershor, Banco de Portugal vuri alarmin për një mundësi për «një ndërprerje brutale» të efikasitetit spekulativ në tregun imobiliar. Dhe nëse rritja ekonomike në vitin 2017 ishte 2.8%, ajo ka filluar të rrudhet në 2018 (2.1%) dhe në vitin 2019 parashikohet 1.7%.

Me dëshirën që të vërë në drejtpeshim ashpërsinë e buxhetit me rregullimin social, qeveria e z. Kosta a nuk ka ndërtaur më shumë një mirazh sesa një mrekulli? «Geringonça ka qenë një laborator politik, një përvojë e re e së majtës, përfundon Reis. Mirëpo, në prag të zgjedhjeve legjislativ të tetorit, një çështje shrohet: a mund të vazhdohet kështu?»

1 Shih Marie-Line Darcy dhe Géaenelle Lenoir, «Au Portugal, la gauche essaye», *Le monde diplomatique*, octobre 2017
2 Me vetëm 1.97% të PIB. Shih *Veille économique et financier du Portugal*, n 30, 3 maj 2019, Trésor, Paris.
3 Takim mujor i ministrave të financës së zonës euro
4 E treta Bankë e vendit, Novo Banko ka lindur nga shpëtimi i Banko Espírito Santo. Në 2014-n shteti portugez kishte injektuar tashmë 4.4 miliardë euro në arkat e saj.
5 Zonja Piazza në vitin 2018 i është bashkuar grupit të CDS – Partia popullore (e djathta konservatore) e ngarkuar me përpunimin e programit elektorale të partisë.
6 Z. Alves aktualisht është akuzuar nga drejtësia për «vrasje nga pakujdesia» për zjarret e qershorit 2017 dhe për dyshime për abuzime me fondet e rindërtimit të shtëpive.

Mizat dhe tigrat kinezë

«Nëse nuk ia dalim të rregullojmë çështjen e korrupsionit, kjo mund të jetë fatale për partinë. Mund të provokojë edhe rënien e saj», do të deklaronte kështu Z. Hu Jintao, në tetor të vitit 2012, gjatë hapjes së kongresit të XVIII të Partisë Komuniste Kineze, të cilën e drejtonte në atë kohë. Ky shqetësim u dëgjua nga pasuesi i tij Xi Jinping, që nisi një fushatë të gjerë antikorrupsioni, me qëllim që «të vriste tigrat dhe të shtypte mizat». E thënë ndryshe: të ndërshtonte qytetarët e thjeshtë ashtu si dhe drejtuesit e lartë. Në këtë pikëpamje, ai e mbajti premtimin e dhënë.

Sipas komitetit qëndror, që bënte inspektimin disiplinor të Partisë komuniste kineze, nga fundi i vitit 2012 deri në fund të vitit 2018, 1,5 milionë njerëz u dënuan në Kinë për korrupsion. Mes tyre, 527 000 mbanin një post të rëndësishëm në parti apo në aparatit shtetëor. Njëzetë e tre «tigrat» të rangut të lartë u futën në burg në fund të vitit të kaluar. Popullsia, në përgjithësi, e vlerësoi «këtë pastrim».

Problemi qëndron në faktin se vetëm komiteti vendoste për fajësinë e qytetarëve – proceset gjyqësore, kur kishte të tillë, më shpesh shërbenin si fasadë. Lufta kundër abuzimeve të mundëson, pak a shumë, eliminimin e kundërshtarëve dhe tërheqjen pas vetes të njerëzve të tyre.

Z. Bo Xilai, ish-shef i Partisë komuniste i komunës së Shongkingut (30 milionë banorë), dhe sidomos armiku i Z. Xi, di diçka rreth kësaj. Ai u arrestua më 2013, sapo u emërua në detyrë presidenti aktual, dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Që atëherë, spastrimet po rriteshin, si ajo që ka të bëjë me Z. Zu Jongkang, ish-ministrin e sigurisë, apo Z. Liu Shiju, një tjetër drejtues i bankës qëndrore...

Ndodh që drejtësia të tregohet humane. Shefi i administrimit të telekomunikacionit kinez, Z. Lu Wei, i quajtur edhe «Cari i internetit», i bindur që ishte përfshirë në korrupsion, iu desh «të rrefejhe publikisht», dhe, në këtë mënyrë, iu ul dënimi: katërmëdhjetë vjet burg – krahasuar me dënimin me burgim të përjetshëm të Z. Bo dhe Z. Zhu.

Papritur, fushata orientohet kundër drejtuesve që kanë nënshkruar kontrata jashtë shtetit në lidhje me rrugët e reja të mëndafshit (projekti *route de la soie*) (Belt and Road Initiative, BRI), të denoncuar shumë shpesh jashtë shtetit. Z. Xi do të bëjë spastrim dhe të zbardhë BRI-në.

Në kuzhinën e investigimit

Ata mishërojnë kundër fuqinë ose kundër pushtetin: gazetarët që hetojnë korrupsionin e të fuqishmëve. Këta hetues, investigadores, po detyrojnë ministrat të dorëhiqen, po shkundin këshilltarët, po heqin shëfat - më rrallë. Por këngët e transparencës gjithmonë ruajnë një zonë gri. Si punojnë, kush u kundërvihet, çfarë i motivon, publiku nuk di asgjë. Pierre Pean, i cili ishte një figurë e spikatur në këtë mjedis, hedh mbi këto kulisa një dritë origjinale.

NGA PIERRE PÉAN

Që nga mesi i viteve 1980, jeta publike franceze duket e shënjuar nga një paradoks. Nga njëra anë, rritja e papunësisë, pabarazisë sociale dhe gjeografike, globalizimi ekonomik, mospjesëmarrja e shtetit të mirëqenies siç ishte konceptuar pas Luftës së Dytë Botërore dhe rivendosja e tij në dobi të kompanive private, kanë shënjuar epokën tonë. Nga ana tjetër, bota e mediave ka ngritur në majën e hierarkisë, jo hetimin shoqëror apo raportin ekonomik, të aftë për të ndriçuar këto shndërrime, por një lloj dhe një figurë që zakonisht lulëzojnë kur gjithçka shpërbëhet: skandalin e korrupsionit politiko-financiar dhe gazetarin e ashtuquajtur «investigues».

Qarkullon emri i “biznesit” si melodia e youtub-it ngulitur në brazdat e kujtesës kolektive: Botton, Schuller-Maréchal, Urba, Mutuelle nationale e studentëve të Francës (MNEF), HLM në Paris, HLM në Hauts-de-Seine, Elf, Pelat, kasetë Méry, Crédit Lyonnais, Dumas, Balkany, Takieddine, Éoerth-Bettencourt, Cahuzac ... Një nga një ato përbëjnë lajmin kryesor, zhbëjnë fatet politike, ngulitin idenë e një shoqërie të strukturuar jo më prej përplasjes së forcave shoqërore dhe politike, por prej betejës midis se mirës, përfaqësuar nga - një numër shumë i vogël individësh të vendosur për të pastruar demokracinë tonë të bukur të deleve të zeza që e shpërftyrojnë atë, kundër së keqes përfaqësuar - nga një bandë e zgjedhur dhe zyrtarë të korruptuar. Këta engjëj të përbetuar me mish e shpirt ndaj virtutit suprem, të drejtës së informimit, formojnë një elitë brenda profesionit të tyre.

Në vitet 1970, ekuilibri midis shtypit dhe pushtetit, i çekuilibruar në favor të këtij të fundit, përbënte aktivitetin e tyre marginal, veçmas, të paktën derisa një palë e hetuesve të Ëashington Post e hoqën presidentin e Shteteve të Bashkuara. Miti themelues u bë model për t'u imituar, deri në pikën që u importua shprehja amerikane - “hetim” më mirë se anketim - çështja Ëatergate fiksoi një herë e përgjithmonë rregullat e ushtrimit: investiguesi e sheh shtetin si kundërshtar, burim i supozuar i tërëfuqishëm dhe i dëmshëm, në atë çast kur ky nis tërheqjen e tij në dobi të ndërmarrjeve private.

Kalimi nga kolonat e guximshme të gazetës “Le Canard enchaîné” drejt fundit të viteve 1970 tek, për referencë, ato të gazetës “Le Monde” në mesin e viteve 1990, gazetaria investigative e specializuar në çështjet politiko-financiare ka ndryshuar thellësisht teatrin demokratik. Vëzhguesi tani është aktor, dhe nganjëherë regjisori i shfaqjes që luhet nga partitë, zyrtarët e zgjedhur dhe votuesit. Zbulimet e tij rishpërdanë rolet në zgjedhjet presidenciale franceze të vitit 2017 duke kontribuar në eliminimin e z. François Fillon, siç edhe çuan në dorëheqjen e Zëvendës Kancelarit Austriak, Z. Heinz-Christian Strache, në vitin 2019. Kundër-pushteti u ngrit në rangun e pushtetit. Po kush e njeh funksionimin e tij? Si dalin këto “zbulime”? Kush zgjedh kalendarin, objektivat e tyre?

Një veçori e këtij aktiviteti të kryer në emër të moralit dhe kërkesës së transparencës është mprehtësia e tij. Një humnerë ndan në të vërtetë imazhin e gazetarit investigues të përcjellë

nga vetë shtypi me portret si të hetuesve, individë me sy me hije dhe cilësi gjoja të jashtëzakonshme, të fotografuar kurriz me kurriz si si në posterat e filmave me spiunazh (2), dhe praktikave të përditshme të profesionit.

Në thelb ka dy mënyra për të hetuar. Njëra, e pretenduar në mënyrë të veçantë nga autori i këtyre rreshtave, mund të përkufizohet si një gazetari banale e ngadaltë: hetuesi zgjedh lëndën e tij dhe i kushton një kohë, një energji që shumica e redaktorëve nuk do pranoin ta bënin. Ai përparon qorrazi, në mënyrë të beftë dhe merr rrezikun që të gabojë. Huluntimet e tij, në përgjithësi, rezultojnë në çështje pak të gjykuara, në krahasim me skandalet politiko-financiare që përbëjnë lajmin kryesor. Ai do të bëjë një libër, të ardhurat e të cilat mbulojnë përfaqësimin, grosso modo, shpenzimet e bëra ndërsa shitjet e librit do të ndihmojnë në fillimin e huluntimit tjetër. Është një model i brishtë: disa dështime të njëpasnjëshme tregtare, të shoqëruara me procedura për shpifje janë të mjaftueshme për t'i hequr gazetarit mundësinë (dhe dëshirën) për të filluar përsëri. Për të riparuar kredinë e dëmtuar të mediave, disa redaksi, përfshi edhe atë audio-vizuale, kanë menaxhuar formularë për të hetuar çështje ekonomike ose sociale (cash investigation “hetimi i parave”, emisioni i Elise Lucet në TV Francë 2), por fenomeni mbetet periferik.

Dhe për një arsye të mirë. Megjithatë ata zakonisht pretendojnë të ndjekin këtë rrugë të pjerrët, shumica e protagonistëve të gazetarisë investigative punojnë në një mënyrë krejtësisht të ndryshme. Nuk bëhet fjalë për të hetuar, por për të pritur një lajm që rrjedh. Nga një procesverbal auditimi ose nga hetimi dërguar nga një gjykatës, një polic, një avokat. Dokumenti mbërrin, dje me faks sot me mesazh të koduar. Detektivi i patrembur, më pas, përpqet ta rishkruajë atë në stilin gazetaresk: fakte të hollësishme, data të sakta, emra të njohur ose cilët do të dalin në shpejti. Kjo punë e zhvendosjes shoqërohet me disa thirrje telefonike për të mbledhur përgënjeshtimet apo pëshpëshet e sikletshme të personave të përfshirë, provë e pamohueshme e një pune të shkallës së parë

Afera HLM çoi në zbulimin e një kategorie të veçantë të korporatës së njerëzve të shtypit: gazetarët investigues. Kur isha ende naiv, mendoja se puna e tyre ishte ... të hetojnë, shkruajt gjykatësi Eric Halphen. Error! (...) Me përjashtime të rralla, dhe unë mendoj se ne gazetën “Canard enchaîné” (...), gazetarët investigues nuk bëjnë hetime (3) ... “Gjykatësi tregonte atëherë në off se kishte marrë një propozim nga të dy hetuesit e shkëlqyer të kohës për të “ecur së bashku”, të cilën ai nuk e pranoi.

RREGULLI YNË ËSHTË T’U PËRMBAHEMI UDHËZIMEVE GJYQËSORE”

Ngjitja e kësaj gazetarie, që ngre kronikën, rrjedh, kështu, nga një aleancë rrethanash midis një fraksioni të vogël të botës së gjyqësorit dhe pikës kulmore të botës së mediave (4). Ky koalicion i skajshëm, periferik, me efekte



të fuqishme ka disa karakteristika. Në radhë të parë, gazetari investigues nuk është përgjithësisht nismëtari i subjektit të tij të hetimit: ky i vjen i gjithi i lidhur nga një gjykatës, një polic apo një avokat, i cili ka përparësitë e tij, interesat e tij - për shembull, për të zhblllokuar pengesat, frenimet politike për një hetim gjyqësor ndaj një personaliteti të shquar duke e bërë atë publike. “Ne kemi një rregull që t’u përmbahemi udhëzimeve,” tha Ariane Chemin, e gazetes “Le Monde”. Ne nuk bëjmë hetim për nismën, iniciativën (5).”

Çështja e financimit të mundshëm libian të fushatës të z. Nicolas Sarkozy në 2007-n, e ekspozuar nga siti i faqes “Mediapart”, siguron një ndriçim të mirë të kuzhinave të investigimit. Aktorët kryesorë të shfaqjes janë përgjegjësit e Zyrës qëndrore të luftës kundër korrupsionit dhe shkeljeve financiare dhe fiskale (OCLC-IF).

Ky shërbim policor gjyqësor në Nanterre merr në pyetje protagonistët libianë dhe francezë të përmendur në hetim. Komandanti përgjegjës për dosjen skanon rregullisht procesverbalet e reja. Një avokat i shoqatës Sherpa, pjesë civile në këtë udhëzim, rikuperon kompaktdisqet e fundit që përmbajnë dokumentet. Në ditët që pasuan, një gazetar nga Mediapart lëshoi një element të ri të “hetimit”, dukshëm të dokumentuar mirë. Kujdestar i të gjitha akteve ligjore dhe tashmë i shndërruar në specialistin më të mirë të çështjes, Fabrice Arfi përfundon punën e OCLC-IF me ndihmën e procesverbalit, i cili përmban emrat, vendet, adresat e aktorëve si dhe ato të të afërmeve të tyre. Në këtë mënyrë, hetimi përfshin përzgjedhjen e dokumenteve të një hetimi nga gjyqësori që mund t’u interesojë lexuesve, rishkrimin e tyre, pastaj plotësimin; hetuesi është një menaxher i lajmit që rrjedh.

Aspekti i dytë ka të bëjë saktësisht me origjinën dhe përdorimin i këtij informacioni. Shfrytëzimi i tyre bazohet në shkeljen e dy ligjeve, prezumimin e pafajësisë dhe fshehtësinë e hetimit, në emër të një parimi, - e drejta e informacionit. Këto spërdredhje u japin të drejtë një pjese të vogël të «hetuesve» që flasin në emër të profesionit për mënyrat e tejkallimit të ligjit të përbashkët, ato të drejtësisë dhe policisë, por pa kornizën administrative dhe gjyqësore që i shoqëron normalisht. Specializuar në gazetën le Monde dhe drejtor i gazetës Journal du dimanche, Hervé Gattegno pranoi në fillim të viteve 2000 të punojë pak a shumë si gjyqtar. Ai e linte kartën e tij të biznesit në kutinë e postës së një protagonistit të paarritshëm në telefon me këtë kujtesë të thjeshtë: “Hervé Gattegno dëshiron t’ju dëgjojë.”

Në çështjen Cahuzac (e cila, duhet theksuar, vazhonte nga një hetim i vërtetë i nismës), drejtori i Mediapart Edëy Plenel nuk hezitoi t’i shkruante Prokurorit të Republikës për t’i kërkuar që ai të merrte një aktakuzë plotësuese, në mënyrë që gjyqtari të njihej me faktet e reja të zbuluara nga faqja në internet. Me fjalë të tjera, gazetari nuk është më i kënaqur të ndihmojë shfaqjen e së vërtetës dhe të ndriçojë gjykimin e lexuesve: bëhet, në këtë rast, drejtësi ndihmëse, apo edhe nga policia. Ky pozicion mund të duket i ligjshëm për publikun kur bëhet fjalë për të denoncuar te prokurori një ministër buxheti që mashtron me taksën, si në rastin e z. Jerome Cahuzac. Por a do ta denoncojë nesër gazetari te gjykatësit një kundërshtar politik, një armik personal, një konkurrent në biznes? Për sa kohë që asnjë forcë kundër-pushtet nuk vepron si kundërpeshë për fuqinë e mediave, një pjesë e debatit publik do të varet nga zgjedhja e disa hetuesve që vënë lajmin në dispozicion të tyre; një ndarje e bërë në atë mënyrë që të goditet «atje ku dhemb, me shpresën se do

◀ të ketë më pak dëm, më pak fatkeqësi dhe vuajtje, padrejtësi dhe mjerim, një ditë» (6).

Nëse çdokush ka interes të dramatizojë këtë përballje me gjasë, të supozuar, midis të drejtës dhe të padenjit, duke nisur nga gjyqtarët dhe policia, të cilët e shohin atë si një mjet për të vepruar pa u dukur, askush nuk mund ta mashtrorë veten: duke ndjekur kriteret e veta, prioritetet e tij politike, agjendën e tij ose atë të informatorëve të tij, hetuesi do të vendosë për shembull të botojë dokumentet e sekuestruara gjatë kontrollit të shtëpisë së një personi të shquar që policia nxitoi t'ia përcillte. A do ta shohim, për shembull, jetën private të Z. Jean-Luc Mélenchon, kompjuterët dhe korrespondenca personale e të cilit u kapën në tetor 2018, postuar me lehtësi në prag të një maturie politike? Apo informacionet e mblledhura nga detektivët e Z. Bernard Arnault mbi jetën e deputetit François Ruffin dhe marrëdhëniet e tij me ekipin e Fakir?

E gjitha ndodh sikur disa personazhe të skenës gazetareske të arrinin të ndryshonin rendin e artikujve të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit të vitit 1789, duke kaluar supozimin e pafajësisë (neni 9) pas shprehjes së lirë të mendimeve dhe opinioneve (neni 11). Dhe përsëri: e drejta për informacion nuk figuron aty. Ky nocion, për të gjithë qytetarët, të cilët janë teorikisht përfituesit, përcaktohet vetëm nga profesionistët të informacionit në tekste korporatiste (siç është Deklarata e Detyrimeve dhe të Drejtave të Gazetarëve të Mynihut të 1971-shit) - është përfshirë gjithashtu në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. A i takon vetëm shtypit ta zgjidhë vetëm këtë çështje apo atë të mbrojtjes së intimitetit

Debatë për përdorimin e përgjimeve telefonike nga yjet e hetimit ilustron këtë tension. Si të gjithë ata që punojnë për çështje të ndjeshme, edhe Plenel, atëherë gazetar në gazetën Le Monde, ishte objekti i një përgjimi. Ai e tregoi në një libër këtë provë. «Një dialog në telefon është si një bisedë me veten,» shkruajti ai në librin *Fjalët e vjedhura në (Stock, 1997)*. Nëse bashkëbiseduesi është një njeri intim, ne jepemi, zhvishemi, mendojmë shpejt, flasin shpejt, shprehim atë që nuk mendojmë vërtet, gënjejmë, predikojmë marrëzi, llomotisim kot, e pohojmë si të vërtetë atë për të cilën dyshojmë thellë (...). Ne mendojmë se jemi në shtëpi, të strehuar, në një intimitet mbrojtës.» Njëzet vjet pas shkrimit të këtij teksti të mrekullueshëm dhe të sinqertë, ai kujton nocionin e «interese-

sit publik» për të justifikuar botimin nga Mediapart të te tjera «fjalëve të vjedhura», ato të maxhordomit të Liliane Bettencourt, trashëgimtare e L'Oréal, ose të Z. Alexandre Benalla. Padyshim që zbulimet ngjallin interes publik. Por burimet e tyre nuk janë gjithnjë moralisht aq të patëmeta, sa do t'i dëshironin të ishin, justifikuesit e penës. Gëzimi i egër për të parë rënien e të korruptuarve shpesh çon në pafuqi përballë strukturave korruptive, të cilat mbesin në vend kur njëri ministër ndjek tjetrin. Ne mendojmë se jemi hakmarrë, por asgjë nuk ka ndryshuar (7)

I paraqitur si një shërbim ndaj publikut, një scoop sjell para

Nëse jo, llogaria bankare apo hapësira sociale e mediave e nxorën lajmin. Sepse interesi publik kaq shpesh i përmendu, ruan lidhje të ngushta me interesin privat. I paraqitur gjithmonë si një shërbim për publikun, një scoop shtet të ardhura. Ai bën «lajmin kryesor», nxit emisione televizive dhe radiofonike, zhurmon në rrjetet sociale, shndërrohet në famë, besueshmëri pastaj në shitje, abonime, rritje të tarifave të çmimit të reklamave. Prodhimi aktual i scoop-it u bindet kriterëve ekonomike. Qasja në dokumentet e gjykatës mundëson të fitohet kohë dhe, për këtë arsye, edhe para. Gazetarët - gjykatës që marrin këto pjesë përfitojnë nga hetimet jo vetëm të parapërgatitura, por edhe të parapaguara, pasi procesverbalet që përbëjnë lëndën e parë sintetizojnë hetimet e kryera nga policia dhe drejtësia falë parasë publike. Disa firma që «ia dalin mbanë» përmes rrjedhjeve të lajmit, kapin një formë subvencioni, që varet nga kontaktet e tyre personale që kolegëve të tyre u mungojnë. Rrugët e virtutit dhe lufta kundër shtetit janë përfundimisht dredha-dredha Kjo ekonomi e hetimit ka një efekt të dyfishtë pervers. Gazetarët që pajtohen të krijojnë aleancën mjeko-gjyqësore paguajnë mundësinë e qasjes në dokumente me varësi ekstreme nga burimet. Kur procesverbalet dalin nga avokatët e çështjeve civile, artikujt zakonisht mbrojnë mbështesin, betejat e tyre. Duke pasur parasysh numrin shumë të vogël të magjistratëve, avokatëve dhe policisë që pranojnë të çlirojnë sekretin e hetimit, numri i «gazetarëve të mëdhenj investigues», të përkushtuar ndaj çështjeve të forta gjyqësore, deri më tani është i kufizuar në Francë - rreth 12. Pabarazia e aksesit në informacione të nënkuptuara nga kjo strukturë, gjithashtu, ka një di-

mension ekonomik: pasi që një e katërta e hetuesve mbajnë monopolin e qasjes në dokumentet e udhëzimeve të çështjeve të ndjeshme, të gjithë të tjerët janë të detyruar të marrin përsëri informacionin e tyre, t'i citojnë, dhe kështu të kontribuojnë në promovimin e konkurrentëve të tyre.

Tri dekada pas shpërthimit të saj në zemrën e jetës publike franceze, kjo gazetari që i shndërron disa hetime politiko-financiare në biznes, jo vetëm që prishi lojën demokratike duke zëvendësuar përplasjen ideologjike të partive me spektaklin e një gjykate të virtutit të orkestruar nga media, por, gjithashtu, ndërpreu ekuilibrin e drejtësisë duke futur një shkallë të dytë të gjykimit publik në çështjet civile. I pari, gjyqësori, bazohet në zbatimin e ligjit. E dyta, media, përdor mjetet e së parës por bazohet në moralin e gazetarit-hetues. Ky i fundit shqipton aktgjykimin, verdiktin e tij përpara procesit duke ndikuar domosdoshmërisht në zhvillimin e tij. Për më tepër që procesi paraqet veçantinë e frikshme për të qenë pa apel. Asnjë e drejtë për përgjigje ose veprim juridik nuk është i mjaftueshëm për të fshirë gjykimin e mediave. Kështu, gjatë shtjellimit të çështjes Elf, e cila u zhvillua në gjysmën e dytë të viteve 1990, ish-Ministri i Jashtëm Roland Dumas ishte subjekt i pesëdhjetë e dy kryeartikujve dhe i një kryeartikulli në gazetën Le Monde; ai u pastrua në apel nga të gjitha akuzat, por emri i tij mbeti i lidhur me këtë shpërdorim fondesh.

Padyshim, do të kundërshtojmë ne, po zoti Cahuzac? A nuk është lartësuar morali publik? Këtu prekim kufijtë e «zbulesës». Degëzimet e pazhvilluara të disa çështjeve bartin kuptime më domethënëse sesa ato që kryesojnë në revistën televizive të orës 20. Kur dhe pse thahen papritur burimet institucionale, duke e lënë gazetarin pa prova? Përgjigja është përgjithësisht mjaft e thjeshtë: kur përparimi i hetimit nuk akuzon më një individ të zëvendësueshëm dhe të korruptuar, por vetë sistemin korruptues.

(1) Lire Serge Halimi, «Une icône du journalisme», Le Monde diplomatique, juin 2019.
(2) Cf. par exemple le dossier « Le retour des chasseurs de "unes" », Télérama, Paris, 3 mars 2012.
(3) Éric Halphen, Sept Ans de solitude, Denoël, Paris, 2002.
(4) Cf. Dominique Marchetti, « Les révélations du "journalisme d'investigation" », Actes de la recherche en sciences sociales, no 131-132, Paris, mars 2000.
(5) Cité dans Jean-Marie Charon et Claude Furet, Un secret si bien violé. La loi, le juge et le journaliste, Seuil, Paris, 2000.
(6) Edwy Plenel, Le Journaliste et le Président, Stock, Paris, 2006.
(7) Lire Razmig Keucheyan et Pierre Rimbart, « Le carnaval de l'investigation », Le Monde diplomatique, mai 2013, et Denis Robert, Pendant les « affaires », les affaires continuent, Stock, Paris, 1996.



Deputeti dhe jahti i tij

Një koncensionar i pasur nga Florida (SHBA), Z. Vern Bushaman, bleu një jaht të shtrenjtë që kushtoi miliona dollarë, pikërisht ditën kur votoi në Kongres ligjin për uljen e taksave për shtresën me të ardhura të larta. Që nga ajo ditë ky republikan konsiderohet si mishërimi i gjallë i korupsionit tek disa individë të zgjedhur në poste shtetërore. Kundërshtarët e tij i kanë realizuar një karikaturë ku shfaqet me një kasketë prej marinari mbi kokë. Kjo çështje është botuar në gazetën prestigjioze "New York Times" («With \$30 Million, obscure Democratic group floods the zone in House races», më 31 tetor 2018).

Drejtuesit blihen që c'ke me të!

Prej kohësh, Shtetet e Bashkuara zënë vendin e parë në lidhje me financimet private dhe shpenzimet e shumta për fushatën e zgjedhjeve të përgjithshme. Ky rekord u arrit të njëjtoherë nga India, ku shpenzimet për zgjedhjet legislative të vitit 2019 arritën shifrën prej 8,7 miliardë dollarë (afërsisht 7,8 miliardë euro), ndërsa në zgjedhjet e 2016-ës (presidenciale dhe Kongresi), kandidatët amerikanë shpenzuan 6,5 miliardë dollarë (5,8 miliardë euro).

Ia vlen të jesh i pasur!

Sipas gazetës The Economist (10 nëntor 2018), miliarderi Jay Robert Pritzker për t'u zgjedhur guvernator i Illinoisit, shpenzoi për fushatën, shumë modeste prej 170 milionë dollarësh. Ndërsa të gjithë kandidatët francezë në fushatën për zgjedhjet presidenciale të 2017 shpenzuan 74,1 milionë euro...fukarallëk...

Nëse s'ka para, atëherë s'ka debat!

Në Shtetet e Bashkuara, komiteti demokrat vendosi që kandidatët që do të merrnin pjesë në raundin e parë të debateve në shtator të 2019 duhej të përmbushnin dy kushte: 1-të paraqesnin një sondazh ku të tregonin se mund të fitonin të paktën 2% të votave në zgjedhjet presidenciale. 2-të kenë 130 000 donatorë.



Foto nga Martin Lopez nga Pexels

Kandidatët e eleminuar në Senegal

Dy kandidatët që merrnin pjesë në zgjedhjet presidenciale të Senegalit në shkurt të vitit 2019, MM.Khalifa Sall dhe Karim Wade, u akuzuan dhe u ndoqën penalisht për përfitim të parave publike dhe për pasurim të paligjshëm. Pabarazia e këtyre procedurave që i penguan të marrin pjesë në votime, që u fituan nga presidenti në ikje Macky Sall, u vu në pikëpyetje nga Amnesty International.

«Khalifa Sall, drejtuesi i opozitës dhe njëkohësisht kryetar bashkie i Dakarit, i arrestuar në mars të vitit 2017, u akuzua për bashkëpunim me keqbërësit, pjesëmarrje dhe përdorim të dokumentave të falsifikuara për përfitime private në tregti, falsifikim të dokumenteve administrative, si dhe për përfitime personale dhe abuzime me paratë publike si dhe krim ekonomik.

Lirimi me kusht i ëshë refuzuar disa herë. Ai u zgjodh në parlament në korrik të vitit 2017, ndërkohë që ishte në burg. Në qershor të vitit 2018 Gjykata e Komunitetit ekonomik të Vendeve të Afrikës Perëndimore vendosi se mbajtja në burg e Khalifa Sall-it ishte arbitrare, dhe se të drejtat e tij për të fituar statusin e të pafajshmit, imunitetin parlamentar dhe të drejtën për të pasur avokat ishin përcmuar.

Në mars të vitit 2015, Gjykata që shqyrton pasurimin e paligjshëm e dënoi Karim Wade, ministër i dikurshëm dhe djali i ish-presidentit të Republikës Abdoulaye Wade, me 6 vjet burg dhe një gjobë prej 210 744 000 eurosh për pasurim të paligjshëm... «Kjo gjykatë nuk i respekton normat ndërkombëtare dhe zonale në lidhje me barazinë e proceseve gjyqësorë, dhe në veçanti lidhur me faktin se vendimet e saj nuk mund të apelojnë. Komisioni afrikan i të drejtave të njeriut dhe të popujve e konsideron faktin se e drejta për të apeluar një vendim tek një instancë juridike më e lartë është një nga elementët thelbësorë të një procesi të barabartë dhe të drejtë. Në prill të vitit 2016, grupi i punës i Kombeve të Bashkuara që shqyrton burgosjet arbitrare e konsideroi burgosjen provizore të Karim Wade si arbitrare, sidomos për arsye të vonësive gjatë procedurës dhe mënyra e ndryshme e trajtimit të këtij rasti. Karim Wade u lirua në qershor të vitit 2016 falë amnistisë së presidentit.

Amnesty International, «Senegal: All talk. No action», 9 gusht 2018. Raporti i drejtohet sesionit të 31-të të raportit periodik universal, Kombet e Bashkuara, nëntor 2018.



Afrikë

Ruanda, gjenealogjia e genocidit

NGA PHILIPPE LEYMARIE

Lufta e ngjeshur e kujtimeve mbi «çështjen franceze», në lidhje me genocidin në Ruanda, në vitin 1994 – ku tetëqind mijë Tutsis u shfarosën në afro njëqind ditë – ka të bëjë me një mënyrë thelbësore me operacionin ushtarak «guri i cmuar» (turquoise), të nisur tre muaj pas fillimit të masakrave. Edhe sikur Franca të ketë qenë e autorizuar nga Këshilli i sigurisë së Kombeve të Bashkuara, veprimet e saj mbeten sërisht të paqarta: Të ketë pasur vallë vetëm qëllime humanitare, ashtu siç dhe është deklaruar me ngulm, apo bëhej fjalë për Parisin, që të paktën në një fazë të parë të fshihnin gjurmët, të mbronin shkatarrët e vjetër të genocidit dhe të nxirnin jashtë loje agjentët e infiltruar?

Pas shumë të tjerëve, Laurent Larcher shtron pyetjen sesi Franca është akuzuar se ka mbështetur vrasësit dhe si ka mundur që njëzet e pesë vjet më vonë është akoma e pamundur të kemi zemrën e pastër.⁽¹⁾ Historian me profesion, ky gazetar i La Croix, ka kërkuar përgjigjet tek afro 30 dëshmitarë dhe personazhe të viteve 1990 – ministra të dikurshëm, ish-shefa ushtarakë, gazetarë, kërkues, vullnetarë -, deklaratat e të cilëve janë ritranskriptuar ashtu siç janë marrë, në emër të «së vërtetës të vërtetës».

Të gjithë vazhdojnë të debatojnë edhe sot në një «labirint», shpjegon Larcher, pasi kjo odise e zhurmshme në kujtesën e francezëve «të çon në buzë të greminës», ndërkohë që lindin shumë versione të tjera ku janë përfshirë ata që kanë marrë vendime, ushtarakë, apo dhe shërbimet sekrete. Autori, që e pranon se ka treguar hapur subjektivitetin e tij, shqetësohet për faktin se disa nga këta «debutuesit vizionarë» qëndrojnë akoma të mbërthyer në tezat e tyre të vjetra, cilatdo qofshin dëshmitë apo dokumentet që kundërshtojnë këto teza.

Megjithatë, nëse hyrja në arkivat zyrtarë

francezë në lidhje me këtë dramë ka qenë për një kohë të gjatë e pamundur për shkak të sekretit ushtarak, Marion Vejsjer (Marion Veysiere), përgjegjëse e departamentit të drejtësisë dhe ruajtjes së Arkivave kombëtarë, na kujton në një libër kolektiv (1), se më urdhër të presidentit Fransua Hollonde, më 2015, 97% e dokumenteve të identifikuar si shumë të rëndësishëm në grumbullin e arkivave presidenciale të presidentit Miteran, - mundën të deklasifikoheshin, edhe pse për publikun e gjerë ngelën sërisht konfidenciale.

Historiani Florent Piton në një libër të tijin, të mbështetur në argumente të forta, ka ndërtuar gjenealogjinë e konfliktit ruandez, që në kohën e monarkisë së vjetër tutsi deri në «Hutu power», dhe shfarosjen e Tutsis. Gjithmonë, sipas tij, ky konflikt nuk ka qenë as aksident dhe as rezultat i një urrejtjeje atavike, por ka qenë produkt i një racizmi modern, i menduar mirë, i planifikuar, dhe i mirorganizuar.

kombëtar që i tejkalon masakrat duke përdorur atë që autori e quan «një kredit genocidi» për t'i vënë kapakun debatit politik. Pitoni, i cili na sinjalizon se ka marrë mbështetjen e Komisionit kombëtar të luftës në Ruanda kundër genocidit, nuk e anashkallon çështjen tutsi në shkallë zone, as rolin e ushtarëve ruandezë në luftë, dhe plaçkitjen e Kongos dhe as tensionet midis të shpëtuarve të kthyer në vend.

Ky konflikt nuk ka qenë as aksident dhe as rezultat i një urrejtjeje atavike, por ka qenë produkt i një racizmi modern, i menduar mirë, i planifikuar, dhe i mirorganizuar

- Florent Piton


Ndërsa Charl Habonimana ka shkruar «kujtime të paharrueshme»: në moshën 12 vjeçare gjatë genocidit, duhej të ishte vrarë kur të mbaronte «puna» në krahinën e tij, por ndryshe nga familja e tij dhe gjithë Tutsit e fshtatit të tij, ai arriti të shpëtonte falë disa rastësive të njëpasnjëshme. (1). Njëzet vjet më pas, ai vazhdon të ngrejë zërin në konferencat e zhvilluara në Shtetet e Bashkuara, në Evropë, në Francë. Vendi i fundit, shkruan ai, «i ka vendosur të gjitha genocidet e ndodhura në programet e librave shkollorë, por e ka kaq të vështirë për të shkruar aty – ashtu siç ka bërë edhe me genocidin e çifutëve në Evropë – përgjegjësia e tij, ajo e shtetit, lidhur me genocidin ushtarak ndaj popullsisë Tutsi të Ruandës».

(1) Laurant Larcher, *Rwanda, ils parlent. Témoignages pour l'histoire*, Seuil, Paris, 2019, 800 pages, 24,90 euros
(2) Olivier Forcade et Sébastien-Yves-Laurent (sous le dir. de), *Dans le secret du pouvoir. L'approche française du renseignement, XVII-XXI siècle*, Nouveau Monde, Paris, 2019, 560 pages, 25 euros
(3) Florent Piton, *Le génocide des Tutsi du Rwanda. La découverte*, Paris, 2018, 248 pages, 18 euros
(4) Charles Habonimana, *Moi, le dernier tutsi*, Plon, Paris, 2019, 304 pages, 17,50 euros.

KUSH PËRFITON NGA LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT?

Si në rastin kur flitet për të ndryshuar ligjin apo për të blerë vota, korrupsioni përbën një nga format e shprehjes më brutale të pushtetit të të fuqishmëve. Gjithsesi, po objektivat e atyre që luftojnë kundër kësaj fatkeqësie të madhe janë gjithmonë aq fisnike sa ç'pretendojnë të jenë? Në Brazil, akuzat e shumta që u hodhën shpesh nëpër media, bënë të mundur burgosjen pa prova të presidentit të mëparshëm

Luiz Injacio "Lula" da Silva. Në Rusi apo dhe në Indi operacionet "duart e pastra" i mundësuan sidomos pushtetit që të hiqte qafe kundërshtarët që i shkaktonin turbullira. Cilat janë motivimet e informatorëve dhe ato të një shtypi që shfaqet gjithmonë e më pak i pa interesuar sesa duket? Përfundimisht, a mjafton fryma e moralit për të udhëhequr aksionin politik?



Vendet me politikanët, zyrtarët, dhe shoqata që përmenden në dokumentet e "Panama Papers", 2016

Ta qortojmë apo ta ndryshojmë botën?

NGA BENOIT BRÉVILLE DHE RENAUD LAMBERT

Në vitin 2017, në Francë, z. Fransua Fijo, kandidati i republikanëve, pa të veniteshin mundësitë e tij për t'u futur në Elysée, kur u hap një hetim ndaj bashkëshortes së tij, e akuzuar se kishte përfituar vende pune fiktive. Në vitin 2018, drejtësia braziliane hodhi dyshime mbi shefin e dikurshëm të shtetit, Luis Injacio "i ashtuquajtur "Lula" da Silva, se kishte përfituar mitmarrje, dhe e pengoi që të merrte pjesë në zgjedhjet presidenciale. Në vitin 2019, presidenti i mëparshëm i Asamblesë kombëtare franceze, Fransua de Rygi dha dorëheqjen nga posti i ministrit të ekologjisë kur në shtyp dolën të dhëna se ai i kishte gostitur me karavidhe dhe verërat më të shtrenjta të afërmit e tij me shpenzimet e shtetit...

Nga Parisi në Brazilia, nga Londra në Seul, jeta politike zjen nga "çështjet" tronditëse. Fatkeqësia e madhe – që papa Françesku e konsideroi së fundmi si "kancer" të shoqërive moderne(1) – ngriti aq shqetësime, sa që çdo 9 dhjetor, nën shtysën e Kombeve të Bashkuara, planeti feston Ditën ndërkombëtare të luftës kundër korrupsionit... dy ditë pas asaj të avionit civil dhe dy ditë para festës së malit.

Nëse dënimi i këtij fenomeni u bë unanimisht, ky term bie në sy nga paqartësia e tij. Studjuesja Anastasija Zaganova nënvizon se ky fenomen shpreh, në të njëjtën kohë, "shkelje penale, duke përkufizuar një sjellje të caktuar dhe sanksionimin e saj (korrupsion aktiv dhe pasiv, ndërhyrje, shpërdorim fondesh, cënim të barazisë së mundësive në tregjet publike" dhe të "sjelljes sociale të diskutueshme), por mënyra e sanksionimit ngelet e paqartë (lobingu, evzacioni fiskal, krijimi i shoqërive fantazëm offshore, raste të punësimit të një funksionari të lartë nga sektori publik në atë privat, etj)" (2).

Në Shtetet e Bashkuara një ndërmarrje që synon të ndikojë në zgjedhjet e një kandidati nuk ka nevojë të paguajë fshehtas nën dorë. Që në janar të vitit 2010 dhe me vendim të "Citizens United v. Federal Election Commission", hartuar nga Gjykata e Lartë, asaj i mjafton të subvencionojë shoqatat e lidhura me përkrahësin që ajo do të mbështesë në mënyrën më të ligjshme në botë dhe pa caktuar një tavan të shumë. (lexoni "Dikush me të vërtetë i poshtë", faqja ..).

Në shumë vende një praktikë e tillë është e ndaluar; përtej Atlantikut flitet për...lirinë e shprehjes. Sipas një raporti të Sunlight Foundation, midis viteve 2007 – 2012, dyqind ndërmarrjet amerikane më aktive politikisht kanë harxhuar në nivel federal 5,8 miliardë dollarë shpenzime të këtij lloji. Në të njëjtën periudhë, ato kanë marrë afërsisht 4400 miliardë dollarë si dhurata të ndryshme: subvencione, përjashtim nga taksat, ulje e taksave (3).

Ndryshim i ligjit më shumë sesa sjelljet e tij: kjo lloj metode josh. Multinacionalet amerikane që kërkonin të vendoseshin në vende të varfra janë të autorizuar të bëjnë "pagesa lehtësimi" për të përshpejtuar një procedurë, për të marrë një autorizim, për të kaluar një dosje mbi pargun e të tjerave. Nga ana e tyre, të gjykuarit me fat mund t'i japin fund ndjekjes ligjore për të cilën janë bërë objekt, duke i dhënë para palës kundërshtarë. Kufiri i paqëndrueshëm midis korrupsionit dhe praktikave ligjore duket, pra, sikur i është nënshtruar të papriturave të drejtësisë dhe të logjikës që shërben si bazë në përpunimin e futjes së

këtyre praktikave për sunduesit në mënyrë ligjore duke garantuar ashpërsinë më të madhe për shkeljet e klasave popullore.

I ndryshueshëm sipas pikave të globit dhe hierarkive shoqërore, vëmendja kushtuar këtij fenomeni tjetërsohet me kalimin e kohës. Midis viteve 1981 dhe 1990, gazetatat Le Figaro, Le Monde, dhe Liberation botuan 2630 artikuj që trajtonin në një mënyrë apo në një tjetër korrupsionin. Dhjetë vjet më vonë, kjo shifër u katërfishua.

Një epidemi shkeljesh ka rënë në të gjithë botën? Në një material botuar në vitin 2004 studiuesit Katherine Fieski dhe Pol Hejud sjellin një tjetër shpjegim: shndërrimi i debatit politik shkak-pasojë, shembi sistemin komunist në fillim të viteve 1990. "Palët", betejat elektorale të cilave organizoheshin dje rreth objektivave ideologjike, por që kishin të njëjtat praktika në fushën e korrupsionit, iu desh të ndryshonin taktikë. Programet e së majtës dhe të së djathtës filluan të ngjasonin ndërsa urgjenca për të shfaqur aftësinë, me të ardhur në pushtet, bëhej përcaktuese.

Konkurenca politike ka çuar në braktisjen e debateve thelbësore për t'u marrë me akuzat për korrupsion, të destinuara për të njolltur njolllos kreditet e kundërshtarit (5). Ky evolucion ka qenë një e mirë e papritur për mediat e mëdha. Të kundërshtuara për gatishmërinë e tyre për të përfaqësuar preferencat e elitave, ato gjejnë tek "këto çështje" mjetin për të praruar emrin e tyre të mirë: meqë zbulojnë punët e fëlliqura të të fuqishmëve, janë media të lira. (Lexoni artikullin e Pjer Pean faqe ... dhe...).

Nxjerrja në pah e temës së korrupsionit në vitet 1990 shkon njëkohësisht me një lëvizje ideologjike akoma më të thellë. Modeli politik alternativ i përfaqësuar nga blloku lindor i zhdukur, dhe shpërblimi perëndimor sipas promotorëve, po ngelet e vetmja mundësi, si mishërim i arsyes. Në korridoret e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës botërore po shfaqet tema e "qeverisjes": ideja e një qeverisjeje teknike, e drejtuar nga ekspertë që punojnë për të mirën e përbashkët. Kështu, për vendet e jugut ashtu si dhe për ata të bllokut komunist konvertimi në ekonominë e lirë ose në kapitalizëm nuk është më një zgjidhje politike, por një kërkesë e domosdoshme e një administrimi të mirë. Konkurenca politike ka çuar në braktisjen e debateve thelbësore për t'u marrë me akuzat për korrupsion, të destinuara për të njolltur kreditet e kundërshtarit (5). Ky evolucion ka qenë një e mirë e papritur për mediat e mëdha. Të kundërshtuara prej gadishmërisë së tyre për të përfaqësuar preferencat e elitës, ato gjejnë tek "këto çështje" mjetin për të vënë në vend sërish emrin e tyre të mirë: meqë nxjerrin në pah punët e fëlliqura të të fuqishmëve, pra qenkan media të lira (lexoni artikullin e Pjer Pean faqe .. dhe ..).

Mjaft i dëmshëm për ndërmarrjet që duan të vendosen në vendet në zhvillim, korrupsioni përqëndron flakën e institucioneve neo-liberale, që identifikojnë shumë shpejt rrënjën kryesore: mungesën e shkëmbimit të lirë. "Duke fryrë çmimin e të mirave më shumë se ai i tregut, shpjegon studiuesi Strom C. Thacker, pengesat në tregti mund t'i shtyjnë drejtuesit e ndërmarrjeve të paguajnë mitmarrje për të përfituar ndonjë përjashtim (nga taksat) apo të bëjnë një marrëveshje në favor të tyre." Liberalizimi dhe lufta kundër shkeljeve: organizatat ndërkombëtare shumë shpejt do të kushtëzojnë ndihmat e tyre financiare në lidhje me këto dy probleme urgjente. Të kudondodhura, sapo bëhet fjalë për të matur fenomenin e korrupsionit, organizata jo qeveritare OJQ, Transparency International – themeluar dy vjet pas shkrirjes së Bashkimit Sovjetik, nga një anëtar i vjetër i Bankës Botërore – është e mendimit se shpërdorimet prekin vetëm sektorin publik. Si rregull, ndërmarrjet do të ishin të mbrojtura.

Do të argumentojmë se Meksika e viteve 1980 dhe Rusia e dhjetëvjeçarit që vijoi treguan se sundimi i tregut – dhe privatizimi që ai kërkon – i njohin mirë marrëveshjet e fsheh-

Shumëfishimi i skandaleve duket sikur arriti të bindë një pjesë të së majtës se bota nuk do të funksiononte kaq keq nëse do të arrinim të shkulinim nga rrënjët mashtrimin, hilen dhe korrupsionin. Duke këmbyer objektivat e tyre politike për të tjera objektiva morale, këta militantë u metamorfizuan


ta, rryshfetet dhe korrupsionin. Por, pak rëndësi ka për ata që bashkë me Frensis Fukajaman mendojnë se shkrirja e bllokut sovjetik shënoi dhe fundin e historisë. Në tregimet e tyre, busullat nuk janë më politike, por morale. Sigurisht që elitat ruajnë preferencat e tyre ideologjike, por ato i formulojnë duke i nxjerrë nga regjistri i virtutit. Dje flisim për kapitalizmin? Shumë shpejt do të flitet për liri ekonomike. U bënë ndërhyrje në Grenad për të luftuar kundër kërcënimit komunist? Do t'i çojnë trupat e tyre në ndihmë të të drejtave të njeriut.

Kështu, në Brazil e majta nuk duket më si një kundërshtarë elektorale, por si një armike, opsionet politike të së cilës kërcënojnë ndershmërinë e përgjithshme. Dy universitarë llogariten se 95 % e artikujve që trajtonin korrupsionin një natë para zgjedhjeve presidenciale të vitit 2010 dhe 2014 i përkisnin partisë së punëtorëve dhe 5% Partisë social-demokrate braziliane, një grupim konservator i identifikuar si "institucioni elektorale" më i fëlliqur në vend në këtë periudhë. Një mbulim i tillë çon pak nga pak në bashkëngjitjen e shpërdorimeve jo më me personalitete politike, por me rrymat me të cilat ato janë lidhur. Ky lloj mbulimi fton në përzjerjen e shumave të stërholluara nga drejtuesit e paskrupullt dhe të pandershëm me ato që kanë të bëjnë me ngritjen e nivelit të jetesës së më të varfërve, të cilët akuzohen për plogështi. A nuk bëhet fjalë si në njërin rast ashtu dhe në tjetrin për një funksion të padrejtë – pra "immoral" – të pasurisë kombëtare? Presidenti i ri i ekstremit të djathtë Jair Bolsonaro mund të premtojë se do të luftojë korrupsionin duke spastruar Brazilin nga "veset morale dhe ideologjike" që ai ia bashkangjit Partisë së punëtorëve.

Mafiet e rërës

Në Shtetin e Tamil Nadu-së (në Indi), rëra e plazhit përbëhet nga minerale shumë të kërkuara, si garneti, ilmeniti, rutili, zirconi, silikati, leukokseni apo dhe monaziti (një mineral radioaktiv që përmban uranium dhe torium). Prej vitesh, mafia të vërteta bëjnë ligjin në këtë sektor, zbuloi qendra i investigimit të «Radio Francë» dhe të faqes «Forbidden Stories». Hetimi i nisur dhe i shpërndarë nga «Francë Info» (22 qershor 2019), solli përvojën e gazetares Sandhya Ravishankar, e cila nuk u la rehat: «Mafia e rërës ka lidhje me drejtues politikë, me policë dhe funksionarë që ndodhen në gjirin e shtetit. Sapo ju i ngacmoni, ata nuk ju mbajnë më!»

Një tjetër gazetar, Sandeo Sharma, 35 vjeç, i cili interesohej dhe ai për mafian e rërës, por në Shtetin e Madhya Pradeshit, vdiq i shtypur nga një kamion më 26 mars 2018. «Sipas Komitetit për mbrojtjen e gazetarëve, ai hetonte për llogarit të kanalit televiziv indian News Word», saktëson «France Info», duke shtuar se një tjetër hetues, Jagendra Singh, kishte gjetur vdekjen, i djegur për së gjalli.



Shumëfishimi i skandaleve duket sikur arriti të bindë një pjesë të së majtës se bota nuk do të funksiononte kaq keq nëse do të arrinim të shkulinim nga rrënjët mashtrimin, hilen dhe korrupsionin. Duke këmbyer objektivat e tyre politike për të tjera objektiva morale, këta militantë u metamorfizuan.

Dje ata luftonin: që sot e tutje ata indinjohen. Ata krijonin organizata për të marrë pushtetin në dorë. Ja tek janë tek nënshkruajnë peticione, duke urdhëruar botën që të tregohet më e dashur, më tolerante, më pak raciste, më e gjelbër, dhe më e barabartë. Zo-

tin de Rygi nuk e shqetësojnë fare këto gjëra sepse ka qenë ministër i mjedisit në një qeveri që e rëndoi krizën klimatike duke promovuar këmbimin e lirë, sepse ai do të pajisej me një tharëse flokësh shumë të shtrenjtë. Dhe meqë morali na detyron të zbatojmë vetë atë që presim ta bëjnë të tjerët, më e rëndësishmja nuk është më që t'ia arrish qëllimit, por të tregohesh i drejtë, i saktë, i paanshëm dhe i sjellshëm.

Ndjekim disa pasoja mbi organizimin e betejave politike, siç e tregon dhe një seancë formimi përgatitur nga Konfederata e përgjithshme e punës për përfaqësuesit e personelit të zgjedhur në mes të këtyre rangjeve në vitin 2014. Një grua e re, kandidate rishtare, punonjëse në një hotel të madh u ftua që të merrte fjalën për të shpjeguar konceptimin e saj për luftën sindikale: «Për mua më e rëndësishmja është të mos e zgjedh grupin e a saj në mënyrë sistematike dhe të tregohem e paanshëm.» "Mos thuaj gjëra pa kuptim, i përgjigjet formatuesi i CGT-së. Ti mendon se në rast konflikti, drejtoresha jote e burimeve njerëzore do të kërkojë se çfarë është e drejtë dhe e paanshme? Politika është një kamp kundër një kampi tjetër: I yti, meqë je sindikaliste, është kampi i të punësuarve."

Sankylotët, komunarët apo dhe manifestuesit e vitit 1936 nuk luftonin kundër korrupsionit, por kundër pushtetit të parasë. Ata nuk u nxitën nga dëshira për t'u treguar ekzemplarë, por u shtynë nga vendosmëria e tyre për të arritur fitoren e çështjes. E majta nuk ka lindur për të qortuar vazhdimisht botën, por për ta ndryshuar atë.



Brazil, misterit i një grushti shteti juridik

Shkarkimi i presidentes braziliene Dilma Rusef në vitin 2016, procesi me një spektakël të madh i burgosjes në vitin 2018 i Luiz Inacio "Lula" da Silva, u ngritën mbi të njëjtin motiv: lufta kundër korrupsionit. Një numër i madh vëzhguesish e kanë miratuar këtë fshesë të dhënë në emër të drejtësisë republikane. Por mund të dallohet se është fjala për një grusht shteti juridik nga i cili përfitoi ekstremi i djathtë.

NGA PERRY ANDERSON*

*Historian dhe profesor në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxelos. Një version i këtij artikulli është botuar në *London Review of Books* (më 7 shkurt 2019).

Operacioni «Lava Jato» («larje me presion të lartë»), që lidhet me skandalin më të madh të korrupsionit në historinë e viteve të fundit në Brazil, shpërtheu në mars të vitit 2014. Ky operacion drejtohej nga gjykatësi Sergio Moro, që kishte marrë emër tashmë që në 2005 si asistent në një çështje shumë të përfolur në media: skandali kishte të bënte me dhënien e parave nga ana e Partisë së Punëtorëve në këmbim të mbështetjes së tyre.

M. Moro përshkroi mënyrën e tij të proceduarit në një artikull të botuar në mes të viteve 2000. Kjo mënyrë konsiston në imitim të procedurave të përdorura gjatë operacionit «Mani pulite», «Duar të pastra», e cila, në fillim të viteve 1990, kishte shpartaluar partitë qeverisëse italiane, duke afruar fundin e Republikës së Parë. Në shkrimin e tij, Z. Moro nënvizon rëndësinë e dy aspekteve të kësaj metode: kërkesa për dënime parandaluese për të nxitur spiunimin; si dhe ikje nga shtypi, të kalibruara për të ngjallur zemërimin e opinionit publik dhe për të vënë nën presion të dyshuar dhe institucione.

Në sytë e tij, një vënie në skenën mediatike ka më shumë rëndësi sesa hamendësimi i pafajësisë. Gjatë çështjes «Lava Jato», gjykatësi brazilian zbuloi talentet e fshehura organizuese. Arrestime të bujshme, nga ato që tërheqin vëmendjen e njerëzve, rrëfime, telefonata që iu bënë organeve të shtypit dhe kanaleve televizive duke garantuar në çdo etapë një mbulim të gjerë të operacioneve që ai drejton.

Njëra më dramatike se tjetra, këto arrestime u emërtuan dhe u pajisën me një emër kodit të huazuar nga imagjinata kinematografike, klasike apo biblike: «Dolce vita», «

Casablanca», «Aletheia», (që do të thotë «vërtetë» në greqishten e vjetër), «Gjykimi i fundit», «Omerta», «Abnyss», etj. Italianët u mburrën se kishin një dell të lindur spektakli? Z. Moro i bëri të duken si amator. Gjatë një viti, ndjekjet patën në shënjestër drejtues të vjetër të shoqërisë kombëtare të naftës, Petrobas, të cilët akuzohen se kanë qenë të shitur, para se të provokonin rënien e kuadrit të parë të rëndësishëm të PT (thesarmbajtësi i tij, Z. Jao Vaccari Neto), dhe drejtuesit e dy shoqërive të mëdha të ndërtimit dhe të punëve publike (BTP) të vendit Odebrecht dhe Andrade Gutierrez.

Manifestimet në mbështetje të Z. Moro u bënë akoma më të fuqishme: duke kërkuar ndërkimim e PT dhe ikjen e presidentes Dilma Rusef, duke e vendosur kështu Kongresin nën presion. Nuk i duhet asgjë më tepër presidentit të Asamblesë kombëtare Eduardo Cunha që të vendosë në rend të ditës shkarkimin e presidentes. E izoluar dhe e dobësuar Znj. Rusef thërret në ndihmë presidentin e mëparshëm Luiz Inacio të njohur si «Lula» da Silva. Ky i fundit shpaloj gjithë njohuritë e tij prej negociatori për të rregulluar marrëdhëniet me aleatin e tij të vjetër, Partinë e Lëvizjes Demokratike braziliene. Z. Cunha, që mesa duket ka vendosur shumë milionë dollarë në llogaritë sekrete në Zvicër, propozon një pakt për mbrojtje të dyanshme: ai do të ndërpresë të gjitha përçapjet e tij kundër Znj. Rusef nëse qeveria i bënte atij një favor. «Lula» e urdhëroi shprehimisht presidenten të pranonte politikën e pajtimit; ajo nuk pranoi e mbështetur dhe nga drejtuesit kombëtarë që kanë frikë se mos marrëveshja zbulohet. Deputetet e Partisë Punëtorë (PT) mbështesin përpjekjet kundër Z. Cunha, i cili përgjigjet duke filluar procedurën e shkarkimit.

Nga ana e tij, Z. Moro përgatit goditjen e



Ignazio da Silva Lula © Midia Ninja

Lula» u arrestua në bazë të dyshimeve për korrupsion, dyshime të cilat lidheshin me përfitimin e një apartamenti buzë detit, por që nuk mundi kurrë të ishte pronari i tij ligjor, I gjykuar në Kuritiba, verën që shkoi, ai u dënua me nëntë vjet burg

fundit. Në fillim të muajit mars 2016, ai nis operacionin «Aletheia». «Lula» del që në mëngjes para kamerave, dhe media, i lajmëruar më parë prej tyre. Presidenti i dikurshëm dyshohet se ka përfituar nga bujaria e Odebrecht-it. Të tjera kthesa vijojnë. Z. Moro përgjigjet dhe shpërndan për shtyp një bisedë telefonike midis zonjës Rusef e Lula, të cilën ai e ka regjistruar. Dy drejtuesit diskutojnë mundësinë për këtë të dytin që të bëhet shef kabineti. (ekuivalenti brazilian për postin e kryeministrit). Meqë funksionarët e rangut ministror dhe anëtarët e Kongresit gëzojnë një imunitet që vetëm Gjykata e Lartë mund t'ua heqë, askush nuk dyshon se kjo është një dredhi për t'i shpëtuar arrestimit. Dy gjykatës të Brasiliës dalin kundër emërimit të tij; i pari është një njeri i mësuar me qortimet e ashpra kundër Partisë Punëtorë në Fb; ndërsa i dyti, një borxhli i Partisë Social-demokrate braziliene, që është kundër pushtetit.

Presioni që vinte nga manifestuesit në favor të shkarkimit të presidentit arriti kulmin e tij. Në Asamble nuk ka asnjë lloj shenje që të tregojë se është arritur shumica me 2/3. Aksione të reja zbuluan shënime të Odebrecht-i ku shiheshin qartë shumat e derdhura që shkonin tek 200 personalitete nga të gjitha partitë. Në klasën politike të gjitha sinjalet ishin të kuqe. Një operator i rangut të parë në gjirin e PMDB u regjistrua pa dijeninë e tij kur i thoshte një kolegu se «duhej të ndryshonin hemoragji, gjakderdhje». «Ata tipat e Gjykatës së Lartë» i thanë se kjo dukej e pamundur për aq kohë sa Znj. Rusef ishte në pushtet, pasi mediat ishin radhitur kundër saj. Nuk ka ndonjë mundësi tjetër, shpjegon ai, duhet ta zëvendësojmë sa



Ish-presidentja Dusef dhe Lula © Agência Brasil / ABr

Kur një nga gjykatësit e institucionit e informoi se parimi i së drejtës civile kërkonte që ai të lironte një drejtues të Petrobasit, Z. Moro u kthye nga shtypi duke deklaruar se, në këtë rast, do t'i duhej të lironte dhe trafikantët e drogës

më shpejt që të jetë e mundur me presidentin e Senatit, Z. Mishel Temer dhe të formojmë një qeveri të komitetit kombëtar të mbështetur nga Gjykata dhe ushtria. Në më pak se dy javë, Asambleja aprovoi shkarkimin e presidentit, duke i lënë hapësirë të lirë Z. Moro që të heqë qafe Z. Cunha, i cili, tashmë, nuk i duhej njeriu. I përjashtuar shumë shpejt edhe nga Asambleja, ky i fundit përfundoi në burg. Senati konsideroi të vlefshëm shkarkimin e presidentit dhe Z. Temer mori drejtimin e vendit.

Në fillim të viteve 2017, «Lula» u arrestua në bazë të dyshimeve për korrupsion, dyshime të cilat lidheshin me përfitimet e një apartamenti buzë detit, por që nuk mundi kurrë të ishte pronari i tij ligjor, i gjykuar në Kuritiba, verën që shkoi, ai u dënua me nëntë vjet burg. Pas gjykimit në apel, dënimi shkoi në 12 vjet. Presidenti i parë i zgjedhur nga radhët e Partisë punëtore pas hekurave, dhe e dyta, e shkaruar me qendrësishme: fundosja e partisë duket se do të jetë totale.

U shfaqën dy analiza të gjykatësve. Analiza e parë i përshkruan si mbrojtës të caktuar për të shfarosur korrupsionin; ndërsa e dyta i përshkruan si operatorë politikë gati të bëjnë gjithçka për t'ia arritur qëllimeve të tyre. Në librin *O Lulismo em crise* (Companhia Das Letra 2019) sociologu brazilian Andre Singer i hedh poshtë që të dyja këto analiza. Sipas tij, gjykatësit janë treguar tërësisht republikanë dhe, në mënyrë të pamohueshme, kundërshtarë. Republikanët: si mund të përshkruhet ndryshe burgosja e shefave të ndërmarrjeve më të pasura dhe më të fuqishme të vendit? Kundërshtarët: çfarë kuptimi tjetër mund t'u jepet ngacmimit sistematik të anëtarëve të Partisë Punëtore në kohën kur anëtarët e partive të tjera nuk ishin prekur fare – përveç z. Cunha, që ishte bërë shumë i mërziqshëm? Pa folur këtu për afrinë politike të gjykatësve, sharjeve që ata kishin shkruar në FB apo fotografive ku shihen duke qeshur dhe duke vënë në dukje emblemat e partive konservatore. Ngrihet një pyetje: republikanë dhe kundërshtarë, a kanë qenë këta gjykatës në proporcione të barazvlershme? Në sistemin juridik brazilian, policët, prokurorët dhe gjykatësit formojnë një trupë të pavarur nga njëri-tjetri. Policia mbledh provat, prokurorët lexojnë pretendencën dhe gjykatësit vendosin dënimin (në Brazil anëtarët e gjyqit ndërhyjnë vetëm për vrasjet).

Gjithsesi, në praktikë, të trija këto funksione u shkrinë me njëri-tjetrin në rastin e operacionit «Lava Jato». Policia dhe prokurorët punonin nën mbikqyrjen e gjykatësve që kontrollonin hetimet, vendosnin dënimet dhe i shpallnin: një mohim i dukshëm i mekanizmave bazë të drejtësisë, që parashikojnë ndarjen e akuzës nga pjesa që jep dënimin (pa përmendur faktin se gjykatësi Moro ka një anë kundërshtuese kryesore të parimit mbi hamendësimet e pafajësisë).

Një tjetër spitullim, hamendësim i sistemit juridik brazilian: «spionimi i shpërblyer» që bën të mundur kërcënimin e personit që vendos dënime dërrmuese, që të mos kotribuonjë në implikimin e një të përligjshmi tjetër – një tjetër ekuivalent juridik i shantazhit. Mund të llogariten shmanget që i atribuohen një dispozitivi të tillë përmes rastit të Z. Marcelo Odebrecht, padroni më i pasur që ishte thirrur në kuadrin e një hetimi të tillë. I dënua me nëntë vjet burg për korrupsion, arriti ta ulë dënimin në vetëm dy vjet e gjysmë kur luajti lojën e spiunit. Në një kontekst të tillë, do të mundoheshim kot të mbivlerësonim presionin e marrë për t'u dhënë magistratëve elementët e kapshëm për të çuar përpara hetimet që i shqetësojnë më tepër se të tjerat.

Por gjithçka që paraprin peshon pak përsa i përket hyrjes në konceptin e *dominio do fato*: zotërimi i provave, mundësia për ta dënua dikë në mungesë të provave direkte për pjesëmarrje në krim, duke ndjekur idenë që ai nuk mund të mos jetë përgjegjës në këtë krim. Ky mekanizëm rrjedh nga ai i Tatherrrschaft (mbivlerësimi i provave) i sjellë nga juristi gjerman Klaus Roxsin për të dënua kriminelët e luftës naziste. Por Roxsin denoncoi përdorimin e parimit brazilian: të jesh në këtë apo atë vend në një organigramë nuk mjafton, thotë ai, për të vendosur përgjegjësinë e një krimi të kryer. Për më tepër, duhet që drejtësia të mund të provojë që krimi në fjalë është finalizuar nga i akuzuari. Gjykatësi Moro nuk i ka këto lloj ndjeshmëri. Vetëm se gjoja kishte marrë një apartament me një vlerë 600 000\$, «Lula» u dënua me 12 vjet burg: dy pjesë të dënimit fillestar të Z. Odebrecht për të maktën 2% të shumës për të cilën është dënua ky i fundit.

Në një kontekst të tillë, aksioni i igjykatës së Kuritibës korrespondon pak a shumë me koktejin e identifikuar nga SINGERI: një dozë e dellit republikan, një tjetër dozë e strategjisë kundërshtuese. Nëse ngjitemi në hierarkinë juridike deri tek Gjykata e Lartë, atëherë gjërat ndryshojnë. Këtu nuk ka as ashpërsi etike dhe as zell ideologjik. Motivimet shfaqen më të nevojshme.



© Lula Marques - Agência PT-29



© Indi Gouveia

Ndryshe nga ekuivalentët e tjerë nëpër botë, Gjykata e Lartë braziliane kombinon tre faktorë: ajo interpreton Kushtetutën; luan rolin e gjykatës së apelit me vendim të formës së prerë për proceset civile dhe kriminale; dhe së fundi ajo ka gjithë mundësinë për të përndjekur drejtuesit politikë – anëtarë të Kongresit dhe ministra –, të cilët gëzojnë pa këtë, një imunitet të njohur me emrin *foro privilegiado*.¹¹ Anëtarët e Gjykatës emërohen nga ekzekutivi. Ndryshe nga ajo që ndodh në Shtetet e Bashkuara, konfirmimi i tyre në detyrë nga pushteti ligjor është vetëm një formalitet. Nuk është e nevojshme asnjë përvojë e mëparshme e gjykatave: mjafton që të kesh praktikë si avokat apo prokuror dhe kaq.

Gjithmonë emërimi i anëtarëve të Gjykatës është mbështetur më tepër në logjikën e rrjeteve sesa në afrinë ideologjike. Në ekipin aktual, njëri nga anëtarët ka qenë avokati i «Lulës», një tjetër anëtar është një i detyruar (borxhli) i presidentit të mëparshëm Fernando Henrik Kardozo, ndërsa anëtar i tretë është

një kushëri i një tjetër presidenti, Z. Fernando Kollor de Mello. Ndërkohë që presioni i publikut i cili kërkonte me ngulm shkarkimin e Znj. Rusef ishte në pikën më të lartë, tetë nga njëmbëdhjetë anëtarët e Gjykatës ishin zgjedhur nga presidenti dhe nga paraardhësi i tij. Por gjykatësit duke shfaqur ngjyrën e tyre politike si të kameleonit, pikërisht ata që për rrogat e tyre i detyroheshin Partisë së punëtorëve, kërkuan pavarësinë e tyre nga partia në pushtet. Ata kënaqeshin me faktin që të vendosnin një formë detyrimi besnikërie ndaj një tjetri: duke harruar të parët e Partisë Punëtore, ata do t'i bindeshin tashmë medias dominuese.

Që në fillim të operacionit, ekipi i Kuritibas përdori arratisjet dhe informatat që kishin dalë në shtyp për të shkurtuar procedurat normale. Të shpejtosh stigmatizimin publik të një të akuzuari para paraqitjes së tij në gjyq është normalisht e ndaluar, por Z. Moro, e përjashtoi mundësinë për t'u besuar gazetarëve për të vënë Gjykatën e Lartë nën presion. Kur një nga gjykatësit e institucionit e informoi se parimi i së drejtës civile kërkonte që ai të lironte një drejtues të Petrobasit, Z. Moro u kthye nga shtypi duke deklaruar se, në këtë rast, do t'i duhej të lironte dhe trafikantët e drogës. Eprori i tij ndryshoi mënyrën e të reaguarit (volteface). Pasi kishte shkëlur tre norma duke marrë dëgjimet telefonike dhe duke bërë publike bisedat midis «Lulës» dhe Znj. Rusef, gjykatësi Moro u justifikua duke shpjeguar se kishte reaguar në «interes të të gjithëve». I konsideruar si një hero kombëtar nga i gjithë shtypi, ndaj tij nuk u mor asnjë masë.

Pas zgjedhjes së tij si president i vendit, në tetor të vitit 2019, Z. Jair Bolsonaro njoftoi se Z. Moro kishte pranuar postin e ministrit të drejtësisë. Në vitet 1990, magistratët italianë të ngarkuar me operacionin «Mani pulite» duart e pastra, kishin shprehur keqardhje që përpjekjet e tyre për të luftuar kundër korrupsionit patën përfunduar me favorizimin e ardhjes në pushtet të Z. Silvio Berlusconi. Në Brazil ylli i «Lava Jatos», iu ngazëllye faktit që iu bashkua ekipit të një prej drejtuesve të lartë politikë të aftë për të paraqitur Z. Berlusconi si një personazh simpatik.

Në fillim të viteve 2000, zoti Vladimir Putin, instrumentalizoi luftën kundër korrupsionit për tu rimarrë oligarkëve të kohës së Jelcinit pushtetin që kishin akumuluar gjatë tranzicionit. Ishte një kthim drejt të afërmeve të presidentit për ti pasuruar ata. 15 vjet më vonë, përvetësimi dhe tronditjet janë bërë pjesë e brendshme e kapitalizmit rus.

NGA TONY WOOD*

6 qershorin e kaluar, gazetari rus Ivan Golunov u ndalua dhe u arrestua për mbajtje droge. Policia përdori një dredhi tashmë të njohur: fillimisht u vendosën «provat» tek personi i akuzuar dhe më pas në apartamentin e tij. Por këtë herë, arrestimi i tij solli një valë të madhe kundërshtimi, që bëri të dalin në rrugë me qindra manifestues, dhe nxiti deklarata në mbështetje të tij nga ana e shtypit rus, gjë që zakonisht nuk ndodh, pasi shtypi nuk i kritikon autoritetet e vendit. Akoma më e çuditshme: Golunovi u la i lirë pesë ditë më vonë.

Hetimet e gazetarit mbi krimet e biznesmenëve dhe të burokratëve nuk kishin si të mos provokonin tërbimin e armiqve të tij më të fuqishëm, dhe sidomos të deputetit kryetar bashkie të Moskës, Z. Sergei Sobianine, të cilit i zbuloi pasuritë e patundshme. Por, ai prek vetëm një elektorat të kufizuar. Reagimet ndaj arrestimit të tij nuk kishin të bënin aq shumë me përmbajtjen e reportazheve të tij sesa me një valë zemërimi që ishte shpërndarë, pothuajse, gjithandej, kundër abuzimeve të vazhdueshme të pushtetit të ushtruar nga drejtuesit rusë. Ato qenë në vazhdimësi të kundërshtive të lindura në janarin e vitit 2011-2012, kur me dhjetëra mijëra rusë manifestuan për të kundërshtuar manipulimin e zgjedhjeve nga partia në pushtet, «Rusia e Bashkuar», dhe një rikthimi shumë të afërt të Z.Vladimir Putin në presidencë.

Nëse opozita përbëhet nga një gamë e gjerë rrymash politike dhe ideologjike – duke filluar nga liberalët tek socialistët, duke vazhduar me monarkistët dhe anarkistët -, të gjithë ranë dakort për domosdoshmërinë e luftës kundër korrupsionit. Një temë kjo që Z. Aleksei Navalni, i cili nuk pushon së diskutuari që në vitet 2000, ka mundur ta kthejë në debat. Nëpërmjet platformave të ndryshme, siç është blogu i tij «Live Journal», llogaria e tij në Twitter apo dhe operacione mediatike të bëra nga fondacioni i tij antikorrupsion, ai ekspozon mashtrimet e të gjitha llojeve, që nga nepotizmi tek pasurimi personal i funksionarëve duke bërë një kalim gjigand e praktikuar kjo nga ndërmarrjet shtetërore. Ai ka zbuluar, gjithashtu, informacione kompromentuese në lidhje me figurat e Kremlinit, duke filluar nga Z. Dimitri Medvedev. Dokumentari «Don't Call Him «Dimon»», realizuar nga fondacioni i tij në 2017, zbulonte pasurinë personale të ish-presidentit, që përbëhej nga jahte dhe pasuri të shumta të patundshme, si në Rusi ashtu dhe në Itali, më saktësisht vreshta dhe një vilë në Toskanë.

Pa dyshim, lufta kundër korrupsionit bëri të mundur që opozita të bashkohej, duke e detyruar regjimin që ta diskutonte publikisht këtë temë. Këtë vit, gjatë dialogut tradicional direkt me spektatorët (e përzgjedhur më së miri), Z. Putin u dëgjua të pyetej nëse ai ndjehej «personalisht përgjegjës për këtë kaos». «Sigurisht», u përgjigj ai, para se të pohonte: «Numri i krimeve lidhur me korrupsionin është në ulje, sidomos falë aksionit tonë të mbështetur dhe të papajtuësëm.» (1)

* shkrimtar, anëtar i komitetit editorial i *New Left Review* (Londër), autor i *Russia without Putin: Money, Power and the Myths of the New Cold War*, Londër, 2018.



Vladimir Putin



Boris Jelsin

NË FAKT HETUESIT DËSHMOJNË KONFLIKTE TË BRENDSHME TË ELITËS MË SHUMË SE NJË MEKANIZËM DISIPLINOR

Në fakt, u arrestuan disa figura të njohura të rangjeve të larta, si ministri i dikurshëm i zhvillimit ekonomik Aleksei Uliukaev, i cili u dënua në dhjetor të vitit 2017 me 8 vjet burg, pasi kishte pranuar një shumë të majme parash. Por, rezultatet e këtyre përpjekjeve ngjallin dyshime për vërtetësinë e tyre. Ministri i dikurshëm i mbrojtjes Anatoli Serdiukov u pushua nga puna në vitin 2012, pas një skandali korrupsionit, më pas u akuzua për neglizhencë në vitin 2013, para se të shpallej i pafajshëm një vit më vonë. Tashmë mban një post të rëndësishëm (dhe padyshim të paguar mirë), tek «Rosteku», konglomerati ushtarako-industrial shtetëror. Hetimet për korrupsion duket se dëshmojnë më shumë për konflikte të brendshme në elitën ruse sesa për një mekanizëm disiplinor, që përdoret si një armë kundër rivalëve.

Fushatat zyrtare kundër korrupsionit nuk janë asgjë më shumë sesa një ushtrim komunikimi. Por, në fakt, opozita dëshiron vërtet që të sulmojë. Për të këto janë vetëm disa incidente që hasen gjatë rrugës dhe nuk janë jashtë sistemit; sapo të hiqet qafe kjo plagë, ai do mund të funksionojë më drejt dhe në mënyrë më racionale. Ose, më pas, kjo do të marrë karakteristikën e një anomalie: orgjitë e pasurimit të paligjshëm kundër atyre që ngrenë krye – dhe me të drejtë – Z. Navalnyi dhe të tjerë si ai nuk rezultojnë fajtorë

I NJËTI SISTEM, DUKE FILLUAR QË NGA BORIS JELCIN, Opozitarët rusë janë

në rrethet pranë Z.Putin; këto lloj maskaradash bëjnë pjesë në arkitekturën e vetë sistemit. Nuk përbëjnë një fenomen që vjen nga jashtë, ose të jetë një aksident në kapitalizmin rus bashkëkohor: ato janë të tilla që nga lindja e tij.

Por, për të kuptuar më mirë këtë gjë, duhet të rikthehemi në origjinën e elitës postsovjetike. Mediat perëndimore i përshkruajnë anëtarët e kësaj elite si politikanë të shkathët që janë pasuruar duke zhvatur sa më shumë në momentin e hapjes së ekonomisë së tregut në vitet 1990. Ligjshmëria e disa prej këtyre praktikave ndoshta ishte e dyshimtë, por vetë ligji a nuk ka qenë i gabuar gjatë kësaj periudhe kaotike? Boris Berezovsky(1) e mishëronte më së miri këtë oligarki që lindi në vitin 1990.

Pas disa vitesh, ky shitës i dikurshëm i materialeve informatike u bë pronar bankash, i një kompanie naftë, i një gazete të madhe dhe i kanalit televiziv më të rëndësishëm në Rusi. Madje, ka ushtruar funksione të rëndësishme nën presidencën e Boris Jelsinit. Shpesh, anëtarët e kësaj oligarkie janë krahasuar me «baronët e hajdutëve» të shekullit XIX në Shtetet e Bashkuara: njerëz pasurimi i të cilëve me anë të mënyrave jo të drejta u vesh shumë shpejt me dinjitet.

Por kjo paraqitje nuk thotë asgjë në lidhje me procesin që bëri të mundur që këta oligarkë të grumbullojnë kaq shumë para. Elita e re ruse lindi nga vullneti politik i shtetit dhe aspak nëpërmjet një konkurrence të pamëshirshme, siç duhet të ndodhë normalisht. Jelsini, i detyruar

që të prishë ekonominë e planifikuar sovjetike, vazhdoi me privatizimin masiv të aktiveve publike që në vitin 1992. Operacioni mori formë të ndryshme, si psh «shitjet në ankand të aktiveve», gjatë të cilave qytetarët e zakonshëm mund të merrnin pjesë nga ndërmarrjet të cilat më vonë mund edhe t'i këmbenin; apo dhe «privatizimet nëpërmjet dekreteve» me anë të të cilave Jelsini ia dha gjithë pronësinë e ndërmarrjeve personave të tij të zgjedhur.

Tërësia e këtyre privatizimeve ka bërë të mundur krijimin e një klase të re oligarkësh të cilët përfituan pjesë të rëndësishme të infrastrukturës prodhuese të Bashkimit Sovjetik me çmime shumë të ulëta. Pika e tyre e përbashkët nuk ishte zhvillimi i tregtisë, por aftësia për të shfrytëzuar lidhjet e tyre me aparatit shtetëror, ku duke premtuar mbështetje ndaj Jelsinit në tentativën e tij për t'u rrizgjedhur më 1996, në këmbim të një kompanie naftë, sikur kjo të ishte realizuar me «hua kundër aksioneve» të vitit 1995.

PËR TU BËRË MILIONER NË VENDIN TONË NUK ËSHTË NEVOJA TË JESH KOKË E MADHE

«Për t'u bërë milioner në vendin tonë, -shpëjton bankieri Piotr Aven, -nuk është aspak e nevojshme që të jesh një kokë e veçantë apo të jesh i specializuar në një fushë të caktuar. Më shpesh, është e rëndësishme që të kesh një mbështetje aktive në gjë të qeverisë, të parlamentit, të autoriteteve lokale dhe të organeve

DERI TEK VLADIMIR PUTIN

gjithmonë të korrumpuar

të sigurisë. Një ditë të bukur, banka juaj, që deri dje ka qenë e parëndësishme, autorizohet të kryejë operatione me fondet publike. Pastaj, në mënyrë shumë bujare, ju jepen kuata për eksportimin e naftës të drurit dhe të gazit. Me fjalë të tjera, ju jeni futur në rangun e milionerëve (1)»

Pas ngjitjes në pushtet në vitin 2000, z. Putin u angazhua publikisht se «do të shfaroste klasën e oligarkëve», duke sugjeruar se era kishte ndërruar kah, dhe se pasuritë e mëdha private nuk ishin më të paprekshme. Por realiteti doli krejt ndryshe. Në vend që të zhdukte oligarkët, presidenti favorizoi përhapjen e tyre. Sipas klasifikimit vjetor të revistës Forbes, në vitin 2000, Rusia nuk kishte asnjë miliardar; në fund të mandatit të tij të dytë, në 2008, numëroheshin 82 të tillë, dhe 11 vite më vonë numri i tyre shkoi në 98, falë një koniunkturë ekonomike të zymtë dhe sanksioneve perëndimore të futura në Rusi që nga viti 2014, pas bashkimit të Krimesë.

Ajo që ka ndryshuar pas ardhjes së Putinit në pushtet, nuk është mundësia e një pasurimi personal masiv, por identiteti i atyre që pasurohen dhe lidhjet që ata kanë me shtetin. Pjesa më e madhe e oligarkëve të periudhës së Jelsinit nuk ishin pjesë e aparatit shtetëror; ata përfituan nga mosfunksionimi i mirë i shtetit. Ndërsa, oligarkët e periudhës së Putinit janë fillestarë që ditën të përdornin pushtetin e qeverisë me

qëllim tërheqjen e aktiveve. Me disa ndryshime sektoresh: në vitet 1990, kur çmimi i burime natyrore ishte shumë i ulët, pasanikët e mëdhenj rusë ishin përqëndruar tek bankat, financa, televizioni dhe rrjetet e komunikimit. Në fillim të viteve 2000, ngritja e çmimit të naftës, gazit dhe metaleve bëri që të përfitojnë ata që kishin aksione në këta sektorë. Midis këtyre manjatëve gjendeshin njerëz të afërt të Kremlinit që ishin në krye të ndërmarrjeve publike, dhe që përfituan nga ajo ç'ka mund ta quajmë nepotizëm kapitalist të shtetit.

Gjithsesi, ky nocion nuk e kupton ngjashmërinë e metodave dhe prioriteteve midis ndërmarrjeve publike dhe atyre private. Në të dyja rastet, bëhet fjalë për të optimizuar vlerën e aksioneve dhe pagat e kuadrove, dhe jo për të rritur përfitimet e tyre nga objektivat strategjike kombëtarë. (pa folur pastaj për rishpërndarje të pasurive). Rezultati është pak a shumë i njëjtë, pavarësisht ndryshimeve formale.

Natyra e turbullt e kufijve midis Shtetit dhe botës së biznesit ka filluar në periudhën e Putinit, dhe nuk ka asnjë shenjë që të tregojë se shteti po ndërhyr për të marrë kontrollin, apo që individë të fuqishëm të konsiderohen si zhvatës. Po ashtu, si gjithandëj nëpër botë, një program politik që themelohet kryesisht për të luftuar korrupsionin paraqet rreziqe dhe kufizime. Z. Na-

valni denoncon shpesh shpërdorimin e parave publike me anë të korrupsionit, gjë që është e pakundërshueshme. Por, kjo logjikë mund të nënkuptojë një pozicion më të gjerë kundër ndërhyrjes së shtetit dhe për ekonominë e tregut; ç'ka mund të çonte në justifikimin e mjeteve neoliberalë akoma dhe më brutale nga ato që kishte njohur më parë Rusia, me pretekstin se shteti ngelet një burim vjedhjeje më se i bollshëm.

FUNKSIONARËT PËRDORIN FUQINË E TYRE LEGALE PËR TË RRIUR KAPITALET E TYRE

Korrupsioni i ka zhytur rrënjët e tij në lidhjet midis pushtetit politik dhe atij ekonomik rus, që ngjitet tek presidenca e Jelsinit dhe formimi i vetë ekonomisë postsovjete. Kur një biznesmen do të kapë një ndërmarrje tjetër konkurente, p.sh, ai mund të paguajë funksionarë të lartë që të bëjnë kontrolle fiskale dhe inspektim mbi kushtet e punës në këtë ndërmarrje derisa pronari të bjerë dakort me të për çmimin e shitjes. Këto dhjetë vitet e fundit janë gjithmonë e më shumë funksionarët e lartë që përdorin praktika të tilla, duke përdorur fuqinë e tyre ligjore për të marrë aktivet që duan, duke ilustruar më së miri proverben rusë: «Gjithcka e kemi për miqtë, ndërsa ligjin e kemi vetëm për armiqtë.»



Dikush që është me të vërtetë i keq

« Personazhi i lig », në 6 Shkurt 2019, e përzgjedhura demokratike, Alexandria Ocasio-Cortez të redaktojë mund të përfiton nga audicioni tek Dhoma e Përfaqësuesve e Zonjës Karen Hobert Flynn, e organizatës Çështja e Përbashkët, organizatë e Zotit Bradley Smith, të Institutit të Fjalës se Lire, dhe e Zotit Rudy Mehrbani, të Brennan Center, për të zbardhur funksionimin e sistemit politik amerikan.

Ocasio-Cortez. – Ju propozoj të luajmë një lojë pyetje-përgjigje. Unë do të luaj rolin e personazhit negativ, që mundohet të përfitojë nga sistemi politik për t'u pasuruar, për t'u shërbyer interesave të mia, edhe kur ato vihen para interesave të popullit. Atëherë, Zonja H-F, imagjino sikur unë dëshiroj të bëhem deputete, dhe përfytyroni sikur dua të dinancoj fushatën ekskluzivisht nëpërmjet donacioneve të kompanive të mëdha. Ka ndonjë pengesë ndaj këtij plani në nivelin ligjor ?

Hobert Flynn. – Asgjë.

Ocasio-Cortez. – OK. Dmth, në qoftë se e kuptoj mirë, asgjë s'më ndalon për të qenë tërësisht e financuar nga shoqëri naftë ose farmaceutike, dhe të jem e rrethuar nga lobistët e tyre, gabohem ? Dakort. Atëherë, le të themi që unë jam një person shumë i lig, dhe që, në të kaluarën, kam bërë disa gjëra jo shumë të bukura që dëshiroj t'i bëj të harrohen në mënyrë që mund të zgjidhem. Zoti Zmith, a është e vërtetë që ju keni shkruar tek Washington Post një artikull të titulluar « Këto derdhje parash tek femrat problematike. Kjo nuk do të thotë që ishin të jashtëligjshme (1). » ?

Smith. – Nuk arrij ta vizualizoj dokumentin në këtë moment, por është e vërtetë që kam shkruar një artikull me këtë titull tek Washington Post. Po, mendoj që ky është teksti në fjalë.

Ocasio-Cortez. – OK. Shumë mirë. Pra, janë të lejuara korrupsionet. Mund të bëj ç'të dua, duke përfshirë dhe gjëra jo shumë të bujshme: ligji më lejon të paguaj njerëzit në mënyrë që të heshtin. Madje, konsiderohet si ushtrim i lirisë sime të fjalës. Le të imagjino-

jmë tani që jam përzgjedhur. Kam një mandat dhe mund të ndryshoj, të redaktoj apo të influencoj përmbajtjen e ligjeve që drejtojnë sot Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Mrekulli. A mund të më tregoni, mbase ju, Zonja Hobert Flynn, në qoftë se ekziston një kufi i teksteve mbi të cilat kam të drejtë të ndërhyj ? Ka ndonjë përkufizim të kapacitetit tim për të modifikuar përmbajtjen e ligjeve që ndikojnë grupet e interesit që kanë financuar fushatën time dhe që më kanë mundësuar të zgjidhem ?

Hobert Flynn. – Jo nuk ka asnjë kufizim.

Ocasio-Cortez. – Asnjë? Dakort. Domethënë, në qoftë se nuk gabohem, mund të financohem tërësisht nga industria farmaceutike dhe të përdor mandatin tim për të krijuar ligje që favorizojnë këtë industri? Dhe e gjithë kjo, pa asnjë kufizim (inkuadrim) ligjor ?

Hobert Flynn. – Saktë.

Ocasio-Cortez. – OK, perfekte. Atëherë, Z. Mehrbani, gjëja e fundit që dëshiroj të bëj, është të pasurohem duke punuar sa më pak. Kjo është ambicja ime kryesore si personazh i lig i kësaj historie. Nëse dëshiroj të zotëroj aksione tek një shoqëri naftë dhe pastaj të bëj ligje që e çrregullojnë këtë sektor? Ligje të cilat pretendohen të rrisin vlerën e aksioneve të mia ?

Mehrbani. – Mund ta bëni këtë pa asnjë shqetësim.

Ocasio-Cortez. – Me të vërtetë? Kjo është e mundur ? Asgjë në ligjet aktuale nuk mund të më ndalojë ?

Mehrbani. – Asgjë.

Ocasio-Cortez. – Perfekt. Pyetja ime e fundit është kjo: a është e mundur që fabula të cilën sapo krijuam i përshtatet qeverisë në fjalë dhe të përzgjedhurve aktualë ?

Mehrbani. – Po

Hobert Flynn. – Po



Lidheri i opozitës ruse, Alexei Navalny, gjatë marshimit në rrugët e Moskës. Foto nga Evgeny Feldman

(1) Bradley Smith, «Those payments to women were unseemly. That doesn't mean they were illegal», The Washington Post, 22 août 2018. Në këtë artikull, autori kritikon mekanizmat që mundësojnë pagesat e përndjekjeve ligjore duke u derdhur shuma parash viktimave.



Marrëveshja © Gentian Shkurti

MUNGESA E DIALOGUT DHE KRONIKA E NJË "ZJARRI" QË U SHUA NGA AMERIKANËT DHE BE-JA

Vendi që i ka shpallur luftë marrëveshjes

Të huajt dhe, në përgjithësi, të gjithë ata që merren me politikën shqiptare, kanë vënë re me shqetësim se demokracia jonë vuan një plagë që po bëhet e rëndë për klimën e besimit. Kjo është mungesa e dialogut dhe paaftësia për të bërë marrëveshje që tejkalojnë interesat e ngushta partiake. Janë shumë ta rralla rastet e bashkëpunimit ndërpartiak për interesa madhore të vendit.

NGA YLLI PATA

Opinionin kujton se vetëm në një rast, kur Shqipëria po digjej nga flakët e revoltës së vitit 1997, partitë nënshkruan një marrëveshje politike dhe krijuan një qeveri të pajtimit kombëtar. Ndërsa, në anën tjetër, të gjithë e kujtojnë se, për interesa krejtësisht personale, dy drejtuesit që urrehen më shumë me njëri-tjetrin, Sali Berisha dhe Edi Rama, nënshkruan në vitin 2008 një marrëveshje elektorale dhe bënë ndryshime kushtetuese për të forcuar pozitat e tyre domineuese në partitë respektive. Ajo marrëveshje është kujtimi i fundit i një dialogu të keq që kryhet vetëm atëherë kur interesat private kapërcejnë ato të vendit. Ndërsa sot, opozita ka bojkotuar sistemin, ka dalë nga të gjitha institucionet dhe apelit të ndërkombëtarëve për t'u ulur në një tryezë me qeverinë që të nisin urgjentisht reformën zgjedhore, po i përgjigjet

me refuzim të trishtuar. Edhe pse i një natyre krejt tjetër dhe në rrethana të ndryshme, Parlamenti i parë shqiptar, në vitin 1920, e nisi punën me një dorëheqje masive deputetësh, çka sollti edhe shkrirjen e Këshillit Kombëtar dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja në vitin 1920. Duket si një mallkim për jetën e mëpastajme parlamentare dhe, në fakt, një tjetër ngjarje e rëndë e tronditi tranzicionin shqiptar.

Zgjedhjet e 26 majit 1996 ishin një masakër e vërtetë antidemokratike dhe procesi i votimit u kompromentua keq. Pak ditë para zgjedhjeve dhe në orët e para të votimeve, vëzhguesit ndërkombëtarë ishin dëshmitarë të një dhune drastike të policisë dhe strukturave shtetërore që tensionoi rëndë situatën. Ishin dhunuar edhe deputetë e komisionerë të opozitës. Një drejtues

lokal i opozitës, kreu i PS-së Bulqizë, u gjet gati i rrahur keq në një kanal buzë rrugës. Si pasojë e kësaj dhune, opozita, pak para mesditës së 26 majit, vendosi që të tërheqë komisionerët nga qendrat e votimit. Pas këtij veprimi, mazhoranca, jo vetëm nuk u frenua, por tejkaloi abuzimin duke mbushur kutitë e votimit në mënyrë vulgare. Si përfundim, mazhoranca mori mbi dy të tretat e Parlamentit, kurse opozita socialiste vetëm 11 vende. Opozita nuk i njohu zgjedhjet, ndërkohë, misioni vëzgues i OSBE-ODIHR-it i cilësoi si një hap prapa dhe që nuk kanë aritur standardet demokratike. Si zgjidhje, OSBE-ODIHR-i kërkoi përsëritjen e zgjedhjeve në të paktën 42 zona zgjedhore. Ky qëndrim u përkrah edhe nga kancelaritë europiane dhe qeveria e SHBA-së. Por Presidenti i atëhershëm, Sali Berisha, nuk pranoi të tërhiqej. Opozita nuk pranoi zgjedhjet dhe nuk i zuri vendet e saj në Parlament, përveç një deputeti, mjekut Sali Rexhepi nga Librazhdi. Klima e besimit ishte tronditur dhe dialogu u mbyl përsëri.

PARADHOMA E DJEGIES SË MANDATEVE

Në vitin 2017, vendi ishte sërish pranë një kaosi institucional. Opozita e Lulzim Bashës nuk pranonte të hynte në zgjedhjet parlamentare të atij viti pa largimin e kryeministrit Edi Rama. Ajo hyri në një çadër përpara kryemi-

nistrisë dhe zhvilloi protesta për 4 muaj. Në fund, me ndërmjetësimin agresiv të SHBA-së dhe BE-së, u arrit një marrëveshje mes Edi Ramës dhe Lulzim Bashës. Sipas marrëveshjes, u krijua një qeveri e përbashkët që do të çonte vendin në zgjedhje të pakontestueshme dhe opozita mori gati gjysmën e qeverisë dhe disa institucione e agjenci të rëndësishme. Zgjedhjet e 25 qershorit 2017 u fituan nga Partia Socialiste, e cila mori 74 mandate e vetme duke larguar edhe LSI-në si aleatë qeveritare. Ndarja me Ilir Metën u bë në mënyrë të butë dhe Rama e mbajti fjalën duke zbatuar marrëveshjen e « natës së ngjalave ». Ilir Meta, me votat e PS-së, u zgjodh President i Republikës.

DJEGIA E MANDATEVE DHE LINDJA E NJË OPOZITE NË PARLAMENT

Më 21 shkurt 2019, djegia e mandateve mori formë zyrtare. Mirëpo kjo nismë u kundërshtua nga disa deputetë të opozitës. Rudina Hajdari nga Partia Demokratike, e bija e ish-liderit të lëvizjes studentore të vitit 1990, Azem Hajdari, e shkolluar në SHBA dhe me shtetësi amerikane, refuzoi të dorëzojë mandatin e saj, së bashku me Lefter Kokën, ish-ministër i LSI-së dhe ish-kryebashkiak i Durrësit si dhe një demokrat i orëve të para, deputeti i Lushnjes, Myslim Murrizi. Jo vetëm kaq, por opozita

mbeti e huatuar kur shumë deputetë të saj që përfitonin një vend nga listat e hartuara, u futën në Parlament dhe sot Kuvendi i Shqipërisë ka 120 deputetë. Në prag të zgjedhjeve lokale u krijua edhe partia « Bindja Demokratike » e Astrit Patozit, ish-nënkryetar i PD-së. Në një deklaratë të përbashkët nga Brukseli, shefja e diplomacisë së Bashkimit Europian, Federica Mogherini dhe Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn, deklaruan më 21 shkurt se « këto vendime dhe akte janë të padobishme, bien në kundërshtim me zgjedhjen demokratike të shtetasve shqiptarë dhe minojnë progresin që vendi ka bërë në rrugën drejt Bashkimit Europian ».

Por edhe pas këtyre qëndrimeve të forta të komunitetit ndërkombëtar, opozita nuk u tërhoq. Ish-kryeministri Sali Berisha, personazhi kryesor që në daljet publike përdorte vazhdimisht retorikën e luftës, të vrasjeve dhe të përplasjes, deklaronte: « Ne kemi djeg mandatet, ne jemi qytetarë të thjeshtë, jemi në betejë dhe opozita ka detyrë të udhëheqë këtë betejë me çdo çmim ». Protesta e parë e opozitës, ajo e 16 shkurtit 2019, ka qenë edhe më e tensionuara. Për pesë orë përpara selisë së Kryeministrit në Tiranë u hodhën bomba Molotov, mjete ndezëse dhe protestues të opozitës tentuan të theyjnë derën e selisë së qeverisë. Pamjet e asaj proteste bënë xhiron e botës dhe Shqipëria dukej se po rikthehej në stinën e tensionit. Në orët e vona të 16 shkurtit, zyrtari i lartë i DASH-it, Mathew Palmer telefonoi dy liderët e Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe u bëri thirrje që të heqin dorë nga dhuna.

DREJT ZGJEDHJEVE ATIPIKE LOKALE

Dekreti i Ilir Metës për çdekretimin e zgjedhjeve krijoi një situatë të vështirë në fillim. Ndërkaq, një parti e koalicionit qeverisës, PUK, e drejtuar nga avokati Idajet Beqiri, iu drejtua Gjykatës së Shkallës së Dytë për të kërkuar çregjistrimin nga zgjedhjet, si një truk për të legjitimuar nga kjo gjykatë dekretin e parë të presidentit, atë të 30 qershorit. Vendimi i kësaj gjykate u quajt si legjitimim i 30 qershorit dhe çdekretimi i presidentit u shpall si akt nul. Dhe vetëm dy ditë para zgjedhjeve, më 28 qershor, në një intervistë të dhënë në « Zërin e Amerikës », Mathew Palmer, zv/ndihmëssekretari i Shtetit dhe i dërguari i posaçëm për Ballkanin tani në fund, deklaroi « Ne presim që zgjedhjet të zhvillohen më 30 qershor. Shpresojmë që ato të zhvillohen në mënyrë të qetë e transparente. Pas zgjedhjeve do të formohet Gjykata Kushtetuese dhe shpresojmë që mosmarrëveshjet për kohën e zhvillimit të zgjedhjeve të zgjidhen përmes institucioneve të vendit ».

Nga politikanët e opozitës ishte deklaruar se zhvillimi i zgjedhjeve do të pengohej duke përdorur militantët si mburoja humane për të mos lejuar që të votohej duke penguar ata që dëshironin të votonin. Por z. Palmer deklaroi: « u bëjmë thirrje udhëheqësve të opozitës t'ua bëjnë të qartë përkrahësve të tyre që më 30 qershor të mos ketë dhunë, që askush të mos pengojë të drejtën e atyre që dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje ».

MËSYMJA AMERIKANE NË BALLKAN

David Kostelancik, Drejtori për Europën Qendrore e Jugore në Departamentin e Shtetit, ishte në Tiranë në fillim të shtatorit në një mision për të bindur opozitën që të rihijë në sistem, duke negociuar personalisht me drejtuesit e opozitës, Lulzim Basha dhe Monika Kryemadhi.

Zyrtari amerikan bëri thirrje për « nevojën për kryerjen e reformës zgjedhore dhe rekomandoi se është përgjegjësi e qeverisë që dora e shtrirë



Foto nga protestat e opozitës në Tiranë



Zv/Ndihmës Sekretar i Shtetit, Matthew Palmer



Ilir Meta gjatë ceremonisë së betimit për president

për opozitën duhet të mundësojë tërheqjen e saj në realizimin e kësaj reforme. Kryerja e reformës zgjedhore brenda vitit do të mundësojë edhe një presidencë shqiptare të suksesshme të OSBE-së në vitin 2020». Zyrtari i lartë amerikan nuk e takoi presidentin Meta. Këto përpjekje të ndërkombëtarëve bëhen pak kohë para vendimit të 18 tetorit, kur Ministrat e Jashtëm të Bashkimit Europian, duhet të marrin një vendim për hapjen e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Sipas radios publike gjermane *Deutsche Welle*, grupi më i madh në Bundestag, ai i CDU/CSU-së i kancelares Merkel, e ka marrë vendimin për t'i thënë PO hapjes së negociatave me Shqipërinë me kushte, edhe pse ekziston një grup skeptik brenda këtij grupi. Politologu Afrim Krasniqi, në një prononcim për edicionin shqip të *Le Monde Diplomatique*, thotë: « Zgjidhja mbetet vetëm politike. Lidhur me parandalimin e krizave në të ardhmen, katër janë mekanizmat që mund ta garantojnë këtë: e para, reformimi i sistemit zgjedhor dhe i ligjit të partive politike, për të siguruar më shumë konkurrencë individuale dhe demokraci funksionale brenda partive. Nëse partitë do të ishin më demokratike,

vendimmarrjet e saj më institucionale dhe parlamenti me më shumë personalitete në përbërje, kriza e 2019-ës do të ishte parandaluar. Mekanizmi i dytë është funksionimi i plotë i sistemit të gjykatave, sidomos Gjykatës Kushtetuese ».

Ndërkohë, Edi Rama, vetëm pak ditë më parë, takoi në Berlin kancelaren Merkel dhe kryetarin e Bundestagut, z. Schäuble. Vizita dukej e ngrohtë dhe Kancelarja paraqiti në sitin e saj zyrtar një foto me kryeministrin kur ky i dhuron albumin me piktura që do ta paraqesë në bienalen e Berlinit. Opozita, ndërkohë, pret « gjermanin e fundit », një delegacion të Bundestagut që përbëhet nga një grup brenda CDU-së që ka përkrahur vazhdimisht zotin Basha, i drejtuar nga deputeti Gunther Krischbahum, kryetar i komisionit për integrimin në BE, i cili pritet të sjellë edhe formulën nga ana e Berlinit për zgjidhjen e ngërçit shqiptar. Ndërkaq, më 9 shtator, Komisioni hetimor nisi nga puna për të shqyrtuar kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin e Presidentit Ilir Meta. Një delegacion i Komisionit të Venecias ishte në Ti-

ranë dhe takoi palët e përfshira në debatin për shkarkimin e Metës. Vetëm pak ditë më parë, Ilir Meta deklaroi se, në qoftë që Komisioni i Venecias do të tregojë se ka shkëlur kushtetutën, ai do të japë dorëheqjen. Ndërkaq, në horizont nuk ka asnjë shenjë se palët do të ulen në tryezë. Marrëveshja, ashtu si në kohën e komunizmit, shihet si nja akt kapitullimi përballë armikut. Armikut? Po, në sistemin demokratik shqiptar, për fat të keq, PD-ja e sheh si armike PS-në dhe Lulzim Basha është gati të kërkojë ndihmë në Greqi që vendi të mos marrë dritën jeshile nga BE-ja në tetor. Një lajm i kohëve të fundit thotë se ish-ministrja e jashtëm e Greqisë, Bakojanis, motra e kryeministrit të sotëm Micotaqis, ka kërkuar që Shqipëria të pranojë marrëveshjen e detit të nënshkruar prej saj dhe Bashës kur ky i fundit ishte ministër i jashtëm. Pas vizitës së Ramës në Gjermani dhe fotove të qeshura me zonjën Merkel, disa kanë hamendësuar se kancelarja do t'i bindë edhe të pavendosurit që të thonë PO për çeljen e negociatave me Shqipërinë në tetor. A thua Greqia mbetet shpresa e fundit për Lulzim Bashën që ky të realizojë bastin e tij se me Ramën kryeministër negociatat nuk çelen?... »



Lajmet e dëshpëruara për vdekjen e Gerda Tarosë

HISTORI

Marketingu gjinor për Gerda Taro-në

«Cfarë do të bëje ti Gerda?», pyet një personazh i romanit të Helena Janeczek-ut «Vajza me Leica».¹ Pyetje me vend. Metamorfoza e botuar pas vdekjes e fotoreporteres Gerda Taro (1910-1937) po shndërrohet në një rast shkollë. E emigruar nga Gjermania në Paris në vitin 1933, Gerda Pohorylle takon Andre Friedman-in. Pas kësaj u formua një çift si dhe pseudonime, falë kësaj gruaje të re. Lindën kështu Gerda Taro (Gerda Taro) dhe Robert Kapa (Robert Capa). Në gusht të vitit 1936 ata shkuan në Spanjën që ishte përfshirë nga lufta. Fotografitë e tyre kishin nënshkrimin «Capa», më pas, të dy emrat bashkë, por, sipas biografes së saj, Irme Schaber, më vonë Taro-ja «do të konsideronte si shumë të rëndësishme që t'i shënonte më emrin e saj, fotografitë që ajo kishte realizuar».²

NGA ANNE MATHIEU

Megjithatë, meqë ata i shkëmbejnë shpesh aparatet e tyre (Rolleiflex dhe Leica) krediti i këtyre klisheve ngeli enigmë për një kohë të gjatë. Më 25 korrik 1937, (bjondja e vogël) gjeti vdekjen, viktimë e një sulmi republikan të pakontrolluar. Kolegu i saj Paul Nizan e shpuri trupin e saj në Port-Bou në Paris. Partia komuniste i bëri një funeral madhështor në varrezat e Pere-Lachaise. Në vitin 2001 shumë fotografi të Tarosë u shfaqën në hotel Sully. Në vitin 2006, Fransua Maspero i kushtoi asaj një libër³ ndërsa biografja e Schaberit u përkthye në frëngjisht; në vitin 2007 u mundësua ekspozita e parë në Nju Jork. Zbulimi i «vaxhës meksikane» bëri të mundur identifikimin e klisheve të saj. Legjenda e saj po bëhej gjithmonë e më madhëshore. Ajo u shndërrua në një personazh romanesk.

«Vajza me aparat Leica» përshkruan portretin e saj falë tregimeve të tre miqve të saj.

Më poshtë autori saktëson: «Falenderoj të gjithë ata që u munduan të qetësonin furinë time për të dokumentuar sa më shumë, duke më kujtuar se po shkruaja një roman. Është e vërtetë: edhe pse kam marrë informacione nga burime të shumta, shpirti i librit, për forcë të zakonit është frut i imagjinatës sime.» Me sa duket, kjo i ka bërë të heshtin të gjitha kritikant.

Libri «Regarder»⁴ (Shiko) i Serge Mestre (Serxh Mestre) trajton punën fotografike të Tarosë dhe angazhimin e saj majtas tek Partia komuniste. Mestrë mbështetet tek Schaberit dhe Maspero, por nuk i shmang klishetë: «Të dy fotografët kanë qenë gjithmonë përkrah njëri-tjetrit. Të kapur për krahu, ata arrijnë të ndiejnë aromën e barutit, të gurit që thyhet, dhe të pluhurit që ngrihet lart. Me sytë e njomur nga djersa, lotët dhe hiri, ata përqafohen siç nuk e kishin bërë kurrë më parë.»

Pas librit «Pas Gerdës», Pierre-Francois Moreau⁵, gjithmonë sipas botuesit të tij, ka shkruar një «roman ku shkrihen historia dhe shkencën». Historitë për Capa-n në Nju Jork, ku do të botojë në vitin 1938 *Death in the Making*, epigrafi i të cilit është i tillë: «Dedikuar Gerda Tarosë, që jetoi një vit në frontin e luftës në Spanjë, ku humbi dhe jetën». Ai ka sjellë një Gerda së cilës i ka veshur shumë fjalime.

Sapo fillon të lexosh rrembesh nga faqet, sepse elementët autentikë kanë një forcë të madhe që del mbi fantazinë. Gjithë këto përkujdesje për të zgjedhur fjalët, të shkruara me të vogla, por që nuk ta zvogëlojnë një si lloj pëshëlljimi. Vërtet Capa i ka pasur këto mendime? Po Taroja a e ka përjetuar vërtet këtë skenë?...



Gerda Taro

Një pyetje i fshin të tjerat: përse këto romane? Në vitin 1994, Schaberit do të shfaqte një lloj vullneti feminist: «Cilido që interesohet për femrat dhe për historinë e tyre duhet në mënyrë të pashmangshme të lexojë me vëmendje shënime dytësore të historisë. Gerda Taro që një nga këto shënime!...» Kjo optikë – e lëndueshme – sot është shndërruar në një tendencë ikonike. Në kapakun e poshtëm të librit «Shiko», shkruhet: «personaliteti i fotoreporteres së ardhshme është e gjitha në këtë skenë, që i jep tonin portretit të ndjeshëm dhe tejet feminist që ka sjellë me detaje Serxh Mestre.»

Dhe për të kompletuar ikonën artificiale, duhet punuar për pastrimin e saj. Në romanin «Vajza me aparat Leica» Capa është gjithashtu «njeriu më i zoti për të ngatërruar realitetin me gënjeshtëri». Të jetë shndërruar Taroja në një instrument të marketingut unik në llojin e saj pa pasur një tjetër model? Edhe Google u pushtua nga fotot e saj në gusht të 2018-s, duke përkujtuar ditën e saj të lindjes.

Puna e mrekullueshme e Tarosë, vendi i saj prej pioniereje në fotoreportazhin e luftës, vlejnjë më shumë se fantazmat biopike letrare.

Paksa e turbullt: kështu titullohej autobiografia e Capa-s (1947). Me gjithë dritën që është hedhur mbi të në ditët tona, Gerda Taro shfaqet edhe ajo, paksa e turbullt.

1 Helena Janeczek, La fille au Leica, Act Sud, Arles, 2018, 380 pages, 22,80 euros.
2 Irme Schaber, Gerda Taro, Une photographe révolutionnaire dans la guerre d'Espagne, Anatolia-Éditions du Rocher, Paris, 2006.
3 François Maspero, L'Ombre d'une photographe, Gerda Taro, Seuil, coll. «Fiction et Cie», Paris 2006. Cf. également le roman de Susan Fortes, En attendant Robert Capa, Edition Héloïse d'Ormesson, Paris, 2011.
4 Serge Mestre, Regarder, Sabine Wispieser, Paris, 2019, 232 pages, 19 euros.
5 Pierre-François Moreau, Après Gerda, Edition du Sonneur, Paris, 2018, 160 pages, 16 euros.

LETËRSI

Pasojat e krizës në jetën bashkëshortore

Jemi në vitin 2009 dhe të gjithë janë në krizë», i thotë një profesor universiteti gruas së tij. Ajo ka dëshirë që të blejë një apartament jashtë mundësive të tyre ekonomike. Qëllimi i saj nuk është vetëm që të jetojnë mirë, por edhe të shpëtojnë martesën e saj duke e vënë të shoqin para një sfide. Pikërisht, rreth kësaj sfide zhvillohet historia e këtij romani. Gjithë urtësia e autorit Marco Missiroli qëndron në paralelizmin që ai vendos midis asaj ç'ka ndodh në botë dhe asaj ç'ka ndodh në shtëpinë e çdonjërit nga ne.

Margarita dhe Karlo Pentekoste janë martuar prej vitesh. Ndryshimet e shumta mes tyre janë fshirë nga kompleksiteti i tyre seksual, dhe aftësia për të bërë sikur nuk po ndodh gjë.

Deri në momentin kur gruaja nuk do t'i fshehtë më zërat që dëgjon përreth: Karlo duhet të ketë pasur një marrëdhënie seksuale me një studente të tijen. Ose të paktën mund të thuhet se ai u gjend pa shpjegim në banjot e femrave. Një incident ky për të cilin vetë profesori dhe studentja japin interpretime kontradiktore. Autori luan me këto dy versione dhe i nxjerr informacionet me pikatore, duke ia lënë në dorë lexuesit të krijojnë idenë e tij.

Po, Margarita, i beson vërtet ajo kësaj tradhtie? Edhe këtë, autori e lë në dorë të lexuesit që ta zbulojë dhe ta vlerësojë. Gruaja do të shqyrtojë të gjitha gjasat që mund ta vërtetojnë këtë tradhti, por jo duke i kërkuar burrit që të thotë të vërtetën, por duke e provokuar. Shumë shpejt marrëdhënia e tyre do mbushet me keqësi, xheloz, por edhe me një lloj erotizmi, gjithmonë e më shumë sadik, si në faqet e pakapshme të veprave të Sadit. Shtu pastaj dhe ardhjen e mamasë së Margaritës, një vejtshë e cila ka dhe ajo shumë

Çdo lloj besnikërie
Nga Marco Missiroli

Përkthyer nga
italishtja prej Nathalie
Castagné
Calmann-Lévy,
Paris, më 2019, 270
faqe, 19,90 euro.



llogari për të mbyllur me burrat tradhtarë. Kështu, tabloja familjare bëhet sa e pamëshirshme aq dhe turbulluese.

Cdo besnikëri tregon historinë e saj, por edhe histori të tjera, dhe pikërisht kjo gjë e fut në letërsi, një lloj si në dy romanet e tjerë të Missiroli-t, përkthyer në Francë (*Gjenialiteti i elefantit*, 2012, dhe *Pakorrektësitë e mia*, 2016, të dyja tek botimet Rivages). Si kuadër të ngjarjeve, autori ka zgjedhur Milanon, pikërisht qytetin ku jeton dhe vetë, dhe ku punon si kryeredaktor i një reviste psikologjike, dhe shkruan gjithashtu për rubrikën «kulturë» të *Corriere della Sera*.

Skenat intime dhe private, inkuadrohen me «kulturën e futbollit», bëhet fjalë për skuadrën e Interit të Milanos dhe jetën politike italiane

që në kohën e Betino Kraksit, kur ka qenë president i këshillit nga 1983-1987.

Autori na paraqet një qytet plot realizëm, pikërisht në çastin kur kriza financiare botërore provokon një tjetër ngritje të çmimeve të pasurive të patundshme. Gjë që e bën akoma më të fortë sfidën e Margeritës, aq sa Karlo duhet të ndryshojë profesion...

Sepse *Cdo besnikëri* nuk kufizohet vetëm në emocionet e një studenti dhe të një lolite, apo dhe në hakmarrjen e një gruaje. Autori na paraqet një panoramë të pasojave të krizës në shtresat e mesme, që vetë Missiroli arrin t'i vendosë në ekuilibër, duke krahasur rrugët me ndjenjat e trazuar të një çifti. E gjitha kjo jepet me anë të një fluksi që na bën të kalojmë nga e tashmja në të shkuarën, me një të kthyer të paragrafit.



Pikturë

Fluturimet e pëllumbave

Pablo Picasso i thoshte gazetës Liberation : « *Piktura nuk është bërë për të zbuluar apartamentet. Është një instrument lufte ofensive dhe defensive kundër armikut* » (*Letrat franceze*, 24 mars 1945). Në fakt, është i vetmi pranim i fjalës « luftë » që ai ka pranuar, atë që ekspozita e fundit (5 prill-8 korrik) e Muzeut të Ushtrisë në Paris « *Pikaso dhe lufta* », nuk e kishte përmendur qartësisht. Është mbledhur këtu gjithë atë që mund të bashkëshoqëronte këtë emër dhe kjo fjalë, falë lidhësës « dhe » : Pikaso gjatë luftës, efektet indirekte mbi artin e tij, denoncimi ballas (*Ëndrra dhe gënjeshtria e Frankos*, *Guernika*, *Gropa e varrit*, *Masakra në Kore*), tërthorazi (*Largimi i Sabinave*) ose metaforik (*Macja duke kapur një zog*). Tema mund të kishte qenë « *Pikaso dhe paqja* », sepse kjo temë ekziston mirë e bukur në veprën dhe në veprimin e tij si qytetar : ai ka pikturuar pëllumbin bërë simbol i paqes, emblemën e masës, ka ndihmuar refugjatët, shoqatat e mbrojtjes së të përkëtuarëve, pjesëmarrës në Lëvizjen e paqes, shpërthyer në 1950, thirrjen e Stokholmit kundër armatimit nuklear (dhjetë mijë firman ë Francë). Që mund të jetë varur pranë « *pëllumbave* » një afishe e ofoçinave antikomuniste Paqe dhe Liri, kjo të çudit... Katalogu¹ paraqet komente të pabarabarta dhe sjell pak kontekst, por sjell, gjithashtu, një minierë dokumentare.


FRANÇOIS ALBÉRA

¹ Collectif, *Picasso et la guerre*, Gallimard – musée de l'armée – Musée Picasso, Paris, 2019, 352 pages, 35 euro.

Plot finesë, i ndjeshëm, eksitues, i pasaktë, romani *Cdo besnikëri*, na fton të njohim nëntë vite të jetës së Karlos dhe të Margeritës. Nëntë vjet nga jetët tona, në agim të këtij shekulli. Korrikun e kaluar romani ishte finalist për çmimin Strega, (Gon-

court transalpin), dhe arriti të fitojë versionin për të rinj, çmimin Strega Giovani. Kjo arritje flet shumë për universalitetin e tij dhe për forcën e impaktit që ai ka.

HUBERT ARTUS



Kafazi
nga Lloyd Jones

Përkthyer nga anglishtja (*Zelanda e Re*) nga Mireille Vignol
Botimet Jacqueline Chambon, Paris,
2019, 320 faqe, 22,50 euro.

Përballë heshtjes së fantazmave

Në fillim, në oborrin e një hoteli ndodhet një kafaz, nuk dihet se në cilin vend. Aty brenda në kafaz jetojnë dy burra. Të parin e thërrasin « doktor », sepse shëroi një fëmijë të sëmurë ndërsa të dytin « Mizë » për shkak të bukurisë së tij. Rrëfyeti, që është njëkohësisht dhe shërbyesi i hotelit, ka si mision që t'i ushqejë dhe t'u japë mesazhe nga këshilli i administratës, që përbëhet nga daja i tij, halla dhe banorët e tjerë. Ai do ta na tregojë historinë e këtyre dy të mbijetuarve nga mbytja e anijes së tyre, mbërritjes së tyre në fshat, qetësia e të cilit u prish menjëherë pas kësaj ngjarjeje.

«Nuk bëjmë gjë tjetër, vecse mendojmë për ta. Ata ngjasojnë me ne, gjë të cilën mund ta konstatojmë lehtësisht, si dhe manifestojnë të gjitha dëshirat dhe uritë klasike. Por ata nuk duan të na thonë se nga kanë

ardhur. Ata përsërisin pa pushim me mijëra herë në ditë se nuk kanë shtëpi.» Meqë janë të stehuar dhe të ushqyer mirë, krijohet një lloj ndjesie, e ushqyer edhe nga frika në rritje e një katastrofe hipotetike që të huajt refuzojnë të kujtojnë. «*Mund t'i quajmë dy afreske që kanë përshkuar përmbytjen e jetëve të mëparshme.*»

Nja javë pas mbërritjes së tyre, ata donin të dorëzonin një kërkesë për azil në bashki, por «*ata nuk kishin kartë identiteti, as dokumente, asnjë lloj dokumenti për t'u identifikuar.* (...) Është e pamundur t'u japësh leje qëndrimi fantazmave.»

Një ditë prej ditësh, të huajt mbyllen pa dashje në kafazin e ndërtuar rishitaz. Edhe banorët humbasin çelësin pa dashje. Kur lajmi përhapet, të gjithë mundohen të ndihmojnë me se të munden, por askush

nuk i ndihmon që t'i nxjerrë që aty. Është një botë e ngushtë e mbushur me logjikë të palogjikshme, e stehuar mes absurdes së Franc Kafkës dhe oportunitetit të Samuel Beketit. Sepse *Kafazi*, është një parabolë, një tregim që flet për epokën tonë, për egërsinë dhe hipokrizinë e saj. Ai ngjason me romanin *Épépé*, botuar në vitin 1970 (Denoël, 1999), nga hungarezi Ferenc Karinthy, në të cilin një linguist, rrugës duke shkuar në një kongres shkencor, ulet në mënyrë të misterishme në një qytet të panjohur dhe ku banorët flasin një gjuhë të pakuptueshme. Një lloj si tek ky roman, edhe Kafazi ngre në pikëpyetje nocionet e të huajt dhe të anomalisë, – aq sa të huajt mund të shpjegojnë vetëm atë që kanë përjetuar. Të vëzhgojë apo të ndërhyjë, të bashkëpunojë apo të reagojë, e tilla është dilema që trazon shpirtin e rrëfyesit të humbur:

«Në këto momente po bombardohem midis dëshirës për t'i ndihmuar paksa ata që ndodhen në mes të një deti të trazuar dhe asaj

për të pritur sesi do ia dalin mbanë vetë.» Nuk bëhet fjalë për të pyetur njerëzimin në lidhje me dy të burgosur, të cilët janë të detyruar të mbijetojnë si kafshë, por në lidhje me mbikqyrësit dhe me komunitetin e tyre. «*Duhet pranuar fakti se vetëm ndërjegjësimi për trishtimin dhe braktisjen e tyre nuk ka sjellë asnjë ndryshim*», konstaton rrëfyesi.

Shkrimtari nga Zelanda e Re Lloyd Jones ka marrë çmimin e shkrimtarëve të Commonwealth-it, për librin *Mister Pip* (2006); Livre de poche (libri i vogël, 2011), ka qënë finalist në Booker Prize, që më vonë është përshtatur në kinema. Pas librit *Më dhuro botën* (2010); Le Livre de poche (libri i vogël, 2012), që flet për një grup me ngjyrë që kapërcen Mesdheun, ai shkollon në Berlin për të takuar djalin e tij pak pas lindjes. Aty afrohet sërish me fatin e emigrantëve të humbur në palat e botës perëndimore. Ose që u kthyen në mostra pas hekurave të një kafazi...

XAVIER LAPEYROUX

KINEMA

Frederic Wiseman, epopeja e jetës së zakonshme

Nga që të duket se po takohesh drejtpërdrejt me realitetin, kinemaja dokumentare, shpesh, është përfillur si pasqyrë e së vërtetës objektive, Mirëpo, harrohet që, nëse filmi mbështetet mbi elemente të realitetit, ato janë zgjedhur, vënë në skenë dhe organizuar prej një autori. Pikërisht këtë tregon i famshmi Frederick Wiseman, një nga më të mëdhenjtë kineastë të SHBA-ve.

NGA PHILIPPE PERSON*

Në fillim një kuadër rural ; në fund një gur varri. Kështu, Frederick Wiseman, 89 vjeç, për filmin e tij të fundit, ka zgjedhur që, përgjatë dy orëve, ta zhysë publikun e tij në mes të banorëve të një komune të vogël të Middle West, thellë në zemrën e SHBA-ve. Për *Monrovia, Indianan*, që doli në Francë në prill 2019, ai, gjatë shumë javëve, ka filmuar nga të gjitha këndet këtë komunë të vogël me 1400 banorë – nga këshilli komunal te sallonet e parukierëve, nga veterinarit tek ai që bën tatuazhe, nga mbajtëset e armëve deri në shkollë, nga një festë në fshat deri te një martesë dhe një varrim. Asnjë zë off (narrator), as titra shpjeguese, asnjë bashkëbisedim. Me imazhet dhe me tingujt që ka parë aty dhe që i tregon, spektatori i ka të gjitha elementet për të kuptuar situatat e përshkruara. Ai, spektatori, nuk di as më shumë dhe as më pak sesa kineasti. Është metoda e Wisemanit qysh prej filmit të tij të parë, *Titicut Follies*, më 1967.


Monrovia, e dalluar si komunë në Indiana, është një nga të parat që ka nxjerrë një ekip shkollor të basketbollit dhe ka votuar më shumë se 76% për Donald Trump në zgjedhjet e fundit presidenciale. Ky emër nuk është shqiptuar asnjëherë në film ; spektatori ndjek me vëmendje dhe kap kuptimin e kësaj vote në këtë komunë me 96% popullsi të bardhë. Wiseman nuk pranon të mësojë anësinë e votës së këtyre zgjedhësve, ngulitur nga e djathta dhe nga Partia Republikane. Përkundrazi, me një mirësi ekstreme ai tregon përditshmërinë e tyre. Dhe ajo që del nga këto imazhe është jeta e qetës e këtyre « njerëzve të guximshëm » që pëlqejnë të sodisin vetura të vjetra dhe të blejnë armë zjarri. Pasi e kishte përfunduar filmin, Wiseman tha se ai kishte qenë veçanërisht i befusuar me religjiozitetin e tyre dhe me kuriozitetin për atë që është jashtë, madje edhe për Indianopolisin, qytetin e madh, shumë pranë tyre. Ky përqëndrim te « të bardhët e vegjël » do t'u japë historianëve shumë tregues për SHBA-në e 2018-s. Në këtë rast, Wiseman-i, kronikan i kohës së tij që nuk i lejon vetes asnjë gjykim a priori mbi atë që filmon, është një arshivist i madh.

Ky njeri i letrave dhe frankofil ka xhiruar një film në Mbretërinë e Bashkuar (*National Gallery*, 2014) dhe katër në Francë⁽¹⁾ dhe ka marrë pjesë rregullisht në Festivalin E Kinemasë reale në Bibliotekën publike të informimit (Qendra Pompidu), në Paris. Fillimisht, filmat e tij janë prodhuar nga një rrjet publik amerikan, Public Broad casting Service, që, të paktën, i siguron atij një shpërndarje kombëtare. Do të duhej të priste disa dhjetëvjeçarë përpara se filmat e tij të shiheshin më gjerësisht dhe të shpërndaheshin për t'u parë në salla kinemaje. Esencialisht, vepra e tij ka të bëjë me vëzhgimin dhe zbulimin e ndryshueshëm të institucioneve amerikane, gjë që e ka shpënë me dhjetëra herë në New York, në të paktën tetëmbëdhjetë shtete të SHBA-ve, në Kanalin

e Panamasë (*Canal Zone*, 1977), në Lindjen e Afërme (*Sinai, Field Mission*, 1978) dhe në Gjermani me rastin e manovrave të forcave ushtarake amerikane (*Manoeuvre*, 1979). Ky ansambël, me më shumë se tridhjetë e pesë filma, përbën një dëshmi unike për gjysmën e shekullit të historisë të fuqisë së parë botërore, duke treguar orët e saj të mëdha dhe dyshimet, nga presidenca e Lyndon Johnson deri te kjo e Trump-it (2). Karriera e Wisemanit nis me një burg psikiatrik për kriminelët e « çmendur » në Bridgewater (Massachusetts) dhe metodat e një kohe tjetër që përdorehin aty : ushqimi me forcë i një të burgosuri që refuzonte të hante me anën e një tubi kauçuku të rrsuar thellë në hundë. Me *Titicut Follie*, censuruar për një kohë të gjatë, ai hedh bazat e praktikës kinematografike të cilat do t'i korrigjojë më pas, thjesht, duke u dhënë pas montazhit të alternuar dhe kështu do të afirmohet tërësisht si një dokumentarist – një fjalë që ai nuk do ta përdorë kurrë ; ai do të preferojë gjithmonë të thotë : « *Unë bëj filma* ». Filma që mund të jenë trillim dhe dihet atëherë ndikimi që pati *Titicut Follies* për *Fluturim përmbi çerdhen e një të krisuri* të Milosh Forman (1975). Sepse kjo thellësi, kjo zhytje në realitet, në dukje, nuk është veçse shfaqja e kinemasë direkte, siç ndodhi në vitet 1960 ; duke ndjekur personazhet me kamera që erdhën e u bënë të lehta. Nuk është rastësi që një film mban emrin e një reviste mujore, që gardianë dhe të burgosur punojnë së bashku : Wiseman nuk ka pasur për qëllim që të rindërtojë në mënyrë të sheshtë të vërtetën e botës, por ta kthejë realitetin duke shfaqur të paprtiturat e tij, duke harruar që i famshëm është vendi që ai ka zgjedhur ose lidhja mes njerëzve që ai filmon.

Qysh në fillimet e tij, ai heq dorë nga pikëpamjet e paramenduar apo të njëanshme. Më vonë, ai do ta formulojë qartas, duke qortuar mënyrën me të cilën punojnë disa kineastë : « *Unë përpiqem të qëndroj me sytë mbyllur dhe filmi, para së gjithash, është sinteza e gjithë asaj që unë kam mësuar gjatë xhirimit dhe jo e asaj që unë pata menduar për atë vend gjatë shumë javëve. Përndryshe do të bënim kinema si të Michael Moore* (3). » Kështu, *High School* (1968) portretizonte një liceist që nuk është prekur ende nga era e kontestimeve dhe përfundon në leximet publike të një letre që një nxënës, i cili do të vdesë në Vietnam, i dërgon ish-mësuesit të tij. Kjo mbyllje mund të interpretohet edhe si një apologji për një sistem që është i aftë të formojë qytetarë të vetëdijshëm për detyrat e tyre, por edhe si një dënim...

Sa i përket *Law and Order* (1969), ku ai ndjek policinë e Kansas City-t, dhe ku e qortojnë që nuk ka dhënë brutalitetin e forcave të policisë kundër manifestuesve që ishin denoncuar prej të gjithëve, një film anti polic, përgjigjja e tij ishte e qartë : « *Më janë dashur vetëm pesëmbëdhjetë minuta ulur në karrige pranë një veture policie për të mësuar dhe kuptuar se ajo që i bëjnë njerëzit njëri-tjetrit kërkon medomeos aparatit policor(...). Policia është shprehje e humanizmit. [Ajo] buron prej nesh dhe brutaliteti i [saj] është brutaliteti ynë* (4) »



Frederic Wiseman

Në filmin e tij mund të shohësh agjentë të dhunshëm dhe paralelisht me të pamje të tjera ato që Wiseman i quan « *akte xhentile* » .

Në vitet 1960-1970 ai nis e merret me funksionet thelbësore të një shteti : shkolla (*High School*), policia (*Law and Order*), shëndetësia (*Hospital*, 1970), ushtria (*Basic Training*, 1971), drejtësia (*Juvenile Court*, 1973), përkrahja shoqërore (*Welfare*, 1975). Duke nisur nga vitet 1980, ai e zgjeroi fushën e tij të veprimit dhe, në mënyrë të papritur, e hapi objektivin duke filmuar psh., një agjenci manekinësh (*Model*, 1980), një fushë vrapimi të kuajve (*Racetrack*, 1985) ose marketin e madh Neiman Marcus të Dallasit (*The store*, 1983). Secili nga këto filma përbën një univers më vete. Wiseman merr gjithë kohën që ai e çmon të nevojshme, për të shkruar çdo herë një kapitull në librin e tij të madh për botën.

Për të folur për kujdesin paliativ (ilaçet që nuk të shërojnë por që të qetësojnë, përkohësisht), ai ndërton një nga veprat e tij më të forta, një film-lumë, ku asgjë nuk është e padobishme (*Near Death*, 1989). Në dukje, atij iu deshën dyqind e tetëdhjetë minuta për të filmuar fshatin e peshkatarëve në *Befast, Maine* (1999), por, me anë të një montazhi virtuoz, vetëm në njëmbëdhjetë minuta ai tregoi fabrikimin e konservave të sardeleve.

Që nga fillimi i rrugës së tij, ai është shfaqur si një mbledhës i shkëlqyer i fjalëve më të shënuara. Kur dëgjon ata që flasin në filmat e tij, të duket sikur është një ligjërim integral, bisedë dhe debat, argumente të mprehta të senatorëve të Idahos mbledhur në Boisë, në kryeqytet për të debatuar mbi çështjet konstitucionale (*State Legislature*, 2007), ose të ndjekësh në *High Schoole II* (1994) inkursionin në një shkollë progresiste të një lagjeje njujorkeze që ka harruar trashëgiminë e saj nga Spanish Harlem, bashkëbisedimin e gjatë mes dy profesorësh, një nxënës kolegj shtatzënë dhe prindërit e saj, e ardhmja e saj... *Ex Libris* (2017) të lejon të mësosh për shtrëngimet financiare të kredive që prekën New York Library dhe, pavarësisht kësaj, me diskutimet e personelit përgjegjës për ta vazhduar aktivitetin. Nëse ai është avokati i informimit dhe ia arrin, kështu, që të japë në mënyrë konkrete dhe me zërat originalë debatet, shqetësimet sfidat e sotme, kjo vjen prej kushteve në të cilat ai filmon. Me operatorin e tij që përdor një kamera të lehtë – më të lehtë e prodhuar në rrymë të zhvillimit teknologjik – me një asistent, një djalë, ai kërkon që, para së gjithash, të merret me zërin dhe jo me imazhin. Që këtë vjen kjo mënyrë unike që të bëhesh zot i fjalës, të fiksosh dialogun.

I mbështetur fort te amendamenti i parë i Kushtetutës që i lejon të filmojë në vende pub-

like, me përjashtim të Shtëpisë së Bardhë, prej së cilës është refuzuar të hyjë, - ai ka mundur të instalohet në një gjykatë, në një zyrë të ndihmës sociale, në një kazermë ose në një klasë shkolle. Dhe, në momente të gjata, ai qëndron ashtu si i shtypur nga vendet e njerëzve dhe nuk e lëviz kameran asnjëherë. Për çdo ditë ai regjistron një deri në dy orë. Dhe, në fund, ka në zotërim qindra orë filmime, prej të cilave do të përdorë vetëm një përqindje të vogël edhe nëse ka filmuar lumenj pamjesh. Duke përsëritur që xhirimet janë një zyrë diktimi, ai e ndërton filmin e tij në montazh, atje ku ai zbulon me të vërtetë objektin e vet – një montazh – mozaik në të cilin skenat u përgjigjen njëra-tjetres dhe kompozohen sipas një logjike që nuk ka asgjë të përbashkët me rrjedhjen lineare dhe kronologjike. Kalon gjashtë deri në tetë muaj « duke shkruar » filmin e tij.

Ai mendon se gjithçka që ndërhyt në film ngjan sikur mban një fjalë të vërtetë që e shqipton me bindje, me qartësi dhe me një cilësi shprehjeje që është përtej kinemasë së vërtetë të dikurshme. Për më tepër, nëse ka ndonjë vështrim drejt kameras, ato janë të pakta në numër, sepse njerëzit e harrojnë shpejt praninë e saj, ndihmuar, po ashtu, edhe prej mungesës së lëvizjes së aparatit. Disa mund të kenë shtyrsën që të gënjejnë, por, për realizuesin askush nuk është i aftë të luajë një tjetër rol veç të tijit në më shumë se disa minuta. Wiseman pranon, sigurisht, se ai interpreton botën, por ai pohon me forcë : « *Dokumentarët- ashtu si pjesët e teatrit, romanet, poemat – u përkasin formave fiksonale dhe nuk kanë asnjë përdorim social të matshëm* (5) » .

Ky adhures i madh i Samuel Beckettit, prej të cilit, dikur, ai pat vënë në skenë « *Oh les beaux Jours* » (Ah ! Ditët e bukura !), nuk ka realizuar veçse një fikson (*Letra e fundit*, 2002), një kthjelltësi e mahnitshme në bardhë e zi, marrë nganjë kapitull i *Jeta dhe fati*, e Vassili Grossman. Ajo që i shkruan rrëfimtaria djalit të saj vrrarë nga nazistët përshkon gjithë kinemanë e Wisemanit : *Çfarë të të them për njerëzit ? Ata më çudisin për mirë e për keq. Ata janë jashtëzakonisht të ndryshëm, megjithëse të gjithë e dinë se kanë të njëjtin fund.* »

(1) *La Comédie-Française ou l'Amour joué*, 1996; *La Dernière Lettre*, 2002; *La Danse. Le ballet de l'Opéra de Paris*, 2009; *Crazy Horse*, 2011.

(2) L'intégrale de l'œuvre de Frederick Wiseman est disponible chez Blacq Out. On peut se procurer la totalité des films réalisés jusqu'en 2015 séparément ou en trois coffrets. *Ex Libris* est sorti en DVD en 2018 et *Monrovia, Indiana* paraît en septembre 2019.

(3) « Wiseman par Wiseman », *Images documentaires*, no85-86, Paris, juin 2016.

(4) « Mort et résurrection du réalisme américain », entretien avec Claire Clouzot, *Écran*, no 50, Paris, septembre 1976. Cité dans Maurice Darmon, *Frederick Wiseman. Chroniques américaines*, Presses universitaires de Rennes, 2013.

(5) Frederick Wiseman, « Le montage, une conversation à quatre voix », *Images documentaires*, no 17, 2e trimestre 1994.

Anna Ahmatova, ardhja e dytë në Shqipëri

NGA ILIR YZEIRI

Para disa kohësh u botua në shqip vëllimi me poezi i poetes ruse Anna Ahmatova, « Ballo me maska në park » (PoeziOnufri, 2019), përkthyer me mjeshtëri nga Aurel Plasari, me parathënie nga shkrintari i njohur, Ismail Kadare. Në mjeshterin kulturor shqiptar emri i kësaj poetes nuk është i panjohur. Ajo ka hyrë dy herë në kufirin e memories kolektive të publikut që është marrë me letërsi e art. Herën e parë erdhi si e kryqëzuar, si modeli që nuk duhej ndjekur, por duhej stigmatizuar. Ishte viti 1947. Shqipëria po hynte në dimrin e gjatë të diktaturës dhe letërsia e artet do të duhej t'i nënshtroheshin projektit të ri të elitave komuniste. Kaluan shpejt vitet '45, '46 kur në ambientin shqiptar të pasluftës zotëronte një atmosferë paqeje dhe frymëzuesi i kësaj klime, Sejfulla Malëshova, përmes nxitjes së botimit të revistës « Bota e re », që doli vetëm 7 numra si dhe pas përpjekjes për të bashkuar në një organizatë të vetme të gjithë shkrintarët pa dallim besimi e ideje, dështoi dhe u mënjanua nga jeta publike. Ai vdiq i dëbuar nga kryeqyteti si magazinier në qytetin e Fierit. Në vitin 1947, shkrintarët dhe elitat që dolën fitimtarë nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, vendosin të ndjekin modelin rus të instalimit të realizmit socialist. Pasi e mbyllën revistën « Bota e re », nën modelin e revistës ruse « Nashaja Literaturnaja », nxorën revistën « Literatura Jonë », që do të bëhej zëdhënëseja e modelit të ri të artit dhe letërsisë shqiptare. Numri i parë i kësaj reviste hapet me një tekst, i cili, përgjatë gjithë periudhës së diktaturës, mbahej si modeli i parë teorik i kup-

Siç vë në dukje edhe Kadare në parathënieën e librit, te ne, qarkullimi letrar, pas rënies së diktaturës, është shënuar edhe nga botimi i atyre autorëve të huaj që kanë qenë të akuzuar e të anatemuar nga kritika e socrealizmit. E tillë është edhe Ahmatova. Nga ana tjetër të duket sikur ky botim plotëson librin e fundit të Kadaresë « Kur sunduesit grinden » (Tiranë, 2018), që u kushtohet tri minutave të bisedës mes Stalinit e Pasternakut për fatin e Osip Mandelstajmit. « Ana Ahmatova, Osip Mandelstajm, Marina Cvetajeva, Boris Pasternak, përbëjnë një « katërshë të veçantë », siç e ka quajtur ajo vetë në bisedat e saj. Unazë prej katër perlash, secila prej tyre rrezëllinte edhe dritë edhe përzitje, ajo ka hyrë në fundnajtën e artit të poezisë ruse të shekullit që porsa shkoi », - shkruan Ismail Kadare në parathënieën e botimit në shqip. Siç dihet, nga viti 1900 e deri në vitin 1910 e ndoshta pak më këtej, në Rusi u zhvilluan disa rryma letrare si simbolizmi, akmeizmi, imazhizmi, etj. Ndërkaq, në anën tjetër, vendi ishte përfshirë në revolucionin më të madh social-politik që kishte njohur bota deri atëherë dhe në Rusi u vendos diktatura e proletariatit. Bashkë me të lindi edhe një art dhe një kulturë e re, e cila i shpalli luftë artit të mëparshëm të quajtur feudo-borgjez, sepse nuk ndihmonte dhe nuk pasqyronte jetën e popullit, por kishte rrëshqitur në batakun e misticizmit reaksionar. Është paradoksale, por, në një mënyrë më të rrudhur, e njëjta gjë ndodhi edhe në Shqipëri. Ashtu si në Rusinë e fillimit të shekullit, edhe te ne u vu re një tendencë për të bashkëjetuar

suar mjaft këtë poete dhe në vitin 1965 ajo ishte e nominuar për çmimin Nobel. Ndërkaq, të gjithë bien në një mendje se për ta njohur mirë atë, duhen mbajtur parasysht, sidomos, ajo që është thënë gati në një zë për të se do të duhej një forcë jo e zakonshme për një femër, do të duheshin poemat e saj therëse për dashurinë, fatkeqësinë dhe dhimbjen ruse si dhe ato për universin që t'i skalitej asaj një vend në Olimpin letrar të zotëruar nga meshkujt.

Libri « Ballo me maska në park », botuar te ne, përmban 79 poezi. Studiuesi dhe përkthyesi Aurel Plasari ka bërë kujdes që të sjellë në shqip gjithë periudhën e gjatë të krijimtarisë së saj. Aty janë poezitë e para që vijnë nga jeta e salloneve dhe asaj që është quajtur epokë e argjendit në letërsinë ruse, ku në një ballo me maska, një kalorës mund t'i ketë thyer pendën në kapelë një markezeje. Më tej rrëfimi dhe

ka humbur drejtpeshimin dhe ajo e vizaton këtë gjendje boshi dhe asgjëje me vargje ku të duket se megjithëse është pranverë dhe drurët zhapëllijnë nëpër erë, trupi është gati si pa peshë dhe ti nuk di as shtëpinë ku e ke:

Kur këngën që dikur të qe mërziut
Ti e këndon me mall si t'ish e re (f. 16)


Në jetën e saj ajo pati shumë fatkeqësi. Në vitin 1921 komunistët sovjetikë i pushkatuan të shoqin, themeluesin e akmeizmit rus, Nikolaj Gumiljov, ndërsa të birin, Lev Gumiljov, ia kishin arrestuar dhe degdisur në Gulag. Pikërisht vajtje-ardhjet në burgjet ruse dhe pritjet në zyrat e KGB-së për të marrë njoftim për të birin shenjua te ajo një përmasë tjetër të poezisë që ajo i përmbodhi në ciklin *Requiem*. Kritika ka vënë re se ajo është poetja unikalë që ka vizatuar emocionet e ngrira dhe dhimbjen e patreguar të reshtave pafund të nënave, grave e motrave përpara gulagëve rusë. Dhe, në shënimin në faqen 33, ajo tregon se si një ditë duke pritur në radhë para zyrrave të KGB-së, në acar, një grua që e ka njohur, i afrohet dhe e pyet. Po këtë mund ta përshkruash? Po. Mundem, - i thotë ajo. Dhe si apoteozë të të gjitha këtyre poezive me këtë temë, do të veçonim poezitë « Dita e të vdekurve » (f.39-40) dhe Epilog (f.41). Në të parën ajo ka në vështrim ato mijëra gra shamizeza që humbën bijtë e burrat në humnerën e krimin stalinian. Me to është dhe poetja, e cila, duke kujtuar ditën e të vdekurëve, thotë se, nëse një ditë ndokush do të kujtohet t'i bëjë një monument, e dua ta ngrejë këtu përpara kësaj dere burgu:

Këtu të ma ngrënë, ku llozi nuk lot,
ndërsa pres në këmbë treqind orë plot. (f. 40)

Një vit para vdekjes, në vitin 1965, ajo u nderua nga Universiteti i Oxfordit me titullin « Honoris causa » dhe shtypi anglez e vlerësoi si një nga poetet më të mëdha të kohës. Poezitë e këtij vëllimi janë vezullime të trishta të një shpirti që u ndrit nga shkëlqimi i një epoke të artit në fillim të shekullit XX dhe u errësua pastaj nga dhuna dhe poshtërimi përreth 50 vjet, e detyruar të jetonte me kujtimin e të shoqit të vrarë dhe të të birit në burg. Si mallkim për kohën që do të vinte dhe për dashurinë që nuk do ta provonte më kurrë, duket se është kjo poezi shkruar në vitin 1917.

Natë e njëzetënjëshit. Ditë e hënë
Kryeqyteti krejt në terr të zi.
Seç u ngrit e shkroi një i lënë
Që në botë paskësh dashuri.
Dhe prej verbësisë a përtacisë
Na i zunë besë në gdo vend:
I këndojnë këngë dashurisë,
Lënë takime, ndarja sa s'i çmend.
Po misteri ka për t'u zbuluar
Dhe kanë për të mbetur krejt pa zë
Unë këtë sëmundje e paç provuar
Dhe që ahëre s'u shërova më.

(1917, Pjetërburg.)



Modigliani - Anna Ahmatova

timist socialist të letërsisë dhe shënonte kështu kufijtë ku do të duhej të mbështetesh gjykimi dhe vlerësimi i artit dhe letërsisë së realizmit socialist. Ky tekst ishte fjala e Kryetarit të Asamblesë së Sovjetëve, Andrej Zhdanov, me shkrintarët rusë në të cilën ai kritikonte revistat « Zvezda » dhe « Leningrad » pse kishin botuar poezi dhe poema të poetes Anna Ahmatova. Jehonën e kësaj fjale e botonte për revistën ruse një shkrintar tjetër i revolucionit, Fadajev. Revista « Literatura Jonë » në numrin e saj botonte pikërisht këtë shënim programatik të Fadajevit për detyrat e letërsisë dhe artit në socializëm duke marrë si shtytë modelin e kundërt, atë të Anna Ahmatovës, frymëzuar nga fjala e Zhdanovit.

me rrymat dhe drejtimet e ndryshme në letërsi. Mjaft të kujtojmë se në kryesinë e Lidhjes, në Konferencën e parë, u zgjodhën edhe Vincens Prenushi e priftërinj të tjerë, por edhe Mitrus Kuteli dhe të rinjtë partizanë, natyrisht, si Shuteriqi e Musaraj. Ishte një kohë kur jeta kulturore rridhte e qetë. Mjaft të kujtojmë se Lasgush Poradeci shkruante edhe si gazetar i kulturës për koncertet simfonike që jepeshin në kinema « Kosova » në drejtimin e dirigjentit italian Ripi. Mirëpo, kjo paqe zgjati shumë pak.

E quajtur ikona e vuajtjes dhe e dhimbjes ruse, Anna Andrejevna Gorenk, e njohur me pseudonimin letrar Anna Ahmatova, lindi në Odesë më 11 qershor 1889 dhe vdiq në Moskë më 5 mars 1966. Kritika europiane e ka vlerë-

mëkati, dashuria që vjen si prej një prekjeje të dorashkës. Dhe pastaj ndarja, malli që të mbështjell në grykë lotët, vetmia. Poetja pat vizituar Parisin në kohën e asaj që është quajtur *Belle Epoque* dhe aty pat takuar edhe piktorin bohem Modiljanin, i cili i pat bërë asaj disa portrete. Pa e menduar gjatë, ajo kthehet në Rusi dhe aty përfshihet në jetën kulturore që ziente nga rrymat moderne si akmeizmi, futurizmi, simbolizmi, etj. Të kësaj periudhe janë poezitë që vizatojnë vdekjen së cilës poetja i lutet që mos t'i marrë me vete kujtesën apo përhumbja në rutinë dhe në normalitet deri te brenga për takimin e dështuar. Ndërkohë, Rusia po zien nga triumfi i revolucionit, ndërsa poetja lutet që « reja e zezë mbi Rusinë/ të shndërrohet në dritë e lavdi » (Lutje). Tani duket se jeta e saj

Bëjeni buzëqeshjen profesionin tuaj

NGA GABRIELLE SCHÜTZ*

Qëndro "drejt!", "buzëqesh", "krihu përsëri", "mos e kthe shpinën!" Këto urdhëra nuk dalin nga goja e një nëne grindavece, por nga ato të eprorëve hierarkikë që u drejtohen punonjëseve të reja, veshur me kostume. Paguar me tarifën ndër-profesionale të minimumit jetik për orë, hostesat (vajzat që punojnë nëpër panairë a promovime të mëdha) punësohen në masën dërmuese nga agjenci që i dërgojnë pastaj në kompanitë kliente. Pasi popullojnë manifestime sportive, inagurime, kongrese apo panairë të mëdha publike, siç është Mondial Paris Motor Shoë (dikur Mondial de l'Automobile de Paris, panairi i automobilëve në Paris) ato orientojnë publikun, duke harruar, gjatë punës, "shakatë" e vizitorëve, të cilët i komplimentojnë për "trupin", "karrocerinë" e tyre ose pyesin nëse ato janë përfshirë në çmimin e veturës.

Ato sigurojnë, gjithashtu, misionet në ndërmarrje, zakonisht më të gjata. Atëherë i gjejnë të postuara pas sporteve për të pritë vizitorë dhe punonjës, dhe për të mbajtur standartin telefonik. Zakonisht të moshës nën 30 vjeç, ato përfaqësojnë rreth 13,000 rrogetare në Francë që punojnë në kompani, pa llogaritur mijëra të tjera të dërguara gjatë ngjarjeve që zhvillohen rregullisht.

Kompanitë e shërbimit nuk kënaqen vetëm me kërkimin e grave të reja me një "paraqitje të mirë" dhe pajisjen e tyre me uniformë: ato vëzhgojnë qëndrimin e tyre, tonin e zërit kontrollojnë lartësinë e takave në centimetër, nuancën e të kuqit të buzëve, shkallën e transparencës së çorapeve, mënyrën e lidhjes së flokëve... "statutet e cilësive që ato u imponojnë, zbulojnë llojin e feminitetit që pritet prej tyre: "Grimi juaj nuk duhet të jetë agresiv, gjithnjë duhet të ndihet që keni treguar kujdesin më të madh për të qenë më e bukura", thotë njëra prej tyre, e cila saktëson, gjithashtu, që punonjëset duhet të kenë "duar të mbajtura mirë", një "makijazh gati natyral, por të sofistikuar", të përdorin një "parfum të lehtë dhe të zgjedhur me shije", të mos mbajnë asnjë "gur të çmuar me fantazi ose të dukshëm" dhe "të respektojnë rregullat e mirësjelljes".

Fillimisht, e konceptuar në modelin e zonjës së ajrit, hostesa e ceremonive pa dritën në vitet 1960. Atëherë, qëllimi kryesor ishte rekrutimi i vajzave të reja nga familje të mira. Në vazhden e lëvizjes për marrëdhëniet me publikun, paraardhës i komunikimit të ndërmarrjeve, shkollat e "suksesit femëror" zhvillojnë trajnime. Ato kërkojnë të frymëzojnë "artet e kënaqësisë", që u mësonin dikur nënat e tyre borgeze dhe synojnë kompetencën profesionale (stenodaktilografi dhe anglisht), si dhe "lulëzimin e personalitetit femëror" (2), duke dhënë "kurse për bukurinë". Kjo imagjinatë qëndron, edhe nëse rekrutimi synon audiencë më të larmishme: gra të reja nga lagje të bukura, në kërkim të parave të xhepit, tani përzihen me të tjera ardhur nga një shtresë modeste që nxjerrin të ardhurat e tyre kryesore nga kjo veprimtari; studentet takohen me artiste pa para ose të diplomuara të kohëve të fundit, të cilat janë duke pritë të kapin ndonjë punë në fushën e tyre. Në kompanitë kliente, atyre u kërkohet të sillen si zonja shtëpie me të fuarit e tyre.

Përmbajtja dhe fushëveprimi i punës së tyre janë shumë të ndryshme. Përveç aktivitetit të pritjeve, zonjat e shtëpisë, ndonjëherë, bëjnë punët e shtëpisë: përgatitin kafënë, ujin bimët, sigurojnë rregullin e duhur të vendeve ku zhvillohen ceremonitë. Në evente, i gjejnë para arkave, në garderoba, në sallat e leksioneve për të kaluar mikrofonin gjatë një debati, për t'u dorëzuar dhuratat të ftuarve gjatë ceremonive, ose para kompjuterave për të shtypur dokumentet e folësve. Në kompani, ato shpërndajnë postën, vendosin pullat mbi kolitë postare, rezervojnë dërgesat dhe taksitë, menaxhojnë caktimin e dhomave të mbledhjeve, klasifikojnë dokumentet e dosjeve, menaxhojnë furnizimet e zyrës, bëjnë fotokopje, bëjnë përkthime të vogla. Ndonjëherë, pritja e publikut bëhet edhe një detyrë dytësore, si për ato që shërbejnë si spëcialiste të shitjeve plotësuese në standat e panairëve apo ngajnë me asistentët e shërbimeve të përgjithshme.

Sikurse të gjitha aktivitetet e njohura si "tipike femërore" (asistentet në çerdhe, ndihmëset e shtëpisë), ky profesion u huazon punëve shtëpiake, tipare të vetëflijimit dhe.. të padukshmërisë. Hostesat s'kanë pse të skuqen nga kualifikimet e tyre. Ato me një diplomë janë më shumë sesa vajzat e tjera të reja të brezit të tyre, shumë më tepër që kanë të paktën një diplomë bachelor, dhe po aq që kanë kaluar një bach + 2 ose plus (4). Kjo nuk është për t'u habitur: Punëdhënësit i kushtojnë vëmendje të madhe mënyrës së tyre të shprehjes, në frëngjisht dhe anglisht, si me gojë dhe me shkrim. Kërkojnë mendjemprehtësi dhe cilësi përshtatshmërie; megjithatë, ato, shpesh, konsiderohen si objekt roli i të cilit kufizohet tek buzëqeshja. Agjensitë nuk janë të fundit që përcjellin këtë imazh, siç dëshmojnë nga një slogan i imagjinuar në vitet 2000 nga Penelope, një nga kompanitë më të mëdha që shërben tregun: "Buzëqeshjen tuaj- kthejeni në punë!" Zhvlerësimi i hostesave ka të bëjë, gjithashtu, me statusin e tyre. Ato nuk punësohen nga kompanitë që përdorin shërbimet e tyre, por nga ndërmjetësit, me kontrata me afat të caktuar (CDD) për ngjarjen ose me kontratë të përhershme (CDI), përgjithësisht, me kontratë të pjesshme, për postet në kompani. Ato punojnë në ambientet e ndërmarrjes kliente përkrah punonjësve të saj, pa përfituar, megjithatë, të njëjtat të drejta, siç janë këshilli i ndërmarrjes ose menca. Situata e tyre është e ngjashme me punonjësin me nënkontratë fikse. Kjo formë e veçantë e nënkontraktuar bën të mundur që një pjesë e fuqisë punëtore të dalë nga lista e pagave në bilanc - dhe kështu të sigurohet një performancë më e mirë kundrejt aksionerëve ose të shmangët arrija të pragjeve të caktuara prej ligjit i cili detyron institucione përfaqësimi të personelit.

Nënkontraktimi fikse dëmton mundësitë e tyre për karrierë. Ai thyen rrugët tradicionaliste të evolucionit që ekzistonin nga e kaluara kur mund të punësoheshe në një ndërmarrje në fund të klasifikimit, në recepsion për t'u bërë më pas si asistentët dhe ngjitur progresivisht shkallët e karrierës. Nëse shoqëritë kliente nuk interesohen të ndërhyjnë për mbarëvajtjen e detyrave dhe kushteve të punës të hostesave, do kenë tendencë të sillen si punëdhënëse. Ato e zgjedhin shpesh hostesën e "tyre" në bazë të një preselektimi nga shoqëria në shërbim të tyre, i japin direktiva apo i kërkojnë të bëjnë orë plotësuese pa ia referuar punëdhënësit zyrtar. Për sa u përket hostesave, zhvillojnë shpesh një ndjenjë përkatësie ndaj shoqërisë kliente dhe shumë më pak ndaj kompanisë së originës, përgjegjësit e së cilës i shikojnë rallë.



Foto nga Elena Buzmakova nga Pexels

Kështu, Çelestja(5), e punësuar e Business Accueil-it është ngjitur pas kësaj shoqërie që të bëhet « shefe e hostesave » e laboratorit të madh farmaceutik me të cilin ajo është lidhur edhe emocionalisht që prej tre vjetëve dhe ku punojnë dhjetëra kolege me më pak vjetërsi. Megjithatë, Malika, që nuk ka shkelur asnjëherë në këtë ndërmarrje, është zgjedhur për atë post. Çelesta mendon se klienti do të mbështesë kandidaturën e saj (ajo mirëkuptohet për bukuri me të), por dyshon se përgjegjësi i saj në Business Accueil do të jetë kundër kandidaturës së saj. Malika, nga ana e saj, është e sigurtë që klienti ka kërkuar lirisht një shefe të hostesave ardhur nga një tjetër ndërmarrje për të sjellë « gjak të ri » dhe « thyer zakonet e këqija ». Ai, madje ka sugjeruar të mos e pranojë Çelestën, e cila është dukshëm e mërziur. Klienti shërben atëherë si huazues që shfaq për të vlerësime të pafavorshme. Në të kundërt, agjencia, mund të heqë dorë nga dhënësi i urdhrave (« Klienti nuk të dëshiron më ») për të provokuar një gjendje jo të mirë psikologjike ose dorëheqje. Për të qëndruar e punësuar duhet ta tërheqësh mushkën në shoqërinë klient, gjithë duke ëndërruar marrëdhënie të mira me shoqërinë që të ka huazuar. Një ushtrim gjithë vigjilencë dhe me ekulibër balancues.

Profesioni duket arkaik për shkak të imazhit të vjetëruar të feminitetit që shfaqet aty. Sidoqoftë është zyra e ndryshimeve të pagave që vlen. Një numur në rritje të punësuarish kanë punë të përhershme në një shoqëri klient, gjithë duke qenë të punësuar në një kompani tjetër që i ka huazuar këtu. Sektori i shërbimeve të ndërmarrjeve (një nëpunës në shtatë i sektorit të shitjeve, jashtë agrikulturës dhe sektorit financiar) përbën kontingjentin më të madh (6). Aty përfshihen agjentët e sigurisë (afërsisht 140 000 rrogetarë me kohë të plotë në 2016) ose punonjësit e pastrimit (404 000, prej tyre 294 000 rrogetarë me kohë të plotë në 2015), por gjithashtu inxhinierë të shoqërive të shërbimit në inxhinierinë informatike (SSII) ose konsulentët e shoqërive këshillimore. Zgjerimi i kontratave me kohë të plotë ka sjellë një fuqi punëtore akoma më fleksibël që CDD kërkona ta kthejë në të përkohshme.

Me një arsenal të tillë, kërcënimin e qeverisë për goditjen e punëdhënësve me gjobë (normat e kontributeve të ngritura) në rast të përdorimit jo të rregullt të kontratës me afat të caktuar nuk ka të ngjarë të eliminojë punëdhënësit

(1) Évaluation de l'auteur à partir des données disponibles provenant des organisations patronales du secteur pour l'année 2017.
(2) Entretien avec Jean-Claude Tunon, fondateur de l'École internationale d'hôtesse Tunon, Hôtesse sans frontières, no 3, Paris, septembre 1970.
(3) Formations dispensées par l'École parisienne des hôtesse, Hôtesse Magazine, no 1, Paris, juillet 1966.
(4) Statistiques issues d'une base de données de 659 individus construite lors de cette enquête.
(5) Les prénoms et les noms de société ont été modifiés pour préserver l'anonymat des personnes.
(6) Elaboration des statistiques annuelles d'entreprise (Esane), Institut national de la statistique et des études économiques (Insee), Paris, 2014.

REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP

Botues: Instituti "Musine Kokalari" - Prishtinë (Kosovë)

Drejtor: Belgzim Kamberi

Kryeredaktor: Ilir Yzeiri

Redaksia: Leart Kola, Andi Kananaj.

Përkthimi: Loretta Mokini, Entela Cani

Layout design: Dritan Lleshi

Tirazhi: 1500

Email: botadiplomate@gmail.com

Botimi i "Le Monde Diplomatique" në gjuhën shqipe mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë- SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde, Association Gunter Holzmann.
Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
Tél.: 01-53-94-96-01. Télécopieur: 01-53-94-96-26
Courriel: secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet: www.monde-diplomatique.fr

Directoire: Serge HALIMI, président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD, Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales: Anne-Cécile ROBERT
Secrétaire générale: Anne CALLAIT-CHAVANEL

Directeur de la rédaction: Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints: Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d'édition: Mona CHOLLET
Rédaction: Akram BELKAÏD, Philippe DESCAMPS, Evelyne PIELLER, Hélène RICHARD, Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie: Cécile MARIN
Site Internet: Guillaume BAROU, Thibault HENNETON
Conception artistique: Maria HERARDI, Boris SEMENIAKO (avec la collaboration de Delphine LACROIX pour l'icongraphie)
Rédacteur documentaire: Olivier PRONET
Mise en pages et photogravure: Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction: Xavier MONTHEARD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion: Bruno LOMBARD
Directeur commercial, chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion: Zaïa SAHALI
Secrétariat: Yuliya DAROUKA (9621), Sophie DURAND-NGÔ, attachée communication et développement (9674), Eleonora FALETTI (9601)
Courriel: prenom.nom@monde-diplomatique.fr
Fondateur: Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs: François HONTI, Claude JULIEN, Ignacio RAMONET

Publicité: Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)

Diffusion, mercatique: Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUDE, Carole MERCERON, Christiane MONTILLET
Relations marchands de journaux (numéro vert): 0805-050-147
Service relations abonnés
● Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé) www.monde-diplomatique.fr
● Depuis l'étranger: (33) 3-21-13-04-32

Reproduction interdite de tous articles, sauf accord avec l'administration
© ADAGP, Paris, 2019, pour les œuvres de ses adhérents
Prix de l'abonnement annuel à l'édition imprimée: France métropolitaine: 59 €
Autres destinations: www.monde-diplomatique.fr/abo

FAQE 2-3	Shqipërimi i «Le monde diplomatique» / Kuptimi i filozofisë dhe sfida e demokratizimit, nga SERGE COSPÉREC DHE FRÉDÉRIC LE PLAINE / Emancipimi homoseksual, çështje politike, nga JEAN STERN
FAQE 4-5	"Mëshira", mjerimi i fshehur i përzgjedhjes sociale në shkollë, nga CLOTHILDE DOZIER DHE SAMUEL DUMOULIN / Në kutinë e veglave të Andre Gorzit, nga ALIOCHA WALD LASOWSKI

FAQE 6-8	Ana e fshehur e mrekullisë portugeze, nga MICKAËL CORREIA / Mizat dhe tigrat kinezë
FAQE 9-10	Në kuzhinën e investigimit, nga PIERRE PÉAN / Deputeti dhe jahti i tij / Drejtuesit blihen që c'ke me të! / la vlen të jesh i pasur! / Nëse s'ka para, atëherë s'ka debat!
FAQE 11	Ruanda, gjenealogjia e genocidit, nga PHILIPPE LEYMARIE / Kandidatët e eleminuar në Senegal

FAQE 12	Ta qortojmë apo ta ndryshojmë botën? Nga BENOIT BRÉVILLE DHE RENAUD LAMBERT / Mafiet e rërës
FAQE 14-15	Brazil, misteri i një grushti shteti juridik, nga PERRY ANDERSON
FAQE 16-17	Opozitarët rusë janë gjithmonë të korruptuar, nga TONY WOOD / Dikush që është me të vërtetë i keq

FAQE 18-19	Vendi që i ka shpallur luftë marrëveshjes, nga YLLI PATA
FAQE 20	Marketingu gjinor për Gerda Taronë, nga ANNE MATHIEU
FAQE 21	Pasoja e krizës në jetën bashkëshortore, nga HUBERT ARTUS / Përballë heshtjes së fantazmave, nga XAVIER LAPEYROUX / Fluturimet e pëllumbave, nga FRANÇOIS ALBÉRA

FAQE 22	Frederic Wiseman, epopeja e jetës së zakonshme, nga PHILIPPE PERSON
FAQE 23	Anna Ahmatova, ardhja e dytë në Shqipëri, nga ILIR YZEIRI
FAQE 24	Bëjeni buzëqeshjen profesionin tuaj, nga Gabrielle Schütz